


KËRKESË ANKIMORE – PËRPARA KAS

Tiranë – Datë 26.05.2025



ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel: 0697839115
KOALICIONI "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE" (PD-ASHM)	

OBJEKTI I ANKIMIT

1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 1315, datë 22.05.2025 – të KSHZ - "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku KORÇË, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025"
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku – Korçë.
3. Zgjidhjen e pasojave duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.

Vendimi	TITULLI I VENDIMIT <u>"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025"</u>
---------	--

Nr.	Datë
1315	22.05.2025

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Korçë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkengjitet këtij vendimi ;
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për kandidatët për deputetë në zonën zgjedhore Qarku Korçë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkengjitet këtij vendimi ... ;

Baza Ligjore:

Nenet: 3, 8, 19, pika 1, 21, pika 1, gërma "a", neni 25, 25/1, 25/2, 26 pika 2, neni 39, pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 121, 123, 123/1, 123/2, 123/3, 124, 125, 127, 133, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 160, 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN**A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese**

Neni 123 i Kodit Zgjedhor parashikon se nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvend, behet nga KQZ. Për këtë, KQZ plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të



Mëshkrimi i Ankuesit

Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore, pra ne rastin konkret të Qarkut perkates.

Në çdo rast Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas këtij neni, nuk mund të miratohet nga KQZ, pa numëruar të gjitha kutitë e pranuar të rregullta, sipas këtij Kodi, në të kundërt vendimi i miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, është i pavlefshëm.

Kur gjatë hartimit të tabelës, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vëren mospërputhje të shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-së me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, merr vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore me shifrat e korigjuara, duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit. Një kopje e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zonës zgjedhore përkatëse.

Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

Referuar Nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet e drejta për të vënë në lëvizje KQZ, si një e drejtë që i njihet subjekteve zgjedhore, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

Sipas pikes 2 të këtij Neni, kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor.

Ndërsa, neni 124, pika 3 parashikohen qarte se Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi. Nderkohe në bazë të Nenit 124/6 i Kodit Zgjedhor, përcaktohet se : ***“Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor”.***

- Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025” ;



Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor, “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM), të kryesuar nga Partia Demokratike (PD), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025.


Nënshkrimi i Ankuesit

Për shkak se çënohen interesat tona të ligjshme, PD-ASHM e kundërshton këtë tabelë përmbledhëse të rezultateve për Qarkun Korçë, për shkaqet dhe arsyet që do të paraqiten në vijim.

Duke qenë se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar rregullisht në zgjedhjet e 11 majit 2025, si dhe duke qenë se ankimi jone paraqitet brenda afatit 5-ditor nga momenti i shpalljes së tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KQZ, ne kemi legjitimitet të plotë për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore përpara KAS.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim "KAS") është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma "a" parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, 124 e vijues të Kodit Zgjedhor parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin objekt ankimi është vendosur miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për Subjektet dhe kandidatët për Zgjedhjet për Kuvend të 11 majit 2025 në Qarkun Korçë. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, brenda afatit ligjor prej 5-ditësh.

Në këtë kuptim, Koalicioni "PD-ASHM" përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, mund të bëhet jo më vonë se 5-ditë nga shpallja e këtij vendimi.


Në rastin konkret, vendimi objekt ankimi është shpallur nga z. Celibashi në datë 22.05.2025. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga dispozitat perkatëse të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni "PD-ASHM" përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga PD-ASHM përmbush të tre kriteret proceduriale (*legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor*), kërkojmë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga Koalicioni "PD-ASHM" lidhur me zgjedhjet e 11 Maj 2025 të zhvilluara në Qarkun Korçë.

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.




Nënshkrimi i Ankuesit

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në Qarkun objekt ankimi, KQZ miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet dhe kandidatë për zgjedhjet për Kuvend, sipas tabelës bashkëngjitur vendimit të atakuar.

Koalicioni PD-ASHM, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të rënda të procesit zgjedhor të ndodhura në të gjitha Qëndrat e Votimit të Qarkut Korçë.

Në Qarkun Korçë, përdorimi sistematik i administratës publike dhe strukturave shtetërore në funksion të interesave elektorale të Partisë Socialiste ka qenë i përhapur dhe intensiv, duke krijuar një mjedis thellësisht të pabarabartë, jo-transparent dhe diskriminues ndaj opozitës. Institucione që, sipas Kushtetutës dhe ligjit, duhet të ruajnë neutralitetin politik, përfshirë administratën e bashkive, agjencitë shtetërore, entet publike dhe ndërmarrjet janë vënë në mënyrë të hapur në shërbim të partisë në pushtet. Praktikisht, të gjitha bashkitë e qarkut, së bashku me kryetarët e tyre dhe administratat përkatëse, janë angazhuar gjatë gjithë periudhës parazgjedhore në mbështetje të listës së kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste në Korçë.

Veprimtaria e strukturave publike nisi që në muajin Janar, nën petkun e “fushatës për regjistrimin e Diasporës”. Kjo përfshiu organizimin e takimeve intensive jo vetëm brenda vendit, por edhe në Greqi, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Kanada dhe vende të tjera ku jetojnë emigrantë shqiptarë, përfshirë edhe persona të moshuar që prej dekadash nuk kanë qenë më pjesë aktive e jetës politike në Shqipëri. Partia Demokratike ka denoncuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një sërë rastesh ku kryetarë bashkie dhe funksionarë të tjerë lokalë të Qarkut Korçë janë përfshirë personalisht në procesin e regjistrimit të qytetarëve në platformën PER, duke abuzuar me detyrën dhe duke shkelur çdo normë të ndarjes së administratës nga fushata. Madje, disa prej tyre e kanë pranuar publikisht këtë angazhim, duke u shprehur krenarë që ishin “patronazhistë” aktivë dhe se kishin përdorur ditët e lejes vjetore për të kontribuar në këtë proces.

Në këto kushte, pjesa më e madhe e administratës vendore dhe qendrore, në vend që të përmbushte detyrimet e saj funksionale ndaj qytetarëve, u përfshi drejtpërdrejt në aktivitetet elektorale të Partisë Socialiste. Zyrtarët lokalë kishin objektiva të qarta dhe synime të përcaktuara për numrin e votuesve që duhej të mobilizonin apo garantonin personalisht, duke e kthyer Shtetin në një instrument të fushatës së mazhorancës. Si pasojë, qytetarët e Qarkut Korçë nuk kanë marrë shërbimet publike të nevojshme gjatë kësaj periudhe, sepse për më shumë se katër muaj (nga Janari gjer në Maj), administrata ishte zhvendosur dhe fokusuar tërësisht në funksion të axhendës elektorale. Te shumë janë rastet ku jo vetëm drejtoret, por edhe specialiste të thjeshtë rezultojnë se kanë marrë lejen vjetore mbi 3-4 javë në këtë fazë, jo për pushime dimri apo pranverë, jo për c’lodhje apo udhetime, por pikërisht për të qenë aktiv në zgjedhje dhe për t’u angazhuar teresisht në fushatë zgjedhore.

Kjo situatë ka shuar praktikisht çdo kufi mes interesit publik dhe interesit partiak, duke minuar themelet e konkurrencës së ndershme dhe të barabartë në një proces demokratik. Në një realitet ku Partia-Shtet përdor të gjithë aparatit administrativ si makineri elektorale, opozita nuk përballlet më me një kundërshtar politik, por me një sistem të tërë që e kthen garën në një farsë. Në këto kushte, zgjedhjet e lira dhe të ndershme mbeten një iluzion.

Farsa elektorale që ne duam të denoncojmë është pikërisht kjo: Opozita nuk hyn në garë me një fushatë të lirë dhe të ndershme, por përballlet me një kundërshtar që gëzon të gjitha resurset shtetërore apo publike, si dhe mund të angazhojë edhe resurse private pa limit në dispozicion sa here i nevojitet. Ndërkohë që partia në pushtet ka në dispozicion buxhetin e Shtetit, buxhetet e gati 90% të bashkive në rang vendi (100% të Bashkive në Qarkun Korçë), rrjetin e administratës të fryrë jashtëzakonisht, dhe strukturat policore apo gjyqësore etj., si instrumente trysnie, subjektet opozitare operojnë me fondet e tyre të kufizuara dhe pa akses. Po, në këto zgjedhje pati përdorim të qarte jo vetëm të mjeteve represive të Shtetit në favor të Partisë Shtet, si Policia, Policia e Burgjeve etj, por pati përdorim të qarte edhe të Gjyqësorit.




Nënshkrimi i Ankuesit

Të gjithë jemi dëshmitarë sesi u vu në lëvizje i gjithë aparati shtetëror për të siguruar... jo, jo 36 mijë, por 36 votat e çmuara të Burgut të Grave në Pojskë, të Pogradecit !¹

Një mobilizim që do ta kishte zili edhe vetë Vladimir Putin, i cili me gjithë dashurinë për rezultatet "plebishitare", zor se do guxonte të pretendonte 100% vota në favor të Partisë-Shtet në një burg të grave.

Ndërkohë që Administrata e KQZ-së shprehej e shqetësuar, sepse, imagjinoni pak, KZAZ-ja paskësh refuzuar të hapte një qendër votimi të posaçme në burg, duke respektuar për çudi një vendim të Kolegjit Zgjedhor, u desh ndërhyrja vendimtare e gjykatësve "të pavarur" të Korçës. Këta të fundit, me vendime të stilit "fap e fap", jo vetëm që urdhëruan që të burgosurat të votonin, por vendosën edhe ku do votonin. Pavarësia gjyqësore në veprim!

Meqë në burg nuk kishte qendër votimi, dhe që vendimi të mos mbetej në letër, gjykatesit e zellshëm të drejtësisë të pavarur Korçare shpikën një zgjidhje të paparë: të burgosurat të votojnë bashkë me fshatarët lokalë, në qendrën më të afërt gjeografikisht me burgun. Thjesht brilante! Tani, edhe KQZ mund të përfshijnë të burgosurat si banorë të përkohshme të fshatit.

Spektakli vazhdoi me koreografi perfekte: Drejtoria e Burgjeve, Policia e Burgjeve dhe gjithë zinxhiri shtetëror u vu në lëvizje : mjete, forca, shoqërues, gjithçka për të siguruar që asnjë nga 36 votat të mos u shpëtonte duarve të Partisë. Një rast i rrallë, ku për herë të parë në historinë e Shqipërisë, të burgosurit morën "leje" de facto për të dalë nga burgu dhe për të votuar bashkë me popullin, në një atmosferë të lirë, demokratike dhe... padyshim të mbushur me frymë falënderimi ndaj qeverisë që i kishte futur në burg!

Rezultati? Epik: 36 me 0 në favor të Partisë. Një fitore spektakolare, një dëshmi e gjallë e pjekurisë politike të grave të burgosura, të cilat, si trup i pandashëm dhe me vetëdije të plotë, vendosën të mbështesin pikërisht atë që u kishte siguruar akomodimin pas hekurave.

Fitorja në Burgun e Grave është më shumë se statistikë, është një monument i bashkëpunimit të frytshëm midis Partisë, Policisë, Drejtësisë dhe organeve ligjzbatuese. Madje, në analizë të thelluar, kjo fitore ka konsoliduar jo vetëm lidhjen klasike Parti-Shtet, por ka forcuar më tej edhe aleancën strategjike mes Partisë dhe personave me precedentë penalë. Një partneritet që premtion shumë për zgjedhjet e ardhshme!

Sepse në fund të fundit, çdo votë ka rëndësi... por disa vota janë më të barabarta se të tjerat.

Edhe në media, aksesit i opozitës është mjaft i kufizuar, shtuar kjo edhe censura, autocensura, mbyllja e rrjeteve sociale si ai TikTok. Raporti i OSBE-ODIHR është tejet kritik ndaj kontrollit, censurës së medias apo auto-censurës së saj. Kjo krijon një disproporcion të skajshëm në kapacitet, dukshmëri dhe aftësi mobilizimi të Opozitës.

Në këtë kontekst, zgjedhjet në Shqipëri nuk janë më një mekanizëm përfaqësues i demokracisë, por një farsë elektorale ku rezultati parapërcaktohet nga instrumentet e Shtetit dhe pushtetit, i cili here pas here mbështetet edhe tek grupet kriminale.

Edhe Raporti Paraprak i OSBE-ODIHR i datës 12 Maj 2025, pra me pak se 24 ore pas mbylljes së kutive të votimit ka evidentuar problemet serioze, të tilla:

Në raportin e OSBE-ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, zona e Qarkut Korçë është përmendur në disa raste si një ndër rajonet ku u shfaqën problematika serioze lidhur me keqpërdorimin e administratës publike dhe presionin mbi punonjësit e sektorit shtetëror.

¹ <https://www.voxnews.al/aktualitet/levet-roze-edhe-burgu-i-pojskes-te-gjitha-grate-e-denuara-votojne-per-i91773>

Konkretisht, raporti thekson se në bashkitë Korçë dhe Devoll pati pretendime për presion të ushtruar mbi punonjësit e bashkive që të merrnin pjesë në aktivitete të fushatës së Partisë Socialiste, madje edhe duke kontribuar financiarisht në fushatë. Gjithashtu, u raportuan raste kur punonjësit u detyruan të jepnin informacion mbi familjarët apo të njohurit që jetojnë jashtë shtetit, çka përbën një shqetësim serioz për ndërhyrjen në privatësinë dhe lirinë e votuesve.

Raporti thekson gjithashtu se në disa zona, përfshirë Korçën, pati pretendime për blerje votash dhe përfshirje të strukturave të patronazhistëve në presion ndaj qytetarëve për të mbështetur PS. Këto veprime u raportuan si mjete për të ndikuar në rezultatin zgjedhor në favor të partisë në pushtet, në kundërshtim me parimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Këto gjetje janë në përputhje me shqetësimet e ngritura nga opozita dhe aktorë të tjerë politikë për shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe mungesën e një ndarje të qartë mes partisë dhe shtetit në këtë qark.

Megjithëse problematikat tepër shqetësuese të evidentuara në Qarkun Korçë, përbëjnë një cënim serioz të integritetit të procesit zgjedhor dhe ndikojnë drejtpërdrejt në vlefshmërinë e tij në nivel rajonal dhe kombëtar, problematika më e rëndë e zgjedhjeve të 11 majit mbetet procesi i votimit të Diasporës. Ky proces, i cili përbën “thembrën e Akilit” të këtyre zgjedhjeve të kontestuara, ndonëse formalisht i mbështetur në një bazë kushtetuese dhe ligjore, ka rezultuar në mënyrë evidente si një dështim total në vlerësimin tonë, për shkak të mangësive të rënda në zbatimin praktik.

Në lidhje me këtë çështje madhore, do të parashtrojmë në vijim argumentet dhe sqarimet tona të detajuara. Megjithatë, është fakt i pakundërshtueshëm se, në ditën e shqyrtimit të ankesave, as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe as kompania postare ndërkombëtare DHL ka deshtuar të vendosi në dispozicion prova që të vërtetojë përmbushjen e plotë të detyrimit ligjor për dërgimin e zarfeve me fletët e votimit në adresën e regjistruar në KQZ për secilin votues të regjistruar nga Diaspora, kundrejt paraqitjes prej secilit prej tyre të një mjeti identifikimi dhe kundrejt nenshkrimit personal të secilit zgjedhës.

Ne vijim, po analizojmë të faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMI.

Referuar Nenit 160 “Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit” parashikon se:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsytimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsytimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsytimi i detajuar për pasojën e tyre”.



Referuar Nenit 161 “Përsëritja e zgjedhjeve” :

Shënimi i Ankuesit

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KOZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi. Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

3. Në rast pavlefshmërie për shkak të fatkeqësisë natyrore, sipas shkronjës “b”, apo të mosfillimit të votimit ose pezullimit më shumë se pesë orë të tij, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 160, merret në konsideratë numri total i zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

5. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.

6. Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme dhe për të cilat KQZ-ja ka vendosur përsëritjen, sipas këtij neni, përsëriten në një ditë të vetme për të gjitha zonat zgjedhore ku është vendosur përsëritja e tyre. Vendimi për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve merret nga KQZ-ja me përfundimin e procedurave ankimore, sipas kësaj pjese ose me kalimin e afateve ligjore të ankimit, të përcaktuara në këtë pjesë. Përsëritja e zgjedhjeve zhvillohet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit.


7. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për shpalljen ose jo të zgjedhjeve të pavlefshme bëhet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë pjesë”.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të renda të dispozitave të Kodit Zgjedhor :

Problemet e zgjedhjeve në qarkun e Korçës, pa vecuar asnjë nga 6 Bashkitë e këtij qarku, si Bashkia Korçë, Bashkia Pogradec, Bashkia Maliq, Bashkia Pustec, Bashkia Devoll dhe Bashkia Kolonjë, janë thellësisht të ndërlidhura me varferinë dhe izolimin gjeografik të një pjese të këtyre bashkive, varfërinë strukturore dhe keqadministrimin e burimeve publike. Në kontekstin e zgjedhjeve të 11 majit 2025, këto probleme janë pasqyruar dhe përkeqësuar nga përdorimi politik i administratës shtetërore dhe intimidimi i votuesve dhe ndërhyrja e patronazhistëve për të kontrolluar votën e lirë të çdo qytetari të Qarkut Korçë. Raporti ndërkombëtar i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE-ODIHR, i datës 12 Maj 2025 [bashkengjitur kopja e tij] përmend në mënyrë eksplicite se përdorimi i burimeve administrative nga partia në pushtet ka krijuar një avantazh të padrejtë dhe ka ndikuar ndjeshëm në rezultatin e zgjedhjeve, duke favorizuar kështu Partinë-Shtet.

Në qarkun Korçë, procesi zgjedhor është shoqëruar me një klimë të theksuar presioni mbi nëpunësit civilë, me aktivizimin e rrjeteve të patronazhistëve dhe me raste të dokumentuara intimidimi ndaj votuesve të opozitës. Kjo atmosferë cenon rëndë standardet minimale të një procesi zgjedhor demokratik dhe ka krijuar kushte ku konkurrenca e ndershme është zëvendësuar nga kontrolli politik dhe manipulimi i vullnetit të qytetarëve.




Kryetari i Ankimit

Në bashkitë Maliq, Devoll dhe Kolonjë – zona me nivel të lartë varfërie dhe mungesë të theksuar mundësish ekonomike – praktika të tilla si kushtëzimi i votës me ndihma ekonomike, shantazhi për vendin e punës apo presioni përmes strukturave lokale, janë më të lehta për t'u zbatuar dhe kanë pasur efekt më të madh krahasuar me bashkitë e tjera të qarkut.

Në thelb, qarku Korçë me të gjashtë bashkitë që përfshin, ofron një pasqyrë të qartë të nivelit të ulët të funksionimit demokratik në vend. Pabarazia flagrante në garën zgjedhore, kapja thuajse totale e institucioneve shtetërore dhe përfshirja e ndërmarrjeve private që mbijetojnë përmes kontratave publike, kanë krijuar një realitet ku varfëria instrumentalizohet për qëllime elektorale, ndërsa qytetarët përjetojnë një cikël të pandërprerë presioni dhe abuzimi. Kjo situatë pasqyron një pushtet që, për të ruajtur dominimin e tij, nuk nguron të përdorë çdo mjet në dispozicion, në kundërshtim të hapur me normat demokratike dhe të drejtën e qytetarëve për të votuar të lirë.

A. Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera shtetërore:

Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 në Shqipëri, janë ngritur akuza për blerje votash nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera shtetërore, veçanërisht në Qarkun Korçë. Këto praktika janë denoncuar nga opozita dhe media, si dhe janë vërejtur nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Sipas raportit të OSBE-së, zgjedhjet u karakterizuan nga mungesa e një fushe loje të barabartë, përfshirë censurën vetjake të gazetarëve dhe një fushatë polarizuese. U raportua për përdorim të gjerë të burimeve publike dhe pushtetit institucional nga partia në pushtet, si dhe raste presioni ndaj punonjësve publikë dhe votuesve të tjerë, përfshirë raste intimidimi.

Në gjithë Qarkun Korçë, janë raportuar raste të përdorimit të administratës publike dhe burimeve shtetërore për qëllime elektorale, duke përfshirë shpërndarjen e bonuseve dhe përfitimeve të tjera për të ndikuar në votën e qytetarëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe rregullat për ndarjen e qartë midis funksioneve publike dhe veprimtarive politike.

Në vijim po ju sjellim ne vëmendje, disa prej rasteve të denoncuar më herët nga PD-ASHM dhe kandidatët e saj në zgjedhje, ku vota u mor në këmbim të favoreve të ndryshme nga pushteti:

Rasti 1

Në datën 24/04/2025, banorë të ndryshëm kanë vënë re se në Maliq, persona të ndryshëm me karroca dore po transportonin thasë me miell me mbishkrimet “*Farina Natyral*”, në mbështjellje 25 kg. Të pyetur nga qytetarët e ndryshëm, personat të cilët kishin marrë miellin, kanë thënë se këtë mjell mund ta merrje vetëm në këmbim të votës për zgjedhjet e datës 11 maj 2025, për subjektin politik Partia Socialiste dhe kandidatëve të tyre.

Gjithashtu paketimet me miell në sasi të mëdha mbaheshin të depozituara dhe shpërndaheshin nga ambientet e shtëpive të personave të kallëzuar, personave të cilët njihen në zonë si eksponentë politikë të Partisë Socialiste dhe punonjës të institucioneve në territorin e Bashkisë Maliq. (Foto dhe Video nga banesat e Vjollca Qako dhe Sonil Pine, ku duken të depozituara sasi të mëdha të paketimeve me miell).

Nga interesimi jonë kemi kuptuar që këtë veprimtari; dhënien e të mirave materiale, në këmbim të votimit në mënyrë të caktuar për Partinë Socialiste dhe kandidatëve të saj, personat të cilët ofronin thasët me miell, të kallëzuar prej nesh, e kanë kryer dhe në bashkëpunim me persona të tjerë, të cilët nuk kemi mundur t'i identifikojmë. Kjo pasi personat të cilët kishin marrë thasët me miell, bënë me dije se ishin njoftuar nga persona të tjerë, të cilët mbajnë pozicione pranë Partisë Socialiste në Bashkinë Maliq. Gjithashtu dhe personat të cilët kanë pranur me vetëdije këto të mira materiale, për të votuar në një mënyrë të caktuar dhe në mbështetje të një kandidati të caktuar të Partisë Socialiste, pasi kjo gjë ju është shpjeguar nga personat të cilët ofronin dhe jepnin thasët me miell; kanë konsumuar vepër penale.




Qendrimi / Ankuesi

Rasti 2

Në datën 27 Mars 2025, kandidatja për deputete e Qarkut Korçë Besa Spaho, së bashku me Drejtorin e AKU Korçë, Ervis Koçileri kanë shkuar në Tavernën “Shtëpia e Traditës”, në fshatin Zape, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë. Në këtë restorant kanë shkuar dhe pronarë të bizneseve të cilat janë subjekt kontrolli permanent, i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Nga informacioni i marrë, ju është ofruar, premtuar biznesmenëve, favorizimi nga ana e institucionit të AKU, në këmbimit të votës së tyre dhe ndikimi tek punonjësit e tyre, për të votuar kandidaten për deputete Besa Spaho.

Në datën 24 Prill 2025, kandidatja për deputete e Qarkut Korçë Besa Spaho, së bashku me ekipin e saj kanë zhvilluar aktivitet politik në fshatin Mborje, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë. Pas mbarimit të aktivitetit politik, ka shkuar në disa dyqane ushqimore dhe ka paguar listën e borxheve të personave të cilat kishin marrë produkte në dyqane dhe nuk i kishin paguar. Ky veprim i shtetases Besa Spaho, është bërë me qëllim që personat të cilat kishin këto pagesa të pakryera, të votojnë në zgjedhjet e 11 maj 2025, kandidaten Besa Spaho.

Gjatë të gjithë muajit Prill 2025, me urdhër të titullarëve/përgjegjësve të ASHK Korçë-Devoll-Ersekë Korçë dhe kandidatës Besa Spaho (e cila ka mbajtur pozicionin e Drejtoreshës së Drejtorisë Vendore, të ASHK-së Korçë) kanë dalë në terren punonjësit e këtij institucioni; duke shkuar në personat dhe familjet të cilat kanë aplikuar për legalizim të ndërtimeve informale, pranë ish ALUIZNI dhe ASHK. Këta punonjës kanë premtuar legalizimin e objekteve, në këmbim të votës për kandidaten për deputete Besa Spaho. Ky fenomen ka ndodhur veçanërisht në zonën e Bashkisë Maliq. Gjithashtu, për të mos u identifikuar nga ana e qytetarëve është vënë re se, punonjësit të cilët detyrat funksionale i kanë në zyrat e ASHK Korçë, kanë zvendësuar punonjësit të cilët detyrat funksionale i kanë në terren.

Rasti 3

Në datën 7 Prill 2025 dhe në vazhdim, titullarja e Drejtorisë Tatimore Korçë Daniela Lico, ka shoqëruar kandidaten Besa Spaho në ambientet e biznesit “Bujtinë” të shtetasit Sotir Guri, në fshatin Polene (fakt i publikuar dhe në rrjetin social të kandidatës Besa Spaho), ku kërkon votën për këtë kandidate. Gjithashtu, drejtoresha Daniela Lico, kërcënon bizneset në qytetin e Korçës, duke premtuar se do aplikojë masa ndëshkuese, për subjektet që nuk do votojnë kandidaten Besa Spaho.

B. Vendosja e shtetit në shërbim të Partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore dhe/ose Investimet Publike për manipulimin e vullnetit të zgjedhësve.

Përdorimi i Administratës dhe i Burimeve Publike:

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka paraqitur me dhjetra kërkesa zyrtare në KQZ, duke denoncuar raste për shkelje të veprimtarive të ndaluara 4-muj para zgjedhjeve sipas vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Madje për raste të caktuara janë depozituar edhe kallezime penale nga ana e Partisë Demokratike.


Më poshtë janë disa nga denoncimet që Partia Demokratike apo eksponentë të saj kanë bërë :



Rasti 1

Bashkia Maliq ka shtruar “asfaltin elektorat” në disa rrugë dhe ka kryer punime duke ndryshuar sistemin ujor dhe ka rinovuar pyjet.

Rasti 2


Bashkia e Ankesës

Bashkia Pogradec ka shtruar "asfaltin elektoral" në disa fshatra të qytetit, siç janë rrugët kryesore të fshatrave Verdovë, Rrëmenj, Gështenjas, Baçallëk, Çërravë dhe Kriçkovë. Bashkia Pogradec ka përfunduar fazën e parë të asfaltimit të rrugës Proptisht-Slabinjë.

Rasti 3

Bashkia Pogradec ka përfunduar rijetëzimin e Qendrës Historike të "Pogradecit të Vjetër". Gjithashtu ka kryer termoizolimimin e pallateve në lagjen 3. Bashkia Pogradec ka kryer punime për rikonstruksionin e shkollës "Kajo Karafili" të fshatit Gështenjas.

Rasti 4

Kryetari i Bashkisë Devoll Eduard Duro ka marrë pjesë në takime dhe organizime politike duke shoqëruar Niko Peleshin në takimet e këtij të fundit me banorët e qytetit të Devollit gjatë të cilit ka prezantuar kandidatët për deputet të Partisë Socialiste për Qarkun e Korçës. Vet subjekti Eduard Demo ka publikuar në rrjetin e tij social Facebook foto nga takimi, i cili shihet se është i pozicionuar në një tavolinë me Niko Peleshin dhe kandidatët për deputet.

Rasti 5

Bashkia Maliq ka shpallur procedurat e prokurimit "Sistemim asfaltim rrugë 2025" para fushatës zgjedhore. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna:

- *Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Maliq*
- *Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur pune*
- *Objekti i kontratës: Sistemim asfaltim rrugë 2025*
- *Numri i referencës së procedurës: REF-41656-03-19-2025*
- *Fondi limit: 83.332.941 Lek pa Tvsh*
- *Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj*
- *Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04.04.2025 (d/m/v) Ora: 10:00*

Rasti 6

Në datën 26 Prill, në Lagjen 18 në Bashkinë Korçë, aty ku ndodhen pallatet Favina është hedhur rërë për të shtruar rrugët në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Rasti 7

Ne datën 28 prill në Zaroshke, Fshati Cerje, gjatë nates, kemi konstatuar se në rrugë po shtrohej asfalti elektoral.

C. Sistemi kriminal i përdorimit të patronazhistëve të Partisë Socialiste:

Përdorimi i patronazhistëve nga Shteti dhe PS, vazhdon edhe në keto zgjedhje të ishte një problem serioz, i denoncuar jo vetëm nga Opozita, dhe mediat, por edhe nga organizatat dhe vezhguesit e zgjedhjeve. Përdorimi i patronazhistëve nga struktura shtetërore dhe nga Partia Socialiste në zgjedhjet e 11 majit 2025 në Qarkun Korçë, paraqet një sfidë serioze për integritetin dhe lirinë e votës. Në këto zona, ku ndikimi lokal i administratës shtetërore është i fortë dhe lidhjet personale shpesh përcaktojnë dinamikën elektorale, mazhoranca ka vënë në lëvizje rrjete patronazhiste për të orientuar dhe kontrolluar votuesit në mënyrë sistematike.

Sipas dëshmive të mbledhura nga opozita dhe gazetarë investigativë, në Korçë u vërejt pranë disa qendrave të votimit grupe të organizuara me lista të detajuara emrash dhe adresash. Këta persona, të




Nënshkrimi i Ankuesit

cilët ishin shpesh punonjës administrate, inspektorë apo madje efektivë policie në terren, nje pjese e mire e tyre me badge dhe akreditime te paligjshme te KQZ, e shoqëronin votuesin deri në derën e qendrës, nxitnin mbajtjen e fotografive të fletëvotimit apo listave zgjedhore, dhe ushtroheshin presion konstant për t'u siguruar se vota te shkonte në favor të subjektit apo kandidatit përkatës të PS-së.

Bashkëngjitur ne prova janë disa nga denoncimet që Partia Demokratike apo eksponentë të saj kanë bërë.

Avancimi i kësaj strategjie patronazhiste në Bashkitë e Qarkut Korçë është problematik jo vetëm për faktin se shkel Kodin Zgjedhor dhe vendimet e Komisionit Rregullator, por edhe sepse çon në trysni dhe dekurajim / distancimin e votuesve nga procesi zgjedhor: shumë zyrtarë lokalë raportuan se qytetarët refuzuan të paraqiteshin fare ne votime, nga frika e presionit.

D. Shteti vendosi investimet publike (prokurimet publike), intimidoi administratën shtetërore dhe përdori në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore në funksion të Partisë Socialiste për zgjedhjet e 11 majit 2025:

Vendosja e investimeve publike në funksion elektoral:

Është raportuar se gjatë muajve para zgjedhjeve, qeveria intensifikoi zbatimin e projekteve publike në këto zona, duke përfshirë tenderime dhe prokurime publike me ndikim lokal, shpesh të shoqëruara me promovime politike dhe prezencë të zyrtarëve të lartë të PS-së. Kjo lloj praktike, kur nuk bazohet në planifikim të zakonshëm buxhetor por synon të ndikojë në preferencat elektorale të qytetarëve, përbën shkelje të parimeve të barazisë në garën zgjedhore.

Bashkëngjitur janë disa nga denoncimet që Partia Demokratike apo eksponentë të saj kanë bërë.

Intimidimi i administratës shtetërore:

Janë raportuar raste të presionit të ushtruar ndaj punonjësve të administratës publike për të mbështetur në mënyrë aktive Partinë Socialiste, përfshirë pjesëmarrje në mitingje dhe fushata, si dhe ndjekje të votuesve (patronazhim) me qëllim orientimin dhe kontrollin e votës. Këto veprime bien ndesh me Kodin Zgjedhor dhe cenojnë rëndë lirinë e zgjedhësve për të votuar pa frikë apo ndërhyrje.

Bashkëngjitur janë disa nga denoncimet që Partia Demokratike apo eksponentë të saj kanë bërë.

E. Punësime të reja në administratën publike, si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik, duke devijuar vullnetin e zgjedhësve.

Punësime të reja në administratë gjatë fushatës:

Raportime të besueshme nga Qarku Korçë, tregojnë për rekrutime të reja në administratën lokale gjatë periudhës zgjedhore, në kundërshtim me ndalimet e vendosura nga Kodi Zgjedhor dhe vendimet e KQZ-së. Punësimet e motivuara politikisht janë dënuar si forma të blerjes së votës nëpërmjet përfitimeve shtetërore.

Bashkia Maliq ka shpallur procedurat për plotësimin e disa vendeve të lira pune në kategorinë e lartë drejtuese, vetëm pak kohë përpara nisjes së fushatës zgjedhore. Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është publikuar njoftimi për hapjen e procedurave të konkurimit për këto pozicione drejtuese, të cilat përfshijnë funksione të rëndësishme në strukturën administrative të bashkisë. Vendet vakante të shpallura për konkurim janë si më poshtë:



[Signature]
Qendra Kombëtare e Monitorimit dhe Raportimit

- Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion)
- Drejtor në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Asteve (1 pozicion)
- Përgjegjës Sektori në Sektorin e Prokurimeve dhe Menaxhimit të Kontratave (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Zyrën Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Sektorin e Shërbimeve Sociale (1 pozicion)
- Agronom 1 (pozicion)
- Specialist Koordinim Donatore (1 pozicion)
- Nëpunës Finance Protokoll (3 pozicion)
- Specialist Arkitekt Dizanj (1 pozicion)
- Specialist Auditi (1 pozicion)
- Specialist Inxhinier (1 pozicion)
- Specialist/Jurist (2 pozicione)
- Specialist për Prokurimet (2 pozicione)
- Specialist Programues Bazë të dhënash (1 pozicion)
- Specialist Statisticien (1 pozicion)

F. Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore, si dhe veprimtari të tjera të ndaluara.

Dhënia e lejeve të legalizimit dhe ndërtimit:

Një tjetër formë e përdorimit të burimeve shtetërore për qëllime elektorale ishte dhënia selektive e lejeve të legalizimit apo ndërtimit në Qarkun Korçë gjatë fushatës. Këto vendime janë parë si përpjekje për të siguruar mbështetje politike nëpërmjet përfitimeve konkrete, çka e minon besimin publik tek procesi zgjedhor.

Në përfundim, përdorimi i mjeteve shtetërore për përfitim elektoral është një shkelje serioze e demokracisë dhe cenon lirinë e zgjedhjes së qytetarëve. Këto praktika kërkojnë hetim dhe ndëshkim të menjëhershëm nga institucionet përkatëse.

G. Shkelje Ligjore ditën e Zgjedhjeve:

Ndër shkeljeve të shumta të tjera, janë evidenuar edhe rasti i gjimnazin Muharem Çollaku në Pogradec nga ekipet e PD-ASHM kanë konstatuar se punonjësit e bashkisë në hyrje të Qendrës së Votimit ju kanë bërë presion zgjedhësve për të votuar Partinë Socialiste.

H. Manipulimi kriminal i votës së Diasporës

Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM), përmes numëruesve dhe përfaqësuesve të saj pranë KQZ-së dhe komisioneve përkatëse, ka kontestuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të dokumentuar parregullsitë serioze në procesin e votimit të Diasporës në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, me theks të veçantë mbi shtetin fqinj, Greqinë.

1. Dyshime serioze mbi integritetin e votës së Diasporës në tërësi, veçanërisht në Greqi

Përfaqësuesit tanë kanë kundërshtuar hapjen dhe pranimin e të gjitha zarfeve të tipit B të ardhura nga Greqia, mbi bazën e dyshimeve të thella dhe të besueshme për:

- Tjetërsimin e votës;
- Manipulimin e saj në favor të mazhorancës;
- Ndërhyrjen e mundshme të strukturave të administratës shtetërore shqiptare jashtë vendit;




Nënshkrimi i Ankuesit

- Përdorimin e praktikave të patronazhimit dheurvejimit të preferencave politike të emigrantëve shqiptarë në Diasporë, veçanërisht në Greqi.

PD-ASHM ka paraqitur **prova dhe fakte të shumta mbi mënyrën se si operatori postar fitues i tenderit, DHL, ka shkelur kushtet bazë të përcaktuara nga ligji dhe Kodi Zgjedhor, duke nënkontraktuar palë të treta në Greqi, të cilat:**

- Nuk i shpërndanë zarfat në mënyrë individuale, në banesë;
- Nuk kërkuar paraqitjen e dokumentit të identifikimit;
- Nuk siguruan që nënshkrimi të bëhej personalisht nga marrësi i zarfit.

2. Mungesa e përgjigjeve nga KQZ

PD-ASHM i është drejtuar me kërkesa të përsëritura Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për:

- Marrjen e masave urgjente për ndalimin e kësaj praktike të paligjshme;
- Sqarime lidhur me mënyrën e shpërndarjes së zarfeve në Greqi;
- Masat për eliminimin e emrave të dyfishtë në listat zgjedhore (në Shqipëri dhe në Diasporë);
- Dokumente shpresore të operatorit postar që të provojnë se zarfat janë shpërndarë ligjërisht.

Asnjë nga këto kërkesa nuk ka marrë një përgjigje të plotë apo të argumentuar nga ana e KQZ-së deri në ditën e sotme.

Ndaj, për sa kohë që nuk ka asnjë provë ligjore dhe të dokumentuar për shpërndarjen e rregullt dhe të ligjshme të mbi 245.000 zarfeve në Diasporë, përfshirë rreth 60.000 zarfa vetëm në Greqi, ku një pjesë jo e vogël ishin votues të Qarkut e kontestuar, PD-ASHM e konsideron rezultatin zgjedhor në çdo zonë ku këto vota kanë ndikuar, si të cenuar në mënyrë të rëndë në integritetin dhe ligjshmërinë e tij.

Rezultatet për votimin e diasporës në Qarkun Korçë duken tërësisht jo realiste dhe të pabesueshme, sidomos kur analizohen me kujdes kutitë e votimit të ardhura nga Greqia. Në mënyrë të përsëritur, pjesëmarrja rezulton rreth 5 deri 7% në pothuajse çdo kuti votimi, një shifër e dyshimtë për një komunitet që përbën një nga grupet më të mëdha të emigrantëve shqiptarë në këtë qark. Kjo uniformitet absurde në përqindje ngre dyshime serioze mbi integritetin e procesit dhe sugjeron një manipulim sistematik ose ndërhyrje të qëllimshme për të ulur efektin real të votës së diasporës në këtë zonë.

Edhe rezultatet për partitë politike janë befasuese dhe thellësisht në kundërshtim me prirjet elektorale të votës brenda vendit. Sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, PD-ASHM ka marrë 30.34% të votave në territorin e Qarkut Korçë, ndërsa në diasporë kjo përqindje bie në vetëm 11%. Më konkretisht, PD-ASHM ka marrë rreth 4.000 vota, ndërkohë që Partia Socialiste ka marrë mbi 12.000 vota, një diferencë e cila nuk reflekton realitetin politik të këtij qarku dhe as prirjet e njohura të emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse. Këto mospërputhje të theksuara kërkojnë verifikim të thelluar dhe hetim të plotë mbi procesin e administrimit dhe numërimit të votave nga diaspora.

Vendimi Nr. 13, datë 12.11.2024 i Komisionit Rregullator ka parashikuar mundësinë e kontestimit të votave (nga numësuësit) kur ata kanë dyshime rreth integritetit të votave.



Nisur nga dispozitat e cituar më sipër, ne gjykojmë se ky proces është njollosur me shumë problematika thelbësore. Kur filloi nisma për përfshirjen e qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në këto zgjedhje, autoritetet zgjedhore vendase garantuan publikisht se çdo zarf me votë do të dorëzohej në adresën e deklaruar të votuesit në PER, përmes një shërbimi postar të drejtpërdrejtë. Votuesit u siguruan

Kontestimi i Ankuesit

se nuk do të kishin nevojë të dilnin nga shtëpia dhe se procesi do të ishte personal, i sigurt dhe pa ndërmjetës.

Por më para pak ditësh nga dita e zgjedhjeve, KQZ ndryshoi papritur qasje. Përmes një njoftimi të thjeshtë të publikuar nga në rrjetet sociale të KQZ, votuesit shqiptarë në Greqi, u njoftuan nga KQZ se duhet të paraqiten personalisht pranë pikave të DHL për të tërhequr ose dorëzuar zarfin e votimit. Ky ndryshim i befasisëm ka sjellë jo vetëm konfuzion mes votuesve, por ka ngritur edhe shqetësime serioze për transparencën, standardin dhe ligjshmërinë e procesit.

Ndryshimi i mënyrës së shpërndarjes së zarfeve bie ndesh me deklaratat dhe rregullat e mëparshme të KQZ-së. Sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, operatori postar ishte i detyruar të dorëzonte fizikisht çdo zarf tek votuesi, kundrejt nënshkrimit dhe paraqitjes së një dokumenti identifikimi. Madje u theksua publikisht se asnjë anëtar familje nuk mund të merrte zarfin në emër të një tjetri dhe do të bëheshin tre tentativa për t'u gjetur votuesi në adresë.

Në Greqi prej javësh kishim patur raportime se zarfat me vota nuk po u dorëzohen qytetarëve në dorë në banesë, por shpesh herë po përvetësohen në mënyrë të organizuar nga individë të caktuar që mund të paraqiten pranë pikave postare (*qoftë zyrtare, si zyra bastesh, apo hyrje pallatesh*), duke përdorur makina me qira me targa shqiptare për të shmangur gjurmët. Këta persona, të dyshuar të lidhur me Partinë Socialiste dhe strukturat e saj, ka njoftime se mund të kenë grumbulluar zarfa me fletët e votimit, cka është totalisht e ndaluar dhe penalisht e dënueshme.

Ndërkohë, siç dihet, Shteti shqiptar ka firmosur një kontratë me vlerë rreth 9.2 milionë Euro me kompaninë postare DHL për të garantuar shpërndarjen dhe grumbullimin korrekt të zarfeve kudo të Botë për 246.000 zgjedhës të regjistruar në PER. Ky ndryshim i papritur në mënyrën e dorëzimit – nga “zarfi vjen në shtëpi” në “shko e merre vetë” – jo vetëm që rrit vështirësitë praktike për mijëra votues, por krijon dhe hapësirë për ndërhyrje, parregullsi dhe potencialisht manipulime procesi.

Vetëm 1 javë para zgjedhjeve të 11 Majit 2025, ishin raportuar nga KQZ se mbi 6,000 zarfe të ardhura në Tiranë nga Greqia, ditën tjetër po 6.000 zarfa, ditën me pas 7.000 zarfa dhe në fund serish mbi 5.000 zarfa, ndërkohë që për disa javë më parë numri total ishte 17,700.

Si shpjegohet që një e treta e të gjithë zarfave të Greqisë vijnë në një ditë të vetme? Si shpjegohet që me pas për 3-4 ditë kjo shifer kerceu në rreth 52.000 vota.

Ky fluks i pazakontë dhe i papritur, në kontekstin e problemeve të raportuara, përforcon dyshimet mbi integritetin dhe parregullsine e procesit.

Shqetësimi ynë është i thellë jo vetëm për integritetin e votës, por edhe për pasojat të rënda që kjo situatë mund të ketë në besimin e publikut të procesi zgjedhor dhe demokracia në tërësi. Kjo situatë nuk u korrigjua ndaj, procesi i votimit të Diasporës u kthye në një eksperiment të dështuar, i shtrenjtë dhe me pasojat serioze për vendin.

Ndaj PD-ASHM kërkon shpalljen të pavlefshme të gjithë rezultatit zgjedhor në zonën zgjedhore të kontestuar, pasi procesi ka qenë i deformuar, i manipuluar dhe në kundërshtim të hapur me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.



D. Finalizimi i farsës elektorale (dita e zgjedhjeve dhe ditët e numërimit):

Gjatë zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025 në Qarkun Korçë, u raportuan një disa problematika që ngritën shqetësime mbi integritetin e procesit zgjedhor.

Nënshkrimi i Ankuesit

Në Korçë, përfaqësues të opozitës denoncuan praninë e drejtuesve të institucioneve publike, si drejtorë shkollash, të hipotekës, tatimeve, KESH, Ujesjellesit etj, pranë qendrave të votimit. Këta individë, të cilët janë pjesë e administratës, akuzohen për ushtrim presioni ndaj votuesve në favor të Partisë Socialiste. Ky veprim është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të cilat ndalojnë praninë e personave të paautorizuar brenda një perimetri prej 150 metrash nga qendrat e votimit.

Në të 5 bashkitë e qarkut, u raportua për një sistem të organizuar të patronazhistëve, të cilët shoqëronin votuesit deri pranë qendrave të votimit, duke ndikuar në mënyrë të paligjshme mbi vullnetin e tyre. Ky fenomen është një vazhdimësi e praktikave të mëparshme, ku individë të lidhur me Partinë Socialiste monitoronin dhe kontrollonin preferencat politike të qytetarëve, duke cenuar lirinë e votës.

Pavarësisht denoncimeve dhe raportimeve të shumta për parregullsi dhe shkelje të ligjit, reagimi i institucioneve përgjegjëse, si KQZ dhe organet e rendit, ka qenë i vakët. Mungesa e ndërhyrjes së menjëhershme dhe e masave ndëshkuese ka ngritur dyshime mbi paanshmërinë dhe efektivitetin e këtyre institucioneve në garantimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent.

Këto problematika në Qarkun Korçë pasqyrojnë sfidat e vazhdueshme që përballen zgjedhjet në Shqipëri, ku përdorimi i burimeve shtetërore për qëllime politike dhe intimidimi i votuesve mbeten pengesa serioze për zhvillimin demokracisë.

Në vlerësimin tonë për Qarkun Korçë, ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektivit të kërkimit. Sidoqoftë, ne si subjekt zgjedhor - përpara shqyrtimit në themel të kërkesës tonë - kërkojmë nga KAS urdhërimin e KSHZ dhe /ose administratës së KQZ, për të na vendosur në dispozicion provat si më poshtë:

- a) Të kryhet kryqëzimi i të dhënave të PEI-së për të gjitha Qendrat e Votimit në Qarkun Korçë dhe të vihet në dispozicion, sa më parë, një kopje e njësuar e këtyre raporteve;
- b) Të vihet në dispozicion, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe operatori postar i kontraktuar prej tij, regjistri i nënshkruar personalisht nga çdo zgjedhës në diasporë, që vërteton marrjen personale të zarfit me materialet zgjedhore nga secili zgjedhës i Qarkut Korçë;
- c) Raportin e Audituesit Teknikien lidhur me problematikën e listave të zgjedhësve në këtë Zonë Zgjedhore.
- d) Kopje e të gjitha Regjistrave të Posaçem e çdo QV në Zonën Zgjedhore objekt ankimi ;
- e) Kopje e të gjitha Proces-Verbaleve në çdo QV dhe për secilën KZAZ, në Zonën Zgjedhore;

Në përfundim të kërkesës tonë ankimore,

SA MË SIPËR KËRKOJMË:

1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 1315, datë 22.05.2025 – të KSHZ - “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025”.
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku - Korçë.




Nënshkrimi i Ankuesit

3. Zgjidhjen e pasojave, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.

**PROVAT QË PARAQITEN
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.**

1. Vendimi Nr. 1315 i KQZ për Miratimin e Tabeles Përmblledhese të Rezultatit – Zona Zgjedhore – Qarku Korçë;
2. Kopje e Raportit Paraprak të Gjetjeve të Misionit Vezhgues të OSBE-ODIHR, datë 12.05.2025 për Zgjedhjet e 11 Majit 2025;
3. Kopje e denoncimeve të shumta të kryera nga PD-ASHM ose nga eksponentët e saj politikë;
4. Kopje të dokumentave të tjera mbi të cilat mbështetet ankimi.

**KOALICIONI
PARTIA DEMOKRATIKE -ALEANCA PËR
SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM)**

Përfaqësuar nga:

**z. Franci NURI
Përfaqësues Ligjor i PD-ASHM në KQZ**



Tiranë, 26/05/2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.5.2025

Nr: 1315

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE PËR REZULTATIN E VOTIMIT NË
ZONËN ZGJEDHORE QARKU KORÇË PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE
KANDIDATËT PËR DEPUTETË, NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11
MAJ 2025**


Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, dhe nenit 123, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe kreut VI.2, pika 3, të vendimit nr. 22, datë 20.03.2025, të Komisionit Rregullator, "Për rregullat për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezulttit të votimit nga jashtë vendit", të ndryshuar.

VENDOS:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Korçë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputetë për 11 subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Korçë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 22.5.2025 Nr: 1315
Ora: 14:00



"Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025"

ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR SUBJEKTET
QARKU KORÇË




Lidhja 1

	ZAZ 70	ZAZ 71	ZAZ 72	ZAZ 73	ZAZ 74	ZAZ 75	ZAZ 76	Me jeshë	Gjithsej
1 Numri i zgjedhësve në listë	69.446	46.036	4.027	30.568	32.280	70.597	13.840	20.633	287.427
2 Fletë votimi të gjetura në kuit	27.471	20.218	1.663	14.636	12.717	27.139	5.952	16.840	126.636
3 Vota të pavlefshme	1.364	1.024	108	611	435	774	154	151	4.621
4 Vota të vlefshme	26.107	19.194	1.555	14.025	12.282	26.365	5.798	16.689	122.015
1 Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhshitore	8.776	5.792	458	5.870	4.576	9.270	1.664	3.388	39.794
2 Partia Lëvizja Bashkë	237	85	2	61	52	324	58	292	1.111
3 Lëvizja Atdheu	38	23	3	5	8	39	6	17	139
4 Partia Koalicioni Euroatlantik	355	301	1	94	94	169	22	55	1.091
5 Partia Socialiste e Shqipërisë	14.178	10.698	1.054	7.082	6.527	13.941	3.733	10.976	68.189
6 Koalicioni Nisma Shqiptaria Behet	1.349	946	7	361	398	1.351	124	1.291	5.827
7 Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare	47	24	2	18	14	39	7	101	252
8 Partia Aleanca Demokracia e Re	25	21	1	4	10	3	7	5	76
9 Koalicioni Diathas për Zhvillim	102	5	0	3	7	76	8	25	226
10 Partia Mundësia	756	296	16	203	203	696	86	367	2.623
11 Partia Socialdemokrate	244	1.003	11	324	393	457	83	172	2.687
Gjithsej vota të vlefshme	26.107	19.194	1.555	14.025	12.282	26.365	5.798	16.689	122.015

“Lyhet” rozë edhe burgu i Pojskës, të gjitha gratë e dënuara votojnë për PS-në

Vox

12 MAJ 2025, 18:57AKTUALITET
SHKRUAR NGA REDAKSIA VOX



Burgu i Pojskës

Teksa procesi i numërimit vijon me ritme të ngadalta në të gjithë vendin, një lajm ndryshe nga këto zgjedhje vjen nga burgu i grave në Pojskë të Pogradecit.

Gratë e dënuara në këtë burg kanë ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet e së dielës dhe sipas numërimit të votave të gjetura në kuti, të gjitha ishin për Partinë Socialiste.

Një fitore tjetër kjo e mazhorancës së Edi Ramës, e cila kishte fituar dhe në burgun e Drenovës.

shperndarja e parave nga PS per te marre vota. Ndiqeni videon e bere sot ne fshatin
Podgorie.

Like Comment Share

550 · 72 comments · 28



Edmond Spaho


Follow



May 8 at 10:36 PM · 🌐

Filloi shperndarja e parave nga PS per te marre vota.
Ndiqeni videon e bere sot ne fshatin Podgorie.

Search videos



May 8 at 10:39 PM

Pjesa e dyte e serialit 12 vjecar "Leke ne kembim te Votave". I zoti i shtepise implikon kandidatin e PS A.J. Fshati i sheh por SKAPI nuk i kap dot.

[See less](#)

Most relevant



Beni Spaho

Ku ka presion?

Pjesa e dyte e serialit 12 vjecar "Leke ne kembim te Votave". I zoti i shtepise implikon kandidatin e PS A.J. Fshati i sheh por SKAPI nuk i kap dot.

[Like](#) [Comment](#) [Share](#)[375](#) · 38 comments · 25



Posts

About

Photos

Videos

Events



64

4 comments 1 share



Like



Comment



Send



Share

**Ilir Xhakolli**

Mar 21 · 🌐

👏✅Rrugët kryesore të fshatrave Vërdovë, Rrëmenj, Gështenjas, Baçallëk e Çerravë tashmë kanë marrë investimin e duhur me riveshjen e shtresave të reja asfaltike. Ndërkohë që puna do të vijojë me rrugët e brendshme si fazë e dytë për ti dhënë zgjidhje çështjes së infrastrukturës rrugore të këtyre zonave.



119

13 comments 22 shares 24.8K views



Like



Comment



Send



Share

**Ilir Xhakolli**

Mar 20 · 🌐

**Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow**

Mar 20 · 🌐

Mirëmëngjes🔄

nga puna disa ditore që po bëjmë për pa... See more





Posts

About

Photos

Videos

Events

**Ilir Xhakolli**

Jan 11 · 🌐

**Niko Peleshi** · Follow

Jan 11 · 🌐



Për të gjithë bashkatdhetarët tanë në Selanik!



Nga dita e nesërme, në orën 10:00-20:00, çdo zgjedhës shqiptar që jeton dhe punon në **#Selanik** dhe ka nevojë për mbështetje teknike lidhur me procesin e regjistrimit për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit mund të paraqitet në zyrën e Partisë Socialiste në Selanik.

Për çdo pyetje ose nevojë për ndihmë gjatë procesit të regjistrimit, ekipi ynë do të jetë i gatshëm për të dhënë asistencë. Regjistrimi është i domosdoshëm për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit si votues i Diasporës.



Adresa: Tsimiski 43, T.K. 54623 Thessaloníki, Greece (Kati III, përballë Konsullatës Shqiptare)



Numër kontakti: +30 697 698 1218



Orari i shërbimit: 10:00 - 20:00

#DiasporaVoton 🇦🇱

#PlatformaElektronikeERegjistrimit 🇦🇱





Posts

About

Photos

Videos

Events

**Ilir Xhakolli**

Feb 12 · 🌐

**Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow**

Feb 12 · 🌐



Termoizolimi i pallateve në lagjen 3

Kemi nisur nga puna me një tjetër bllok pallatesh duke aplikuar sistemin kapot. Falë kësaj ndërhyrjeje të financuar nga FSHZH i japim zonës jo vetëm një pamje të re, por mundësojmë apartamente më të ngrohta për familjet. Kjo punë do të vijojë në të gjitha lagjet ku ka pallate të para viteve 90".

#bashkiapogradec #fshzh

126

14 comments 2 shares



Posts

About

Photos

Videos

Events

**Ilir Xhakolli**Mar 19 · **Edi Rama**  updated his cover photo. · **Follow**Mar 19 · **LIVE**MIRËMËNGJES 

dhe me numrin 5  të Partisë Socialiste në fletën e 11 majit, ku çdo shqiptar e shqiptare do të duhet ta investojë votën për të vazhduar pa asnjë ndalesë a lëkundje negociatat me BE, anëtarësuar Shqipërinë në Bashkimin European, siguruar pashaportën europiane për vete e familjen, duke mos parë majtas e djathtas, po drejt, tek maja e Shqipërisë 2030 në BE, ju uroj një ditë të mbarë 

 48

1 comment 3 shares



Like



Comment



Send



Share

**Ilir Xhakolli**Mar 18 · **Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare)** · **Follow**Mar 18 · Mirëmëngjes 



Posts

About

Photos

Videos

Events

**Ilir Xhakolli**



Feb 21 · 🌐

**Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow**

Feb 21 · 🌐

✓ E kryer

Ka nisur faza e parë e asfaltimit të rrugës Proptisht-Slabinjë. Një aks rrugor i rëndësishëm për lidhjen e dy njësive Velçan-Proptisht me aksin nacional. Paralelisht do vijoje puna për rehabilitimin e qendrës së Proptishtit me trotuare, shesh dhe ndriçim publik. Sepse Mokra e meriton!
#fshatratepogradecit #mokra #proptisht #slabinjë #velçan



👍 230

19 comments 3 shares



Like



Comment



Send



Share



Posts

About

Photos

Videos

Events



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) is with **ilir_xhakolli** and **ne_pogradec** in **Pogradec**.

2d 

U zhvillua takimi në kuadër të grantit të akorduar nga Agjencia Franceze e Zhvillimit (AFD) mbi masterplanin e turizmit për rajonin e Korçës. Në takim morën pjesë znj.Mirela Mata udhëheqëse e Misionit strategjik dhe operacional të AFD-së për Shqipëri dhe Kosovë, z.Romain Dissaux, shefi i projektit pranë zyrave qendrore të Agjencisë Franceze të Zhvillimit (AFD) dhe z.Sebastien Carreau përfaqësues i zyrës së AFD në Tiranë.

Objekti i takimit ishte njohja dhe diskutimi rreth projektit që do të realizohet me grantin e akorduar. Në takim u bë një prezantim i sektorit të turizmit në Pogradec si dhe politikat, projektet dhe nevojat në këtë sektor në mënyrë që grantin të bëhet sa më të vlefshëm.

Pasi u njohën me fushat që financohen nga projekti kryesisht për infrastrukturë turistike Bashkia Pogradec po përgatit disa projekte me të cilat do të aplikojë për financim pranë AFD.





Posts

About

Photos

Videos

Events

**Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare)**3h · Mirëmëngjes 

me punimet që po realizohen për rikonstruksimin total të shkollës "Kajo Karafili" të fshatit Gështenjas.

● Palestër e re sportive.

● Hapsira të reja shtesë, salla aktivitetesh dhe banja të reja.

● Sistem ngrohje me kaldajë.

● Sistem i ri elektrik.

● Rikonstruksim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme ekzistuese.

● Bazë e re materiale në fund të punimeve.

Ky është një investim që kryhet në bashkëpunim mes Bashkisë Pogradec dhe Ministrisë e Arsimit dhe Sporteve, në fund nxënësit e Gështenjasit do të kenë ambiente të reja dhe me standarde bashkëkohore.

 83

2 comments 16 shares 2.4K views



Like



Comment



Send



Share

**Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare)**1d · 

Njoftim për subjektet politike mbi materialet elektorale



Posts

About

Photos

Videos

Events

**Ilir Xhakolli**

Jan 20 · 🌐




#Diaspora 🇲🇰🇲🇰

Këtë fundjavë që lamë pas pata kënaqësinë të isha i ftuar për të biseduar me bashkëatdhetarët tanë në Selanik dhe Athinë. Diskutuam me ta për procesin e regjistrimit në KQZ mbi zgjedhjet e 11 Majit dhe për punët e mira që kemi bërë në Pogradec gjatë këtyre viteve.

Konstatova një entuziazëm të madh në radhët e tyre për hapin historik dhe mundësinë që iu dhamë për të votuar në këto zgjedhje. Emigrantët më mirë se çdokush tjetër e bëjnë dallimin e ndryshimeve në qytet dhe vend kur kthehen, ndaj jam i lumtur që çdo ditë e më tepër plotësojmë pritshmëritë e tyre për një Pogradec të zhvilluar dhe Shqipëri Europiane!

#Diaspora #zgjedhje #11Maji #Selanik #Athinë





Posts

About

Photos

Videos

More ▼



**Sotiraq Filo**Mar 6 · 

Barç

Nga puna për pastrimin e përroit në fshatin Barç,
Njësia Administrative Bulgarec.

Një ndërhyrje e rëndësishme që eleminon
rrezikshmërinë nga përmytjet që mund të shkaktohen
nga grumbullimi i inerteve dhe papastërtive.

Punë konkrete! 

#BashkiaKorce 158

9 comments 3 shares



Like



Comment



Send



Share



Posts

About

Photos

Videos

More **Sotiraq Filo**Feb 24 ·  Polenë

Pastrimi i kanaleve kullues është një proces pune i vazhdueshëm dhe sistematikë i bashkisë në ndihmë të fermerëve, sidomos në zonat rurale. 🌱

Mjetet dhe punëtorët tanë sot ishin në fshatin Polenë.



#BashkiaKorce

#mefermeret

#punekonkrete



151

6 comments 2 shares



Posts

About

Photos

Videos


More **Sotiraq Filo**Feb 21 

➡ Puna për ndërtimin e Polit të Dijes po vijon me një intensitet të lartë, një infrastrukturë e cila do të ngrejë Universitetin "Fan S. Noli" në një nivel të ri zhvillimi. 🌟

➡ Ky projekt i rëndësishëm ka si qëllim të forcojë bazën shkencore dhe edukative të universitetit, duke e pozicionuar atë në një standard ndërkombëtar.

➡ Në kuadër të këtij zhvillimi, janë planifikuar programe të përbashkëta inovative me partnerë ndërkombëtarë, si dhe afrimi i pedagogëve të njohur nga diaspora. Do të ngrihen qendra kërkimore shkencore, të cilat do të bashkëpunojnë ngushtësisht me sektorin e sipërmarrjes në fusha që janë të rëndësishme për zhvillimin e vendit. 📖 👤 🏢 🧑🏫

➡ E ardhmja e Universitetit "Fan S. Noli", si dhe e Korçës është e lidhur ngushtë me suksesin e këtij projekti të rëndësishëm.





Posts

About

Photos

Videos

More 

Like



Comment



Send



Share

**Sotirag Filo**Feb 28 · 

Punonjësit e Shërbimeve Publike janë të angazhuar çdo ditë në të gjitha Njësitë Administrative, duke kontribuar në mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për komunitetin. 🇲🇰

Disa nga detyrat e tyre të përditshme përfshijnë punë thelbësore që sigurojnë një mjedis të pastër dhe funksional për të gjithë banorët.

#BashkiaKorce

 186

4 comments 1 share



Like



Comment



Send



Share



Posts

About

Photos

Videos

More ▼

**Sotiraq Filo**Mar 10 ·  Voskop

Në çdo Njësi Administrative Ndërmarrja e Shërbimeve Publike po bën një punë të mirë, për t'u ardhur në ndihmë fermerëve.

Aktualisht po punohet në fshatin Voskop për pastrimin e kanaleve kullues.  

#BashkiaKorce

 199

7 comments 7 shares



Like



Comment



Send



Share



Posts

About

Videos

Photos

Events

**Afrim Avdiaj**

5d · 🌐



Të nderuar bashkatdhetarë:

Për shkak se në postën e Hantiasë SPEEDEX ndodhen shumë zarfe me nr tel të gabuar, ju lutemi të paraqiteni pranë kësaj zyre postare për ti tërhequr vetë zarfet tuaja.

Për të tërhequr zarfin duhet pasaporta, ose një dokument ku verifikon të dhënat tuaja.

Adresa--- PARTHENIU KELAIÐHI 60



👍 33

27 comments 6 shares



Like



Comment



Send



Share

**Afrim Avdiaj**

5d · 🌐





Posts

About

Videos

Photos

Events

68

17 comments



Like



Comment



Send



Share

**Afrim Avdiaj**

4d ·





Mbas shumë bisedimesh me strukturat e larta të postës DHL, por dhe me postat e tjera të cilat ka ngarkuar kjo postë për dorëzimin e zarfeve për zgjedhjet në kuvendin e Shqipërisë, organizata jonë arriti në marrëveshje që qendrat postare në Hania do jenë hapur ditën e Shtunë dhe të Dielë deri në orën 14:00.

Kjo të nderuar bashkatdhetarë ndodh për shkak të fluksit të madh që ka prefektura e Hantiasë në këto zgjedhje.

Ju lutemi vëllezër dhe motra, mos lejoni asnjë votë të shkoj dëm.

Ju faleminderit.



31

2 comments



Like



Comment



Send



Share

**Afrim Avdiaj**

4d ·





Posts

About

Photos

Videos

More ▼



63

9 comments 1 share 36K views



Like



Comment



Send



Share

**Komuniteti Shqiptar Hania. Κοινότητα
Αλβανων Χανια**

...


4d · 🌐

Mbas shumë bisedimesh me strukturat e larta të postës DHL, por dhe me postat e tjera të cilat ka ngarkuar kjo postë për dorëzimin e zarfeve për zgjedhjet në kuvendin e Shqipërisë, organizata jonë arriti në marrëveshje që qendrat postare në Hania do jenë hapur ditën e Shtunë dhe të Dielë deri në orën 14:00.

Kjo të nderuar bashkatdhetarë ndodh për shkak të fluksit të madh që ka prefektura e Haniës në këto zgjedhje.

Ju lutemi vëllezër dhe motra, mos lejoni asnjë votë të shkoj dëm.

Ju faleminderit.



14

1 comment 4 shares



Like



Comment



Send



Share

**Komuniteti Shqiptar Hania. Κοινότητα
Αλβανων Χανια**

...



Afrim Avdiaj

4.6K followers • 659 following



 Add friend

 Message



Posts

About


Videos

More ▼

Details

 **Profile** · Digital creator

... See Afrim's About Info



 23

2 comments



Like



Comment



Send



Share



Afrim Avdiaj



20h · 

**Vota për Partinë
Socialiste është çështje
Kombëtare.
FitorePS**



Afrim Avdiaj

16h · 🌐

...

**Asnjë votë nuk do shkoj
dëm këtu në Kretë.
Sado që të mundohen
klikat neo-fashiste.
Sepse këtu ka zot hauri.**

👍👍👍 42

8 comments



Like



Comment



Send



Share



Afrim Avdiaj

16h · 🌐

...

Mbas shumë bisedimesh me strukturat e larta të postës DHL, por dhe me postat e tjera të cilat ka ngarkuar kjo postë për dorëzimin e zarfeve për zgjedhjet në kuvendin e Shqipërisë, organizata jonë arriti në marrëveshje që qendrat postare në Hania do jenë hapur ditën e Shtunë dhe të Dielë



Posts

About

Videos

Photos

Events



31

2 comments



Like



Comment



Send



Share

**Afrim Avdiaj**

4d · 🌐

Vota për Partinë Socialiste
është çështje Kombëtare.
FitorePS



74

44 comments 1 share



Like



Comment



Send




Share

**Afrim Avdiaj**

5d · 🌐

Votoni Partinë Socialiste
sepse do tju hajë buba o
popull.
Krenar që bëra zgjedhjen e
duhur.





Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 9 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimit të aseteve publike dhe promovimit të veprave në fushën e infrasktrukturës nga Bashkia Krujë

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:

“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së...”

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Bashkia Krujë ka shpallur publikisht me ane të një table se do të kryejë punime për permiresimin e shtresave asfaltike në rrugën Thumane, duke konsumuar shkeljen e Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9/2020. Kjo ngjarje shoqërohet me foto, të cilat lehtësisht vërtetojnë shkeljen ligjor të kryer nga Bashkia Krujë.

Bazuar në nenin 23 pika 4 e ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” parashikon:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore”

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ngre shqetësimin dhe dyshimin se rehabilitimi dhe shtrimi i rrugëve para fushatës zgjedhore është një tentativë nga ana e Bashkisë Krujë për të ndikuar dhe përfituar votat e banorëve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM dyshon se kjo veprimtari e kryer para fushatës zgjedhore bëhet për qëllime politike dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe synon manipulimin e votave të zgjedhësve.

Kjo veprimtari është e ndaluar sipas Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, i cili parashikon:

“Neni 3

Veprimtari të ndaluara

1 Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë” veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjitikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, ai edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet...”

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...”

Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, rruga cilësohet të jetë burim/aset publik dhe përdorimi i saj për të mbështetur një subjekt zgjedhor të caktuar përbën shkelje të Kodit Zgjedhor.

Për këto arsye, vlerësojmë se veprimtaria e rehabilitimit të rrugëve para fushatës zgjedhore është kryer në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe ka sfond propagandistik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe mbi të gjitha kërkon të ndalohet ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë se jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto të shkeljeve të kryera.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

**PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ**

Franci NURI



Partia Demokratike

KALLËZIM PENAL

Korçë, më ____/____/2025

KALLËZUES:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE,
përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm **Z. Flamur NOKA**
Adresa për efekt komunikimi: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë
Email pd@rithemelimi.com

OBJEKTI:

Kallëzim i veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe
“Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 dhe
neni 328/b i Kodit Penal.

KUNDËR:

1. Vjollca Qako, punonjëse pranë Zyrës Postare Qendër Maliq
2. Sonil Sulo Pine, punonjës pranë Bashkisë Maliq
3. Artur Sardi, punonjës në pozicionin e shoferit pranë Bashkisë Maliq

*Çdo shtetas tjetër, ende i painedetifikuar deri më tani, i cili nga ky
hetim do të rezultojë me përgjegjësi penale.*

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale,
Neni 328, 328/b i Kodit Penal.

DREJTUAR:

**PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK**

I nderuar zoti Prokuror / E nderuar zonja Prokurore!

Unë kallëzuesi subjekti politik “Partia Demokratike”, kam rënë në dijeni të veprimtarisë
penale të parashikuar nga neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal, për të cilat ekziston dyshimi
serioz se mund të jenë konsumuar nga ana e personave të kallëzuar prej nesh.

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim kallëzimin për veprat penale të
sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat
ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave
vërtetohet konsumimi i veprave penale.

RRETHANAT DHE FAKTET:



Partia Demokratike

Në datën 24/04/2025, banorë të ndryshëm kanë vënë re se në Maliq, persona të ndryshëm me karroca dore po transportonin thasë me miell me mbishkrimet “*Farina Natyral*”, në mbështjellje 25 kg.

Të pyetur nga qytetarët e ndryshëm, personat të cilët kishin marrë miellin, kanë thënë se këtë mjell mund ta merrje vetëm në këmbim të votës për zgjedhjet e datës 11 maj 2025, për subjektin politik Partia Socialiste dhe kandidatëve të tyre.

Gjithashtu paketimet me miell në sasi të mëdha mbaheshin të depozituara dhe shpërndaheshin nga ambientet e shtëpive të personave të kallëzuar, personave të cilët njihen në zonë si eksponentë politikë të Partisë Socialiste dhe punonjës të institucioneve në territorin e Bashkisë Maliq. (Foto dhe Video nga bancesat e Vjollca Qako dhe Sonil Pine, ku duken të depozituara sasi të mëdha të paketimeve me miell).

Nga interesimi jonë kemi kuptuar që këtë veprimtari; dhënien e të mirave materiale, në këmbim të votimit në mënyrë të caktuar për Partinë Socialiste dhe kandidatëve të saj, personat të cilët ofronin thasët me miell, të kallëzuar prej nesh, e kanë kryer dhe në bashkëpunim me persona të tjerë, të cilët nuk kemi mundur t’i identifikojmë. Kjo pasi personat të cilët kishin marrë thasët me miell, bënin me dije se ishin njoftuar nga persona të tjerë, të cilët mbajnë pozicione pranë Partisë Socialiste në Bashkinë Maliq.

Gjithashtu dhe personat të cilët kanë pranur me vetëdije këto të mira materiale, për të votuar në një mënyrë të caktuar dhe në mbështetje të një kandidati të caktuar të Partisë Socialiste, pasi kjo gjë ju është shpjeguar nga personat të cilët ofronin dhe jepnin thasët me miell; kanë konsumuar vepër penale. Ne nuk kemi mundur të identifikojmë këta persona, por disa prej tyre paraqiten në foto të qarta, ku mund të identifikohen nga ana juaj.

Për çka parashtruam më sipër evidentohet qartazi nga rrethanat dhe provat foto e video bashkëngjitur këtij kallëzimi, se personat e kallëzuar dhe persona të tjerë të paidentifikuar prej nesh, kanë konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal.

JURIDIKSIONI, KOMPETENCA DHE KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM:

Juridiksioni:

Neni 75/a - *Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) krimet e nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, **328 dhe 328/b të Kodit Penal;**

Në rastin konkret, duke qenë se vepra penale e cila dyshojmë se është kryer përfshihet në veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, çmojmë se ky kallëzim është në kompetencën



Partia Demokratike

lëndore të Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) për t'u gjykuar.

Ligji i zbatueshem:

Neni 280 i K.Pr. Penale

Marrja dijani për veprën penale

“Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.

Neni 283 i K.Pr. Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

“1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

Neni 328 i Kodit Penal

Korrupsioni aktiv në zgjedhje

Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

Neni 328/b i Kodit Penal

Korrupsioni pasiv në zgjedhje

Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera në cilëndo formë, për vete ose të tjerët, me qëllim për të dhënë firmën për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

ANALIZA LIGJORE:

Nga indiciet, provat dhe faktet e paraqitura, ka vend se personat e kallëzuar kanë konsumuar veprat penale të parashikuara në nenin 328 dhe 328/b të Kodit Penal.



Partia Demokratike

Referuar nenit 328 të Kodit Penal:

Objekti i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e zgjedhjeve dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga **ana objektive**, vepra penale në rastin konkret është kryer me veprime të kundërligjshme, të korrupsionit, duke ofruar dhe dhënë të mira materiale (thasë me miell).

Subjekt i korrupsionit në sistemin e zgjedhjeve mund të jetë çdo person që ofron ose jep shpërblim, persona të interesuar për fitoren e një kandidati në zgjedhje për të votuar pro ose kundër një kandidati apo për të marrë pjesë ose jo në votime. Kështu që subjektet janë të posaçme dhe janë konkretisht **Vjollca Qako, Sonil Sulo Pine dhe Artur Sardi**.

Nga **ana subjektive**, vepra penale e korrupsionit në sistemin e zgjedhjeve kryhet me dashje dhe duke dëshiruar ardhjen e pasojave.

Referuar nenit 328/b të Kodit Penal:

Objekt i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt ligjore të zgjedhësve, në ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes, votimit të lirë e të ndershëm, interesat e kandidatit ose të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga **ana objektive** vepra penale është kryer me veprime direkte të kundërligjshme, nëpërmjet pranimit nga zgjedhësi i të mirave materiale.

Subjekt i veprës penale është i përgjithshëm, personi fizik që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm.

Nga **ana subjektive** vepra penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë me qëllim për të dhënë, për të votuar në një mënyrë të caktuar.

KONKLUZION:

I nderuar Prokuror,

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht mbi fakte dhe prova se personat e kallëzuar prej nesh dhe persona të tjerë të pidentifikuar me gjeneralitete të tyre, kanë konsumuar elementët e veprave penale të lartpërmendura.

Për pasojë, duke paraqitur këtë kallëzim, ftojme Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), të veprojë me urgjencë për vënien para përgjegjësisë penale të personave të kallëzuar dhe për të ndërprerë këtë aktivitet të paligjshëm.



Partia Demokratike

Përfundimisht, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) kërkohet:

- Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasve Vjollaca Qako, Sonil Sulo Pine, Artur Sardi dhe personave të tjerë që do të rezultojnë me përgjegjësi penale, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë të rrethanave të parashtruara më sipër.

Me respekt,

KALLËZUESI:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE
përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Z. Flamur NOKA

PROVAT BASHKËNGJITUR:

Foto dhe video të datës 24/04/2025



Partia Demokratike

KALLËZIM PENAL

Tiranë, më ____/____/2025

KALLËZUES:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË,

përfaqësuar nga _____

Adresa për efekt komunikimi: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë

Email: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI:

Kallëzim i veprave penale "Pengimi i subjekteve zgjedhore" parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal, "Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve" parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal, "Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor" parashikuar nga neni 326/a i Kodit Penal, "Shkelja e fshehtësisë së votimit" parashikuar nga neni 327 i Kodit Penal, "Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar" parashikuar nga neni 327/a i Kodit Penal, "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje" parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal, "Pengimi i zgjedhësit" parashikuar nga neni 330 i Kodit Penal, "Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit" parashikuar nga neni 331/a i Kodit Penal

KUNDËR:

Shtetasit Afrim Avdiaj

Çdo shtetas tjetër, ende i paidentifikuar deri më tani, i cili nga ky hetim do të rezultojë me përgjegjësi penale.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

Neni 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 329, 330 dhe 331/a të Kodit Penal

DREJTUAR:

PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK

I nderuar zoti Prokuror,

E nderuar zonja Prokurore

Unë kallëzuesi subjekti politik "Partia Demokratike", kam rënë në dijeni të veprimtarisë penale të parashikuar nga dispozitat si më sipër të Kodit Penal, për të cilat ekziston dyshimi serioz se mund të jenë konsumuar dhe do të konsumohen në të ardhmen nga personi i

kallëzuar, nëse ai nuk ndalohet dhe ndëshkohet nga organet ligjzbatuese sa më shpejt të jetë e mundur.

Ky kallëzim penal është një thirrje urgjente e cila duhet trajtuar seriozisht nga ana juaj dhe për të cilën duhen filluar menjëherë hetimet për të zbardhur ngjarjen dhe për të vënë para përgjegjësisë ligjore personin e kallëzuar.

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim kallëzimin për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprave penale.

RRETHANAT DHE FAKTET:

Në kuadër të procesit të votimit për shtetasit shqiptarë rezidentë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është vënë re se një person me përkatësi të njohur politike si simpatizant i Partisë Socialiste, ka bashkëvepruar ose bashkëpunuar në mënyrë të dyshimtë me përfaqësues të shoqërisë DHL Internacional Albania shpk, e cila është autorizuar për të shpërndarë zarfet e votimit për emigrantët.

Nga informacionet që kemi në dispozicion ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ky person:

- Po ndikon në mënyrë të njëanshme dhe të paautorizuar në shpërndarjen e materialeve zgjedhore;
- Po selekton votuesit sipas bindjes politike;
- Po merr ose manipulon të dhëna personale të votuesve;
- Po ushtron presion të drejtpërdrejtë ose indirekt mbi votuesit;
- Po tenton të devijojë vullnetin e lirë të zgjedhësve për të favorizuar Partinë Socialiste.

Këto veprime përbëjnë cënim serioz të procesit zgjedhor sipas standardeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe shkelje të një sërë nenesh të Kodit Penal.

Personi i kallëzuar është shtetas shqiptar me banim në Kretë, Greqi. Afrim Avdiaj është një nga drejtuesit e shoqatave më aktive të emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe në rrjetin e tij social ai shpreh publikisht mbështetjen e tij ndaj Partisë Socialiste.

Në postimet e tij ai shpreh se *“Asnjë votë nuk do shkojë dëm këtu në Kretë..”* dhe *“Vota për Partinë Socialiste është çështje kombëtare”*.

Por përveç kësaj, në një nga postimet publike të personit të kallëzuar rezulton se, është bërë ky njoftim:

“Mbas shumë bisedimesh me strukturat e larta të postës DHL, por edhe me postat e tjera të cilat ka ngarkuar kjo postë për dorëzimin e zarfeve për zgjedhjet në kuvendin e Shqipërisë, organizata jonë arriti në marrëveshje që qendrat postare në Hania do jenë hapur ditën e Shtunë dhe të Dielë deri në orën 14:00. Kjo të nderuar bashkëatdhetarë ndodh për shkak të fluksit të madh që ka prefektura e Hantiasë në këto zgjedhje. Ju lutemi vëllezër dhe motra, mos lejoni asnjë votë të shkojë dëm. Faleminderit”.

Ky postim është shpërndarë në rrjetin social Facebook edhe nga faqja me emrin Komuniteti Shqiptar Hania.

Një tjetër postim i të kallëzuarit është:

“Të nderuar bashkëatdhetarë,

Për shkak se në postën e Haniatë SPEEDEX ndodhen shumë zarfe me nr tel të gabuar, ju lutemi të paraqiteni pranë kësaj zyre postare për ti terhequr vet zarfet tuaja. Për të tërhequr zarfin duhet pasaporta, ose një dokument ku verifikon të dhënat tuaja. Adresa PARTHENIU KELAIDHI 60”.

Bashkëlidhur tekstit, personi i kallëzuar ka bashkëlidhur edhe foto, të cilat do t'i vendosim në dispozicionin tuaj për gjykim.

Për këto deklarime publike të personit të kallëzuar, kemi bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshem se ky person ka kryer veprat penale të shënuara në objektin e këtij kallëzimi dhe do të vazhdojë t'i kryejë në të ardhmen nëse ndaj tij nuk regjistrohet menjëherë ky kallëzim penal dhe nuk vihet para përgjegjësisë ligjore.

Për sa parashtriam më sipër evidentohet qartazi nga rrethanat dhe provat bashkëngjitur këtij kallëzimi, se personi i kallëzuar ka konsumuar elementët e veprave penale të cituara më sipër.

JURIDIKSIONI, KOMPETENCA DHE KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM:

Juridiksioni:

Neni 69/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”. Duke qenë se kemi të bëjmë me konsumimin e një veprë penale të parashikuar nga Kodi Penal, vlerësojmë se jemi përpara juridiksionit penal.

Kompetenca lëndore:

Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon:

- a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;
- b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;
- c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
- ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.

Ligji i zbatueshëm:

Neni 280 i K.Pr. Penale

Marja dijeni për veprën penale

“Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.

Neni 283 i K.Pr. Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

“1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policies gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

Neni 325 i Kodit Penal

Pengimi i subjekteve zgjedhore

Pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore, dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet

Neni 326 i Kodit Penal

Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Neni 326/a i Kodit Penal

Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor

Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatit e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet.

Neni 327 i Kodit Penal

Shkelja e fshehtësisë së votimit

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e zgjedhësit, nëpërmjet fotografimit të fletës së votimit, ose filmimit të saj, ose dokumentimit me çdo mjet dhe formë

të mënyrës sesi ka votuar, shfaqjes së tyre tek persona të tjerë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet nga një vit deri në katër vjet me burgim.

Neni 327/a i Kodit Penal

Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një gjer në tre vjet.

Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj veprë nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Neni 328 i Kodit Penal

Korrupsioni aktiv në zgjedhje

Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

Neni 329 i Kodit Penal

Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 330 i Kodit Penal

Pengimi i zgjedhësit

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet

Neni 331/a i Kodit Penal

Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit

Dhënia e dokumentit të identifikimit me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, garantimin e mospjesëmarrjes në votime, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve të tjerë, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, moslejimin për të votuar, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

ANALIZA LIGJORE:

Në bazë të rrethanave dhe provave të paraqitura, dyshojmë se personi i kallëzuar mund të ketë kryer ose është në përpjekje për të kryer veprat penale të mëposhtme:

1. Pengimi i subjekteve zgjedhore – neni 325 i Kodit Penal;
2. Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe i rezultateve të zgjedhjeve – neni 326;
3. Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor – neni 327;
4. Shkelja e fshehtësisë së votimit – neni 328;
5. Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar – neni 329;
6. Korrupsioni aktiv në zgjedhje – neni 328/a;
7. Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje – neni 328/b;
8. Pengimi i zgjedhësit – neni 330;
9. Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit – neni 331.

Duke qenë se ndodhemi afër datës së mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj për të respektuar dhe realizuar të drejtën e votës për shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në cilësinë e institucionit të ngarkuar me ligj për këtë detyrë, ka lidhur një marrëveshje dhe ka kontraktuar operatorin DHL Internacional Albania shpk, i cili do të kryejë shërbimin e dërgimit të fletëve të votimit tek votuesit dhe kthimit mbrapsht në KQZ.

Pra DHL Internacional Albania shpk është i vetmi operator i ngarkuar nga KQZ për të realizuar shërbimin e dërgimit të fletës së votimit të zgjedhësit jashtë Shqipërisë.

Në dijeninë tonë, nuk kemi informacion nëse ne marrëveshjen midis KQZ dhe DHL Internacional Albania shpk ekziston ndonjë parashikim i cili lejon këto të fundit të bashkëpunojë me ndonjë zyrë postare tjetër për të mundësuar dërgimin e fletëve të votimit të zgjedhësit jashtë vendit.

Fakti që personi i kallëzuar deklaron se ka biseduar dhe ka rënë dakord me strukturat e DHL Internacional Albania shpk për të marrë pjesë në procesin e dërgimit, të mbledhjes dhe shpërndarjes së zarfave të zgjedhësive, automatikisht sjell lindjen e dyshimit për ligjshërinë e këtij aktiviteti.

Në këtë kuadër, ne kemi dyshime se, *a lejohet që DHL Internacional Albania shpk të nënkontrakttojë subjekte të tjera jo postare në veprimtarinë e shpërndarjes, dërgimit të zarfave në adresën e zgjedhësve dhe mbledhjen e tyre? A e përmban marrëveshja midis KQZ dhe DHL Internacional Albania shpk këtë parashikim? Nëse jo, ndodhemi në kushtet kur personi i kallëzuar po vepron në shkelje të ligjit, pasi DHL Internacional Albania shpk nuk ka asnjë tagër nga KQZ për të bashkëpunuar me subjekte të tjera për këtë aktivitet. Dhe nëse marrëveshja parashikon një autorizim të tillë, shtrohet pyetja, mbi çfarë vlerësimi dhe kriteresh përzgjidhet një operator ose subjekt tjetër për të bashkëpunuar me DHL Internacional Albania shpk në këtë aktivitet? A duhet të ketë një parashikim të tillë që nuk lejohet të përfshihen në këtë aktivitet subjekte të cilët shprehin hapur bindjet e tyre politike, siç është rasti i personit të kallëzuar?*

Në kontekstin ku një person simpatizant i Partisë Socialiste bashkëpunon me përfaqësues të DHL për të shpërndarë zarfa të votimit për emigrantët, ekziston dyshimi i arsyeshëm se mund të ndikojë në mënyrë të paligjshme për të favorizuar këtë parti.

Për veprën penale “Pëngimi i subjekteve zgjedhore” parashikuar nga neni 325 i KP, personi i kallëzuar:

- Mund të pengojë shpërndarjen e zarfeve të votimit për zgjedhësit e partive të tjera duke i “humbur” ose vonuar qëllimisht zarfat.
- Mund të informojë përfaqësues të Partisë Socialiste për afatet apo proceset aktuale duke mbajtur të paimformuar partitë e tjera.
- Mund të ndërhyjë në rrjedhën e komunikimeve mes DHL dhe përfaqësuesve të partive të tjera, duke devijuar njoftime të rëndësishme.
- Mund të kryejë veprime që favorizojnë Partinë Socialiste në shpërndarjen e zarfave dhe votimin, ose bllokojë dhe vonojë materialet e partive kundërshtarë duke sjellë pengesa ndaj barazisë zgjedhore.

Për veprën penale “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve” parashikuar nga neni 326 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të ndërhyjë në përmbajtjen e zarfeve, duke zëvendësuar fletët e votimit ose duke i hapur e ridërguar ato.
- Mund të falsifikojë nënshkrime, vula ose elementë sigurie në dokumentacionin që shoqëron fletët e votimit.
- Mund të ndërrojë zarfa të votuesve që dihet se nuk votojnë PS.
- Mund të komandojë mbledhjen e të dhënave të votuesve dhe t’i dërgojë ato për përpunim politik për të ndikuar në rezultatin final.

Për veprën penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor” parashikuar nga neni 327 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të grisë, njollosë apo dëmtojë fletët e votimit për të anuluar votat që nuk i shërbejnë qëllimeve të tij politike.
- Dëmtimi mund të ndodhë edhe në formë më të rafinuar, p.sh., duke palosur gabimisht fletën që ajo të cilësohet si e pavlefshme.
- Mund të fshehë apo asgjësojë zarfa për të mos lejuar që vota të arrijë në KQZ.

Për veprën penale “Shkelja e fshehtësisë së votimit” parashikuar nga neni 328 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të kërkojë që votuesit t’i dërgojnë foto të votës së hedhur për të provuar se kanë votuar për PS.
- Mund të ndihmojë në përgatitjen ose mbushjen e fletës së votimit për emigrantët në mënyrë që ai të dijë paraprakisht për kë po votohet.
- Mund të ofrojë “ndihmë” për plotësimin e fletës së votimit, duke imponuar votimin për PS.

Për veprën penale “Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar” parashikuar nga neni 329 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të përdorë të dhënat personale të emigrantëve që nuk ndodhen në Shqipëri dhe të votojë në emër të tyre.
- Mund të lejojë votimin më shumë se një herë për personat që janë mbështetës të PS duke siguruar vota për këtë parti.
- Mund të shpërndajë zarfa në mënyrë selektive vetëm tek personat që votojnë për PS

Për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328/a i KP personi i kallëzuar:

- Mund të ofrojë para ose përfitime të tjera materiale (p.sh. punësim, favore administrative) në këmbim të votës për PS.
- Mund të përdorë pozicionin e vet për të premtuar shërbime publike ose ndihmë sociale ndaj atyre që votojnë PS.
- Mund të përdorë ndikimin e tij për të favorizuar votues që kanë PS

Për veprën penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” parashikuar nga neni 328/b i KP personi i kallëzuar:

- Mund të kërcënojë personat që nuk votojnë për PS me pasoja në rast se votojnë ndryshe
- Kanosja mund të jetë edhe indirekte, përmes shantazheve psikologjike ose presionit social në komunitetet e emigrantëve.
- Në raste ekstreme, mund të shfaqë sjellje agresive ndaj përfaqësuesve të subjekteve të tjera ose mbështetësve të tyre.

Për veprën penale “Pengimi i zgjedhësit” parashikuar nga neni 330 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të bllokojë ose vonojë shpërndarjen e zarfeve të votimit për individë që dihet se mbështesin parti të tjera.

- Mund të dezinformojë votuesit për afatet apo procedurat e votimit, duke i bërë të humbin të drejtën e votës.
- Mund të përdorë intimidim ose ndikim për t'i bindur të mos votojnë

Për veprën penale “Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit” parashikuar nga neni 331 i KP personi i kallëzuar:

- Mund të kërkojë dokumente identifikimi nga emigrantët nën pretekstin e “ndihmës për votimin”, për t'i përdorur më pas për manipulim.
- Mund të mbajë kopje të ID-ve dhe të votojë në emër të tyre, duke përdorur mjetet e identifikimit për qëllime të jashtëligjshme.

Këto veprime penale si më sipër përfaqësojnë një kërcënim serioz për legjitimitetin dhe funksionimin e zgjedhjeve në një shtet demokratik për arsyet se:

1. Cënojnë parimin e sovranitetit popullor

Në një shtet demokratik, pushteti buron nga populli, përmes votës së lirë. Çdo ndërhyrje në këtë proces (si manipulimi i votës apo presioni mbi zgjedhësin) zhbën të drejtën bazë të qytetarëve për të vendosur mbi qeverisjen, e sanksionuar në Kushtetutë.

2. Shkelin parimet e barazisë dhe transparencës zgjedhore

Veprat penale të mësipërme, favorizojnë PS dhe diskriminojnë partitë e tjera në garën zgjedhore, duke shkelur barazinë e subjekteve zgjedhore dhe deformuar rezultatin final.

3. Sjellin rritjen e mosbesimit publik

Kur qytetarët shohin se vota e tyre manipulohet ose se zgjedhjet janë të paracaktuara, humbet besimi te vota e lirë, te drejtësia, te shteti ligjor dhe demokratik, e cila ul pjesëmarrjen e zgjedhësve dhe fuqizon apatinë politike. Demokracia bëhet vetëm formale, jo reale.

4. Sjellin destabilitet politik dhe social

Zgjedhjet e manipuluar prodhojnë institucione që nuk përfaqësojnë vullnetin real të qytetarëve. Kjo çon në përplasje politike, protesta, polarizim social, dhe ndonjëherë edhe dhunë apo delegjitimim ndërkombëtar.

5. Minojnë sundimin e ligjit

Kur ligji nuk zbatohet për krime zgjedhore, përforcohet kultura e pandëshkueshmërisë. Kjo shkatërron funksionimin e shtetit ligjor, pasi dërgon mesazhin se pushteti mund të merret përmes manipulimit, jo përmes rregullave.

Objekti i veprave penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor për të siguruar votën e lirë, të drejtën e zgjedhjeve dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve në një republikë parlamentare, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.

Nga ana objektive, veprat penale në rastin konkret kryhen me veprime ose mosveprime të kundërligjshme, ato të parashikuara më sipër.

Subjekt i këtyre veprave penale në sistemin e zgjedhjeve mund të jetë çdo person që kryen veprimet e mësipërme për të favorizuar fitoren e një partie politike në zgjedhje dhe penguar zgjedhësit ose partitë e tjera. Kështu që subjekti është i posaçëm dhe është konkretisht Afrim Avdiaj.

Nga ana subjektive, veprat penale në sistemin e zgjedhjeve kryhen me dashje, me paramendim dhe duke dëshiruar ardhjen e pasojave.

KONKLUZION:

I nderuar Prokuror;

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht mbi fakte dhe prova se personi i kallëzuar prej nesh dhe persona të tjerë të paidentifikuar që mund të jenë të përfshirë në këtë ngjarje, kanë konsumuar dhe rrezikojnë të konsumojnë në të ardhmen elementët e veprave penale të lartpërmendura.

Për pasojë, duke paraqitur këtë kallëzim, ftojme Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), të veprojë me urgjencë për vënien para përgjegjësisë penale të personit të kallëzuar dhe për të ndërprerë këtë aktivitet të paligjshëm, për më tepër në kuadër të nismës së SPAK për të hetuar pas muajit Janar 2025 me prioritet dhe duke i dedikuar një ekip të caktuar vetëm krimeve zgjedhore.

Përfundimisht, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) kërkojmë:

- Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Afrim Avdiaj dhe personave të tjerë që do të rezultojnë me përgjegjësi penale,
- Kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për identifikimin e personit të kallëzuar dhe rolin e tij në shpërndarjen e materialeve zgjedhore,
- Verifikimin e bashkëpunimit me DHL dhe mënyrën se si po shpërndahen zarfat,
- Marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar cënimin e integritetit të procesit zgjedhor.

Me respekt,

KALLËZUESI:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPERISE
përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Z. Flamur NOKA

PROVAT BASHKËNGJITUR:

- Foto dhe video të postimeve të personit të kallëzuar

- Denoncime të ardhura nga zgjedhësit në Greqi

Nr. 1211 Prot.
Datë. 12.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 6201 Prot./V.M

Tiranë, më 05.05.2025

Lënda: Dërgojmë vendimin për mosfillimin e procedimit penal.

Drejtuar: Znj. Albana Vokshi
Partia Demokratike e Shqipërisë
(Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.11)


TIRANË

Bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të vendimit për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me materialin kallëzues nr.133 datë 30.04.2025.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE
ORGANIZUAR

V E N D I M

PËR MOSFILLIMIN E PROÇEDIMIT PENAL

Në Tiranë, më 08 maj 2025.

Unë, Vladimir Mara, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pasi studiova materialin kallëzues nr.133, datë 30.04.2025,

K O N S T A T O V A:

Se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 30.04.2025 mbi bazën e kallëzimit penal të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Albana Vokshi, të depozituar me shkresën nr.14681 Prot., datë 29.04.2025, ka regjistruar materialin kallëzues Nr. 133 datë 30.04.2025.

I. Rrethanat e faktit

I.1. Shtetasja Albana Vokshi, si përfaqësuese e Partisë Demokratike të Shqipërisë ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kallëzim penal ndaj shtetasve Vjollca Qato, punonjëse pranë zyrës postare Qendër, Maliq, Sonil Pine, punonjës pranë Bashkisë Maliq dhe Artur Sardi, punonjës në pozicionin e shoferit në Bashkinë Maliq, për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal.

I.2. Sipas këtij kallëzimi penal, shtetasja Albana Vokshi, pretendon se në datën 24.04.2025, banorët e zonës kanë vënë re se në Maliq, persona të ndryshëm, me karroca në dorë po transportonin thasë me miell, me mbishkrimet “Farina natyral”, në mbështjellje 25 kg. Të pyetur nga qytetarë të ndryshëm, personat të cilët kishin marrë miellin, kanë thënë se këtë miell mund ta merrije vetëm në këmbim të votës për zgjedhjet e datës 11.05.2025, për subjektin politik Partia Socialiste dhe kandidatëve të tyre. Paketimet me miell në sasi të mëdha mbaheshin të depozituara dhe shpërndaheshin nga ambiente të shtëpive të personave të kallëzuar, personave të cilët njihen në zonë si eksponent politikë të Partisë Socialiste dhe punonjës të institucioneve në territorin e Bashkisë Maliq.

I.3 Në lidhje me këtë fakt, kallëzuesja ka depozituar një cd dhe fotografi nga bancesat e Vjollca Qato dhe Sonil Pine, ku duken të depozituara sasi të mëdha të paketimeve me miell, ku personat e kallëzuar dhe persona të tjerë të paidentifikuar, sipas kallëzimit kanë konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal.

I.4 Po në lidhje me këtë fakt, në datën 25.04.2025, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit janë venë në dijeni nga burime të hapura të publikuara në media, duke bërë këqyrjen e faqes së internetit “Facebook”, ku evidentohet një artikull i publikuar në një status shoqëruar me disa fotografi, tek llogaria e z.Edmond Spaho me funksion deputet i Partisë Demokratike.

miell nga shtëpitë e Sonil Sulo Pine dhe Vjollca Qato. Shihni fotot e maskarenjëve që shpërndajnë miell për vota dhe që pretendojnë të na fusin në Europë. Nesër do ju bëj kallëzim penal në SPAK'

II. Verifikimet e kryera

II.1. Është kryer këqyrje e pamjeve filmike të dërguara nga kallëzuesja, Cd me nr LH3173BA23034411 D6, ngjyrë gri, e markës HP, me mbishkrimin me ngjyrë të zezë *"Bashkia Maliq"*.

II.2. Nga këqyrja e pamjeve filmike të dërguara me anë të një CD-je nga kallëzuesja, identifikohet një shtetas, i cili shfaqet me një karrocë, ku brenda saj ndodhet 1 (një) thes me miell me mbishkrimet *"Farina natyral"*.

II.3. Gjithashtu, nga këqyrja duket një ambient i jashtëm banese private, e rrethuar me kangjella, ku janë të vendosur disa thasë me miell.

II.4 Prokuroria e Posaçme pas komunikimit me Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë në lidhje me këtë fakt, në datën 25.04.2025 janë kryer verifikimet përkatëse, të cilat më pas i janë bashkëngjitur akteve të këtij materiali kallëzues. Për sqarimin e rrethanave të faktit është marrë deklaram shtetasve Difiruz Pino, bashkëshorte e Sonil Pino, Benereta Pashollari, Afërdita Jaupi, Bukurie Canellari, Avdi Mecani, Plator Collaku.

II.5 Në datën 26.04.2025, nga hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit është bërë këqyrja e të dhënave në faqen zyrtare në internet të Kishës Ungjillore Libonik, Maliq.

II.6 Në datën 06.05.2025 nga hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit është marrë deklaram shtetasit Plator Collaku për sqarim e fakteve dhe rrethanave.

III. Kuadri Ligjor

III.1 Neni 328 i Kodit Penal "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikon se:

"Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet."

Objekt i veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve duke i dhënë një mbrojtje juridike të posaçme me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive vepra penale kryhet me veprime ose mosveprime në çfarëdo forme:

- Me ofrimin ose dhënien e të hollave, të mirave materiale (nuk ka rëndësi shuma e të hollave të ofruar ose të dhëna). Të mirat materiale mund të jenë edhe në formën e dhuratave, ushqimeve, shtrimit e rrugëve, zgjidhjen e problemeve të pronësisë etj.

- Me bërjen e premtimeve për vende pune kryesisht për ata që janë të papunë si dhe favorizime të tjera për ofrim të një vendi tjetër pune, gradime, transferime etj.

Këto forma korrupsioni përdoren me qëllim orientimin e votës dhe shtyrjen për të votuar në një mënyrë të caktuar pro një kandidati të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime ose për

III.2 Neni 328/b i Kodit Penal "Korrupsioni pasiv në zgjedhje" parashikon se:

"Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera në cilëndoformë, për vete ose të tjerët, me qëllim për të dhënë firmën për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet". Objekt i veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve duke i dhënë një mbrojtje juridike të posaçme me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive vepra penale kryhet me veprime ose mosveprime

- Me pranimin e përfitime si të hollave, të mirave materiale. Të mirat materiale mund të jenë edhe në formën e dhuratave, ushqimeve, shtrimit e rrugëve, zgjidhjen e problemeve të pronësisë etj.

- Favorizime të tjera për ofrim të një vendi tjetër pune, gradime, transferime etj.

Këto forma korrupsioni përdoren me qëllim orientimin e votës dhe shtyrjen për të votuar në një mënyrë të caktuar pro një kandidati të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime ose për t'u angazhuar në mbështetjen e një kandidati përmes veprimeve të paligjshme.

III.3 Kodi Zgjedhor (ligji 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar) në nenin 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)" parashikon: "1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimor, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. 3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lrimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lrimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë. 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. 5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike "

IV. Analiza e faktit dhe e ligjit

IV.1 Në kallëzimin penal pretendohet se nga ana Vjollca Qato, punonjëse pranë Zyrës Postare Qendër Maliq, Sonil Pine, punonjës pranë Bashkisë Maliq dhe Artur Sardi, punonjës (shofer) në Bashkinë Maliq po konsumohen element të veprës penale “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*” dhe “*Korrupsioni pasiv në zgjedhje*” parashikuar nga neni 328 dhe 328/b i Kodit Penal.

IV.2. Nga aktet e administruara në funksion të këtij kallëzimi penal, rezulton nga deklarimi i shtetasës Difiruz Pino, bashkëshorte e shtetasit Sonil Pino, deklararon se ajo është anëtare e Kishës Ungjillore dhe ka mbajtur përkohësisht në banesën e saj thasët me miell, në mënyrë që të ti marrin shtetasit Afërdita Jaupi, Bukurie Canellari dhe Avdi Mecani, të cilët janë fqinjët e saj. Gjithashtu deklarim ju është marrë dhe shtetasve Afërdita Jaupi, Bukurie Canellari dhe Avdi Mecani, të cilët deklarojnë se thasët me miell i kanë marrë në kuadër të ndihmave humanitare nga Kisha Ungjillore, me rastin e festave të Pashkëve Ortodokse.

IV.3 Për sqarimin e rrethanave të faktit i është marrë deklarim shtetasit Plator Collaku, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Duart që sigurojnë”, pjesë e “Hands of Providence International”, me qendër në SHIBA. Ai deklararon se misioni kryesor i këtij fondacioni është ndihma humanitare, krijimi i qendrave rezidenciale si dhe mbështetja e fëmijëve jetim, ndihma e shtetasve në nevojë, të mëshuar apo njerëz me ndihmë ekonomike.

Ai deklararon se në datën 24.04.2025 është vënë në dijeni nga gazetari Xhensil Shkëmbi, për disa fotografi që ishin shpërndarë, ku shfaqeshin disa të moshuar, të cilët kanë pasur thasë me miell dhe sipas postimit ishin shpërndarë me qëllime elektorale. Ai deklararon se këtë sasi mielli e kanë siguruar nga fondacioni në datën 15.04.2025 dhe janë shpërndarë disa shtetasve për festën e Pashkëve, nga punonjësja Benereta Pashollari. Ai thekson se disa thasë janë dërguar nëpër banesa dhe një pjesë e tyre është lënë në banesën e një shtetasi, për shkak se të moshuarit nuk gjendeshin në atë lagje dhe nuk kanë patur mundësi për ti tërhequr vetë pranë kishës. Përveç këtyre rasteve, ai deklararon se janë shpërndarë dhe thasë me miell për familjet në nevojë, të cilët frekuentojnë kishën.

IV.4 Në vijim të verifikimeve është pyetur shtetasja Benereta Pashollari, e cila deklararon se është e punësuar prej 6 vitesh si kujdestare në “ Qendrën Rezidenciale e Djemve” në Maliq dhe njëkohësisht bën punë të ndryshme vullnetare humanitare pasi është anëtare e Kishës. Në deklarim ajo sqaron se ndajnë ndihma të ndryshme humanitare për anëtarët dhe frekuentuesit e kishës si dhe për njerzit në nevojë, ku konkretisht së fundmi kanë dhënë disa thasë me miell për cdo familje. Pasi është informuar në lidhje me lajmin e publikuar në rrjete sociale se këto ndihma janë shpërndarë për qëllime elektorale, ajo shprehet se ndihet e ofenduar që misioni është përbaltur. Në lidhje me këtë rast, deklararon se së bashku me disa shtetas të tjerë, anëtarë të Kishës, disa thasë miell janë lënë në banesën e shtetasit Sonil Pino, për shkak se aty jetojnë disa të moshuar që frekuentojnë Kishën. Në vijim të deklarimit kjo shtetase spjegon se nuk ka asnjë lidhje politike dhe misioni humanitar nuk ka lidhje me këtë pjesë.

IV.5 Në kuadër të veprimeve paraprake, nga ana e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, në datën 25.04.2025 është administruar një kopje e faturës datë 14.04.2025 nga fondacioni “Shpresë

“Fondacioni ‘Shpresë për Shqipërinë’, në kuadër të Krishtlindjes dhe të Pashkëve, festave simbolike të Krishtërimit, organizon projektin e dhurimit të thasëve të miellit, projekt i cili përfshinë disa Kisha/Fondacione në Shqipëri në qytete të ndryshme. Ky projekt ka filluar vite më parë dhe vazhdon besnikërisht çdo vit. Gjithashtu për javën e Pashkës 2025 sërish HFA ka shpërndarë thasë me miell dhe ndër të cilat i janë dërguar edhe Kishës Ungjillore Maliq, për ti ndarë në komunitet në zonën e tyre”. Bashkëngjitur këtij emaili ndodhet dhe fatura me përmbajtjen e ngarkesës (miell-sasia 100).

IV.6 Bashkëngjitur kësaj praktike, është administruar lista emërore, të cilët kanë marrë ndihma humanitare sipas deklarimeve më sipër. Nga këqyrja e kësaj liste, figuron emri i shtetasve Benereta Pashollari, Afërdita Jaupi, Bukurie Canellari etj.

IV.7. Në deklarinimin e datës 06.05.2025, përpara Hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, shtetasi Plator Collaku, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit *“Duart që sigurojnë”*, në lidhje me rrethanat e kallëzimit, sqaron se i ka dërguar një mesazh në aplikacionin *“Ëhatsapp”* shtetasi Xhensil Shkëmbi nëpërmjet të cilit është vënë në dijeni të statusit të shtetasit Edmond Spaho, ku shfaqen fotot e disa personave, të cilët po merrnin thasë me miell. Xhensil Shkëmbi i ka shkruar se në foto shfaqen persona, të cilët frekuentojnë kishën tonë *“Kisha Ungjillore Libonik Maliq”*. Gjatë diskutimit me Xhensil Shkëmbin në aplikacionin *“Ëhatsapp”*, nëse duhet të reagonin ose jo lidhur me këtë status në Facebook, në përfundim vendosën mos të reagonim pasi nuk kishte akuzë për kishën e tyre.

Nga denoncimi i shtetasit Edmond Spaho ishin përmendur shtetasit Sonil Pine dhe Vjollca Qako. Plator Collaku deklaroi se shtetasen Vjollca Qako, e njeh dhe shkon rregullisht në kishën e tyre. Kjo shtetase ka qënë në listën për përfitim të ndihmave. Ata si kishë organizojnë grup grash për organizimin dhe shpërndarjen e ndihmave. Zakonisht këto ndihma i shpërndarjnë për festën e *“Krishtlindjeve”* dhe për *“Pashkë”*. Zakonisht me shpërndarjen e ndihmave merren shtetësja Benereta Pashollari, i biri i Benedetës, Niko Bezhani, Vjollca Qako, bashkëshortja e shtetasit Sonil Pine, e cila quhet Difiruz Pino dhe disa gra të tjera.

Në lidhje me fotografinë në facebook të shtetasit Edmond Spaho, ku shfaqet një zonjë e cila po shtyn një karrocë me një thes miell të përshkruar si *“Farina Natural”*, Plator Collaku deklaroi se zonja quhet Afërdita Jaupllari dhe është anëtare e rregullt e kishës. Gjithashtu është dhe përfutuese e ndihmave të Kishës.

Për sa i përket sasisë së miellit, ai deklaroi se sasinë e miellit e kanë siguruar nga fondacioni *“Hope for Albania”*, me datë 15.04.2025 dhe janë shpërndarë pas festës së *“Pashkës”*.

Ky shtetas shpjegoi se duke qënë se disa nga përfutuesit e ndihmës janë pensionistë dhe nuk kanë mundësi të tërheqin ndihmat, Kisha është organizuar me Benereta Pashollarin nëpërmjet furgonit të Kishës për transportin në lagjen Blloku nr.2, ku në fotot e treguara është shfaqur dhe shtetasja Afërdita Jaupllari.

Shtetasi Plator Collaku deklaroi se shpërndarja e ndihmave për njerëzit në nevojë është puna e tyre e përhershme. Ata kanë shpërndarë në kohën e Covid dhe kanë shpërndarë gjithmonë ndihma. Gjithashtu projekti dhe donatorët e kishin planifikuar shpërndarjen menjëherë pas festës së Pashkës.

IV.8 sa i përket pretendimeve të kallëzueses në këtë material kallëzues për konsumimin e veprës penale *“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”*, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe

krijohej dyshimi i arsyeshëm se jemi përpara një fakti korruptiv të ofrimit/dhënies së shumave monetare apo premtime për vende pune apo përfitime të tjera në këmbim të pjesëmarrjes në votime apo për të votuar në një drejtim të orientuar, ku të jenë përfshirë shtetasit e kallëzuar apo shtetas të tjerë.

Në parashikimin që ligjvënësi ka bërë në nenin 328 të K.Penal kërkohet që vota apo zgjedhësi të jetë i përcaktuar i njohur dhe veprimet e personit të dyshuar t'i jenë kundërtuar, të kenë pasur për objekt një apo disa zgjedhës konkret me qëllim deformimin e vullnetit të tyre. Ofrimi i të mirave ka një qëllim të posaçëm dhe qëllimi është element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale dhe si i tillë duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret, konstatohet se nuk jemi para provave/indicjeve që të mbështesin konsumimin e veprës penale e “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal apo “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal.

IV.9 Duke qenë se qëllimi i shpërndarjes së ndihmave, në rastin konkret, produkti ushqimor miell, rezulton se është si pjesë e një programi social të rregullt të Kishës Ungjillore, dhe jo me qëllim për të ndikuar në procesin zgjedhor. Si rrjedhojë, mungon elementi subjektiv i veprës penale. Gjithashtu, mungon ana objektive e veprës penale të kallëzuar, pasi nuk ka prova që tregojnë se shpërndarja e miellit është e lidhur me kërkesën për votimin në favor të një subjekti të caktuar politik.

IV.10 Sipas, nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shteti është neutral në çështjet e besimit fetar dhe garanton lirinë fetare. Organizatat fetare lejohen të ushtrojnë veprimtari humanitare, edukative dhe sociale, për sa kohë nuk përfshihen në veprimtari politike. Në këtë kontekst shpërndarja e ndihmave nga Kisha është e ligjshme për atë kohë sa ka qëllime humanitare, nuk shoqërohet me thirrje për votë apo mbështetje të ndonjë partie politike si dhe nuk përdoret si mjet për propagandë politike.

Duke qenë se ndihmat e shpërndara, janë kryer në mënyrë të rregullt, pa përfshirje të ndonjë partie politike, pa ftesë për të votuar për një parti/kandidatë politik dhe shoqëruar me akte të dokumentuara, nuk ndodhemi përpara ndonjë veprë penale.

Pra, nga aktet dhe të dhënat e paraqitura si dhe ato të administruara, nuk evidentohet se janë ofruar apo dhënë të mira materiale, apo se janë kërkuar ose pranuar të mira materiale etj, me qëllim dhënien e ndonjë firme për paraqitje kandidati në zgjedhje apo për të votuar në një mënyrë të caktuar.

Ndodhur në këto kushte, mbi bazë të akteve të administruara gjatë veprimeve verifikuese nuk evidentohen të dhëna të tilla që të provojnë kryerjen e veprave penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” apo “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” të parashikuara nga nenet 328 dhe 328/b të K.Penal.

IV.11. Sa më sipër u arsyetua, organi procedues vlerëson se nuk ka të dhëna për fillimin e procedimit penal për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal, për sa kohë nuk u konstatua asnjë indicie me vlerë provuese, në këtë drejtim, apo vepra të tjera penale në kompetencë lëndore nga Prokuroria e Posaçme dhe për rrjedhojë procedimi penal nuk mund të fillojë.

Neni 290 i K.Pr. Penale parashikon: “*Procedimi penal nuk mund të fillojë kur... pika ç... fakti*

Nga sa më sipër, procedimi penal nuk mund të fillojë, pasi fakti nuk përbën veprë penale. Kjo pasi nga analiza e fakteve dhe provave të sipërcituara rezulton se faktet e pretenduara nga kallëzimet nuk përmbajnë elementë të figurës të veprës penale "Korrupsionit aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, "Korrupsioni pasiv në zgjedhje" parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal, apo ndonjë veprë tjetër penale.


Për këto arsye mbështetur në nenet 290/1 gërma ç) dhe 291/1/2 të K.Pr.Penale:

V E N D O S A:

1. Mosfillimin e procedimit penal, që ka të bëjë me kallëzimin penal nr. 133 datë 30.04.2025.
2. Të njoftoj me këtë vendim kallëzuesen, e cila ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI

VLADIMIR MARA





Partia
Demokratike

Nr. 284 prot.

Tiranë, më: 30 . 04 . 2025

INFORMACION MBI FAKTE TE RENDA PENALE

Referues: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Flamur Noka.
Adresa për efekt komunikimi: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë,
email: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI: Informacion mbi veprën e “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”
parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal

KUNDËR:


1. Besa Spaho, kandidate për deputete në Qarkun Korçë
2. Ervis Kocileri, Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), në Drejtorinë Rajonale Korçë
3. Daniela Fejzulla Lico, Drejtoreshë e Tatimeve Korçë

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale;
Neni 328 i Kodit Penal

DREJTUAR: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR– SPAK

I nderuar zoti Prokuror / E nderuar zonja Prokurore!

Unë kallëzuesi, subjekti politik “Partia Demokratike”, kam rënë në dijeni të informacionit mbi fakte të rënda penale, për të cilën ekziston dyshimi serioz se mund të jetë konsumuar nga ana e personave të cituar më sipër prej nesh.



Partia Demokratike

Në kushtet kur përveç informacionit të marrë nga persona të ndryshëm, nuk kemi mundësinë e paraqitjes të provave konkrete, ju vëmë në djeni për aktivitetin e paligjshëm të ushtruar nga këta persona dhe kërkojmë nga ana juaj kryerjen e veprimeve proaktive, të cilat ju si institucion ~~keni~~ mundësinë dhe të drejtën për t'i kryer, duke vepruar me urgjencë

për vënien para përgjegjësisë penale të personave të cituar dhe për të ndërprerë këtë aktivitet të paligjshëm.

Informacioni mbi faktet e rënda penale.

1. Në datën 27 Mars 2025, kandidatja për deputete e Qarkut Korçë Besa Spaho, së bashku me Drejtorin e AKU Korçë, Ervis Koçileri kanë shkuar në Tavernën "Shtëpia e Traditës", në fshatin Zape, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë. Në këtë restorant kanë shkuar dhe pronarë të bizneseve të cilat janë subjekt kontrolli permanent, i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
Nga informacioni i marrë, ju është ofruar, premtuar biznesmenëve, favorizimi nga ana e institucionit të AKU, në këmbimit të votës së tyre dhe ndikimi tek punonjësit e tyre, për të votuar kandidaten për deputete Besa Spaho.
2. Në datën 24 Prill 2025, kandidatja për deputete e Qarkut Korçë Besa Spaho, së bashku me ekipin e saj kanë zhvilluar aktivitet politik në fshatin Mborje, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë. Pas mbarimit të aktivitetit politik, ka shkuar në disa dyqane ushqimore dhe ka paguar listën e borxheve të personave të cilat kishin marrë produkte në dyqane dhe nuk i kishin paguar. Ky veprim i shtetases Besa Spaho, është bërë me qëllim që personat të cilat kishin këto pagesa të pakryera, të votojnë në zgjedhjet e 11 maj 2025, kandidaten Besa Spaho.
3. Gjatë të gjithë muajit Prill 2025, me urdhër të titullarëve/përgjegjësve të ASHK Korçë-Devoll-Ersekë Korçë dhe kandidates Besa Spaho (e cila ka mbajtur pozicionin e Drejtoreshës së Drejtorisë Vendore, të ASHK-së Korçë) kanë dalë në terren punonjësit e këtij institucioni; duke shkuar në personat dhe familjet të cilat kanë aplikuar për legalizim të ndërtimeve informale, pranë ish ALUIZNI dhe ASHK. Këta punonjës kanë premtuar legalizimin e objekteve, në këmbim të votës për kandidaten për deputete Besa Spaho. Ky fenomen ka ndodhur veçanërisht në zonën e Bashkisë Maliq. Gjithashtu, për të mos u identifikuar nga ana e qytetarëve



Partia Demokratike

është vënë re se, punonjësit të cilët detyrat funksionale i kanë në zyrat e ASHK Korçë, kanë zvendësuar punonjësit të cilët detyrat funksionale i kanë në terren.

4. Në datën 7 Prill 2025 dhe në vazhdim, titullarja e Drejtorisë Tatimore Korçë Daniela Lico, ka shoqëruar kandidaten Besa Spaho në ambientet e biznesit "Bujtinë" të shtetasit Sotir Guri, në fshatin Polenc (fakt i publikuar dhe në rrjetin social të kandidates Besa Spaho), ku kërkon votën për këtë kandidatë. Gjithashtu, drejtoresha Daniela Lico, kërcënon bizneset në qytetin e Korçës, duke premtuar se do aplikojë masa ndëshkuese, për subjektet që nuk do votojnë kandidaten Besa Spaho.

KONKLuzion:

I nderuar Prokuror!

Me anë të këtij informacioni, kërkojmë nga ana juaj, kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim dokumentimin e fakteve penale dhe për vënien para përgjegjësisë penale të personave të cituar dhe për të ndërprerë këtë aktivitet të paligjshëm.


Me respekt,

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

PËRFAQËSUAR NGA

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flamur NOKA





Partia Demokratike

KALLËZIM PENAL

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 18/04/2025

KALLËZUES: Flamur Noka, Deputet i Partisë Demokratike, nënshkruar i këtij kallëzimi, Adresa për efekt komunikimi: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë, email: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI: Kallëzim i veprave penale parashikuar nga neni 328/a "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore" dhe neni 248 "Shpërdorimi i detyrës" të Kodit Penal të ndryshuar

KUNDËR: Erion Isai, me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë

Çdo shtetasi të identifikuar në këtë kallëzim dhe ende të painedifikuar deri më tani, i cili nga ky hetim do të rezultojë me përgjegjësi penale.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Neni 246 dhe 328/a të Kodit Penal të ndryshuar;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale;
Kodi Zgjedhor (neni 91 e në vijim)
Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"
Ligji nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore"

DREJTUAR: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK

*Të nderuar Prokurorë të SPAK,
I nderuar Z. Dumani, Drejtues i SPAK,*

Unë kallëzuesi subjekti politik "Partia Demokratike", Dega Tiranë, ditët e fundit kam rënë në dijeni të veprimtarisë penale të parashikuar nga nenet 246 dhe 328/a të Kodit Penal të ndryshuar, për të cilat kemi bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se janë konsumuar nga Erion Isai me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë.

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim këtë kallëzim për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore

penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprave penale.

RRETHANAT DHE FAKTET:

Kemi vendosur të paraqesim sot në SPAK këtë kallëzim penal ndaj shtetasit Erion Isai me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë, nisur nga shkeljet e Kushtetutës dhe Kodit Penal, veprime këto të kryera në dëm të deputetëve të opozitës dhe të qytetarëve shqiptarë.

Partia Demokratike ka marrë dijeni se personi i kallëzuar ka kryer një sërë veprimtarish të ndaluara nga Kodi Zgjedhor, Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator pranë KQZ, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Kodit Penal.

Subjekti i kallëzuar ka nisur fushatën elektorale në diasporë dhe në qytetet në Shqipëri, në mbështetje të Partisë Socialiste, kandidatëve të saj për deputet dhe Kryeministrit Edi Rama, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, duke shkelur ligjin, shpërdoruar detyrën, fondet publike dhe funksionin e tij si funksionar i administratës vendore.

Konkretisht, në datën 15 Shkurt 2025, subjekti ka qenë në Volos, Greqi, në takim me një familje shqiptare në shtëpinë e tyre, dhe në këtë postim ai ka përdorur hashtag #PartiaSocialiste. Duke parë me anë të veprimeve të tij mbështetjen e madhe për Partinë Socialiste në këto zgjedhje, ne kemi bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se Erion Isai ka përdorur pushtetin e tij si kryetar bashkie për të ndikuar në bindjen politike të kësaj familjeje. Si mund të shpjegohet ndryshe ky takim në shtëpinë e zgjedhësve dhe përdorimi i këtyre simboleve, hashtageve?

Ne dyshojmë se këto simbole janë me natyrë dhe përmbajtje politike dhe se subjekti në fjalë i ka përdorur me qëllimin e qartë për të treguar mbështetjen për Partinë Socialiste, gjë e cila është në kundërshtim me ligjin.

Në datën 24 Shkurt 2025, Erion Isai ka zhvilluar një takim në Athinë, me shqiptarët që jetojnë atje. Mbishkrimi i tij në foto është "voto nga shtëpia...". Nuk mund të pretendojmë se ky shkrim nuk ka përmbajtje politike dhe që nuk lidhet me zgjedhjet e datës 11 Maj. Edhe këtë herë, roli i Erion Isait ka qenë ndikimi të zgjedhësit për të votuar Partinë Socialiste.

Në datën 1 Mars ka postuar foto me shkrimin "*Nje kafe me disa familje nga Kolonja qe jetojne dhe punojne ne Londer. Ditet e fundit te regjistrimeve vijojme te shtojme patriotet tane ne shkundjen e mandatit te 4-t qe po vjen*". Në dijeninë tone, jemi në prag zgjedhjesh për Kuvend dhe mandati i katërt referohet si mbështetje për Partinë Socialiste.

Një postim tjetër i Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, i cili prej muajsh ka harruar detyrën e cila i është besuar dhe për të cilën paguhet, është një takim në Mollas, me strukturat e PS. Fotoja shoqërohet me shkrimin "*Mollas/ me strukturat e PS per te nisur vrullin e perbashket per ti sjelle Partise Socialiste 7 mandate nga Qarku Korce, e per te mos ndalur ne vrapin qe vetem Edi Rama dhe (trendafil) di te beje per Shqiperine drejt Bashkimit European. Tek -sa*". Nga ky shkrim kuptojmë se Erion Isai është angazhuar në fushatë politike në mënyrë serioze dhe duket se nuk e tremb as ligji dhe as pasojat e tij. Fjalja "*Per ti sjelle Partise Socialiste 7 mandate nga Qarku Korce*" nënkupton se subjekti është angazhuar në veprimtari që lidhen me mbështetjen dhe promovimin e kandidatëve për deputet për Qarkun Korçë. Vendosja e shenjës së dorës jo rastësisht, përkon të jetë numri 5 që Partia Socialiste do të ketë në fletën e votimit. Edhe për këtë rast, ne kemi bindjen e plotë se jo vetëm postimi por edhe gjithë veprimtaria e Erion Isai lidhet ngushtë me zgjedhjet e 11 Majit dhe mbështetjen e Partisë Socialiste.

Në një postim tjetër, Erion Isai ka shpërndarë foto të një takimi të Kryeministrit që ka realizuar në Athinë me zgjedhësit. Shkrimi krahas fotos është *"Miremenges me atmosferen dhe që Shqiptaret e Athinës i përshiten Edi Rama dhe Partia Socialiste. Mandati i katërt është autostrada e shpejtesise drejt Bashkimit Europian"*. Citimi në çdo postim i Edi Ramës, Partisë Socialiste dhe mandatit të katërt nuk mund të jetë një rastësi. Të gjitha aktivitetet në të cilat Erion Isai ka marrë pjesë duke treguar mbështetjen dhe favorizimin për Partinë Socialiste, ndërkohë që është në detyrë në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Kolonjë, njëkohësisht punonjës i administratës vendore, tregojnë se ligjet në vendin tonë nuk zbatohen dhe sa kohë partia në pushtet të kontrollojë institucionet, persona të tillë si Erion Isai do të vazhdojnë të shpërdorojnë detyrën dhe të mos ndëshkohen.

Në një postim, subjekti i këtij denoncimi ndër të tjera, ku përmend Edi Ramën dhe Partinë Socialiste, ka shkruar *"...ma shton përgjegjësinë për të sjellë në 11 maj një rezultat edhe më spektakolar"*.

Në 20 Mars, Erion Isai ka shoqëruar në një takim Niko Peleshin, i cili është i angazhuar në detyrë pranë Byrosë së Kuvendit, Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Sekretariatit për Marrëdhëniet me Jashtë për Partinë Socialiste, njëkohësisht kandidat për deputet. Madje në foto duket Erion Isai duke folur me mikrofon para zgjedhësve. Në dyshojmë se edhe në këtë veprimtari, Erion Isai është duke u përdorur për qëllime politike dhe duke ushtruar ndikimin e tij të zgjedhësit, në kundërshtim me ligjin.

Në datën 20 Mars, Erion Isai ka publikuar një postim në të cilin shkruan *"Ne 30 mars ju pres miqtë e shoket tane Kolonjare! Shihemi në 29 Mars në takim të vogël se bashku, dhe në 30 mars me Edi Ramën"*. Subjekti ka vendosur foton e cila tregon numrin 5 që PS do të mbajë në fletën e votimit. Edhe në këtë rast, Erion Isai tregon se po punon dhe mbështet një parti politike të caktuar, gjë e cila bie në kundërshtim me ligjin.

Për të gjitha sa më sipër, ne kemi bindjen e plotë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm i cili mund të vërtetojë të kundërtën, se Erion Isai është i angazhuar në veprimtari politike dhe elektorale në mbështetje të Partisë Socialiste dhe të kandidatëve të saj për deputet për Qarkun Korçë, apo këdo kandidat tjetër të kësaj partie.

Erion Isai ka disa muaj që vepron në shkelje të hapur dhe të rëndë të ligjit, duke takuar, regjistruar në PER dhe duke ndikuar të bindja politike të zgjedhësve që nga muaji Janar 2025 me takimet e tij në Shba, Kanada, Itali, Greqi dhe në qytete në Shqipëri.

Për ne është e rëndësishme të theksojmë se, sjellja e përsëritur e Erion Isait është kthyer në një fenomen, në një precedent të rrezikshëm të shkeljes së ligjit dhe pandëshkueshmërisë së tij nga institucionet përkatëse.

Ne denoncojmë përfshirjen e pushtetit vendor në veprimtari politike dhe në mbështetje të një partie të caktuar, e cila është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe mbi të gjitha me Kodin Penal.

1. Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 91 i Kodit Zgjedhor:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale

apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimi, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:

Neni 6, pika 3:

“Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.

Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:

Neni 7, pika 1:

“1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, perfektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:

d) marrin masa që automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo të institucionit, të ndalohen të përdoren për veprimtari politike e të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje, duke urdheruar parkimin e detyruar të automjeteve në mbarim të orarit zyrtar në ambientet e institucioneve respektive. Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve të dedikuar zyrtarëve të lartë, Shërbimit të Protokollit të Shtetit, të Gardës së Republikës, atyre në shërbim të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale, si dhe rastet e urdhëruara me autorizim për shërbime pune

dh)....ommissis....

e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e:

i) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë elektorale e të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

ii) fondeve të institucioneve për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;

iii) mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;

iv) institucioneve publike për zhvillimin e fushatës zgjedhore apo realizimin e propagandës politike në to;

v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore”

Neni 328/a i Kodit Penal paragrafi i fundit:

“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Neni 248 i Kodit Penal:

“Shpërdorimi i detyrës

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

2. Analiza ligjore

Në kuptim të nenit 91, pika 1 dhe 2, kryetarët e bashkiave konsiderohen burime njerëzore për shkak të angazhimit në detyrë pranë institucionit të bashkisë.

Pjesëmarrja në takime politike për të favorizuar dhe promovuar kandidatët e Partisë Socialiste, në takime të organizuara nga kjo parti, konsiderohet se Erion Isai po funksionon dhe po përdoret si burim njerëzor i institucionit për shkak të detyrës dhe po krijon një precedent të rrezikshëm për shoqërinë dhe demokracinë.

Pjesëmarrja e një kryetari bashkie në takime politike për të mbështetur apo promovuar një kandidat për deputet përbën shqetësim serioz në kuadër të veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, për shkak se:

1. Cënon barazinë në garën elektorale

Kryetari i bashkisë është funksionar publik dhe, në ushtrimin e detyrës së tij, është i detyruar të qëndrojë politikisht neutral. Mbështetja publike e një kandidati apo partie përmes pjesëmarrjes në aktivitete elektorale perceptohet si favorizim institucional, duke ndikuar në barazinë e kandidatëve dhe integritetin e procesit zgjedhor.

2. Shkel detyrimin ligjor për paanshmëri institucionale

Sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", funksionarët vendorë duhet të respektojnë parimin e paanshmërisë politike në ushtrimin e funksioneve të tyre. Angazhimi aktiv në lëshata politike, sidomos nëse bëhet me përdorim të burimeve publike, përbën shpërdorim të detyrës, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

3. Shpërdoron burimet publike për qëllime elektorale

Pjesëmarrja në takime politike me përdorimin e automjeteve të bashkisë, stafit të administratës, fondeve publike apo infrastrukturës bashkiake, përbën shpërdorim të aseteve shtetërore për përfitime politike, e cila ndalohet rreptësisht nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020.

4. Krijon presion mbi administratën publike vendore

Pjesëmarrja e kreut të bashkisë në takime politike për një kandidat të caktuar mund të krijojë presion të tërthortë ndaj nëpunësve civilë të bashkisë dhe zgjedhësve, duke ndikuar në mënyrë të padrejtë në sjelljen e tyre elektorale.

5. Dëmton interesin publik në favor të interesave politike

Pjesëmarrja në takime politike për të favorizuar një parti dhe kandidat të caktuar **nuk përfaqëson interesin e bashkisë apo të qytetarëve** dhe nuk i shërben qëllimit përse kreu i bashkisë ushtron këtë funksion. Pjesëmarrja në takime politike synon mbështetjen dhe përfitimin politik të një subjekti të caktuar, e cila përbën **shkelje të funksionit dhe keqpërdorim të pozitës** dhe përbën elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore.

Në përfundim, vlerësojmë se veprimet e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë kanë ndodhur në mënyrë të organizuar, me vetëdije dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në fushatën politike duke shfrytëzuar pozicionin e tij publik dhe se nga ana e tij janë konsumuar veprat penale ajo e shpërdorimit të detyrës, sipas nenit 248 dhe e përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore sipas nenit 328/a të Kodit Penal.

Partia Demokratike denoncon ashpër këto veprime antiligjore dhe tepër të rrezikshme nga ana e personit të kallëzuar. Administrata nuk është në funksion të politikës, të partive politike dhe të fushatës elektorale të një partie të caktuar. Burimet që institucioni ka në administrim janë vetëm në funksion të ushtrimit të veprimtarisë institucionale dhe nuk janë për përdorim për qëllime politike dhe nga partitë politike.

Legjislacioni shqiptar ndalon përdorimin e administratës publike për qëllime/interesa politike dhe elektorale. Përdorimi i administratës publike për qëllime politike është një çështje e ndjeshme dhe ka të bëjë me etikën dhe ndarjen e pushteteve në një shtet demokratik. Në një shtet të sunduar nga ligji, administrata publike duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme, duke i shërbyer vetëm interesit publik dhe jo interesave personale apo politike të një partie apo individit.

Përdorimi i administratës publike për qëllime politike sjell pasoja serioze për demokracinë dhe funksionimin e institucioneve shtetërore. Shfrytëzimi i burimeve të administratës është një praktikë e dëmshme dhe në shkelje flagrante të ligjeve të një shteti demokratik. Kur administrata përdoret për interesa politike, mund të krijohen mundësi për korrupsion dhe abuzim me pushtetin, si dhe favorizim të individëve ose grupeve me interesa të caktuara.

Në këto kushte, Partia Demokratike kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personin e kallëzuar.

Objekt i veprave penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, të cilat parashikojnë veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Nga ana objektive, veprat penale janë kryer nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme, që përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës dhe që kanë sjellë si pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të shtetasve dhe deputetëve të opozitës.

Subjekti i veprës penale, është subjekt i posaçëm dhe konkretisht Kryetari i Bashkisë Kolonjë Erion Isai.

Nga ana subjektive, veprat penale janë kryer me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçëm ndikimin të vota e lirë dhe bindja politike e zgjedhësve shqiptarë për të favorizuar Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Referuar gravitetit të shkeljeve ligjore të kryera nga ana e personit të kallëzuar, me dashje direkte dhe duke shkelur Kushtetutën, mospërfillur ligjin dhe duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe të opozitës, kërkojmë që regjistrimi i këtij kallëzimi penal të kryhet menjëherë.

KONKLuzion:

Të nderuar Prokurorë,

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht dyshime të arsyeshme të bazuara mbi fakte dhe prova se personi i kallëzuar ka konsumuar elementët e veprave penale të lartpërmendura.

Për pasojë, duke paraqitur këtë kallëzim, ftojmë SPAK të veprojë me urgjencë për vënien para përgjegjësisë penale të personit të kallëzuar.

Përfundimisht, nga ana e SPAK, kërkojmë:

Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Erion Isai me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë për kryerjen e veprave penale parashikuar nga neni neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” dhe neni 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal të ndryshuar, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë të rrethanave të parashtruara më sipër.

Me respekt,

KALLËZUESIT:

PROVAT BASHKËNGJITUR:

1. Kopje Pasaportë ose ID e deputetit
2. Kopje e indicieve, provave ose publikimeve në organet e mediave ku mbështetet kallëzimi



Partia
Demokratike

KALLËZIM PENAL

Nr. 415 Prot.

Tiranë, më 09/05/2025

KALLËZUES:

Partia Demokratike, përfaqësuar nga Deputeti Edmond Spaho, nënshkrues i këtij kallëzimi, *Adresa për efekt komunikimi*: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë, email: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI:

Kallëzim i veprave penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

KUNDËR:

1. Erion Isai, me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë
2. Xhensil Shkëmbi, atësia Ardian, amësia Dallëndyshe, datëlindja 11.05.1999, banues në fshatin Vlocisht-Libonik-Maliq, punësuar pranë Qendrës Kulturore “Fan Stiljan Noli”, Kolonjë

Çdo shtetasi të identifikuar në këtë kallëzim dhe ende të paidentifikuar deri më tani, i cili nga ky hetim do të rezultojë me përgjegjësi penale.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Neni 246, 328 dhe 328/a të Kodit Penal të ndryshuar;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale;
Kodi Zgjedhor;
Ligji nr. 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”

DREJTUAR:

PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK

*Të nderuar Prokurorë të SPAK,
I nderuar Z. Dumani, Drejtues i SPAK,*

Unë kallëzuesi subjekti politik “Partia Demokratike”, ditët e fundit kam rënë në dijeni të veprimtarisë penale të parashikuar nga nenet 246 dhe 328, 328/a të Kodit Penal të ndryshuar, për të cilat kemi bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se janë konsumuar nga Erion Isai me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë dhe Xhensil Shkëmbi i punësuar pranë Qendra Kulturore “Fan Stiljan Noli” Kolonjë.

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim këtë kallëzim për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprave penale.

I. RRETHANAT DHE FAKTET:

Pranë Bashkisë Kolonjë, Kryetari i Bashkisë Kolonjë Erion Isai, ka punësuar pranë Qendrës Kulturore “Fan Stiljan Noli” Kolonjë, shtetasin e kallëzuar Xhensil Shkëmbi.

Shtetasi i punësuar Xhensil Shkëmbi, me dijeninë e Kryetarit të Bashkisë nuk paraqitet në vendin e punës, por përdoret nga Kryetari Erion Isai, për të ofruar të mira materiale, premtime për vende pune në Bashkinë Kolonjë ose favorizime të tjera, me qëllim për të votuar për Partinë Socialiste në zgjedhjet e 11 Maj 2025.

Në këto kushte Erion Isai, në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, me dashje lejon që shtetasi Xhensil Shkëmbi të mos paraqitet në ambientin e punës, për të kryer fushatë dhe për të kryer favorizime në këmbim të votës për Partinë Socialiste, për zgjedhjet e 11 Maj 2025.

Mosparaqitja e tij në punë është evidente dhe provohet fare thjeshtë nga aktiviteti që ushtron në rrjetin social facebook Xhensil Shkëmbi, ku shfaqet publikisht duke ushtruar aktivitete politike të ndryshme në orarin zyrtar të punës, që duhet të kryente pranë Bashkisë Kolonjë. Ky aktivizim politik kryhet në praninë e eksponentëve dhe kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste.

Pavarësisht faktit se personi nuk paraqitet në vendin e punës, rroga e institucionit nga Bashkia Kolonjë, kalohet e plotë.

Ky përfitim i padrejtë i sjell një dëm të madh ekonomik, interesave të ligjshëm të shtetit, ku shtohen dhe sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, pavarësisht faktit se Xhensil Shkëmbi nuk kryen asnjë punë reale pranë Bashkisë Kolonjë dhe nuk paraqitet pranë ambienteve të punës.

Këto shkelje penale kanë ndodhur që në momentin që ka filluar punë në Bashkinë Kolonjë dhe vazhdojnë dhe sot, kur po depozitojmë këtë kallëzim, duke e kryer krimin në vazhdimësi.

Të gjitha faktet mund të merren nga ana juaj, duke verifikuar dokumentacionin pranë Bashkisë Kolonjë, ku evidentohet qartë nëse ky shtetas kryen punë reale pranë kësaj Bashkie, apo merr rrogën fiktivisht. Gjithashtu një fakt i pakundërshtueshëm dhe lehtësisht i verifikueshëm janë qelizat telefonike të numrit 069 31 87 413 (numri të cilin përdor Xhensil Shkëmbi), nga i cili do të rezultojë qartësisht që ky shtetas nuk paraqitet në ambientin e punës dhe nuk qëndron gjatë orarit zyrtar, por rezulton me vendndodhje komplet të ndryshme nga ato që përfshin Bashkia Kolonjë, por ndodhet përgjatë gjithë orarit zyrtar në Bashkinë Maliq dhe/ose Bashkia Korçë, Bashkia Pogradec.

Pra paga e këtij shtetasi, i kalon thjesht për të kryer detyra apo funksione të drejtpërdrejta politike, apo duke i ushtruar ato në mbrojtje të Partisë Socialiste nëpërmjet shkrimeve nëpër media apo rrjete sociale.

Një nga rastet që provon në mënyrë të drejtpërdrejtë këto fakte, janë deklaratimet e tij publike, ku shtetasi Xhensil Shkëmbi figuron si organizator dhe në shpërndarjen e miellit në Bashkinë Maliq, për qëllime elektorale të Partisë Socialiste (kallëzim të cilin e kemi dorëzuar pranë SPAK për shtetasit Vjollca Qako, Sonil Pine, Artur Sardi). Ky shtetas ka kryer një mbrojtje aktive të këtij rasti korruptiv, në rrjetet sociale dhe media, duke munduar të shtrembërojë faktet dhe opinionin publik, për të justifikuar rrogën që merr në mënyrë të padrejtë nga Bashkia Kolonjë.

II. JURIDIKSIONI, KOMPETENCA DHE KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM:

Juridiksioni:

Neni 69/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se *“1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”*. Duke qenë se kemi të bëjmë me konsumimin e disa veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, vlerësojmë se jemi përpara juridiksionit penal.

Kompetenca lëndore:

Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon se *“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:*

- a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;*
- b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;*
- c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;*
- ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.*

Në rastin konkret, duke qenë se subjekti i kallëzuar kryen funksionin e kryetarit të Bashkisë Kolonjë, parashikuar në gërmën “c” më sipër, çmojmë se ky kallëzim penal është në kompetencën lëndore të SPAK për t’u gjykuar.

Ligji i zbatueshem:

Neni 280 i K.Pr. Penale

Marrja dijëni për veprën penale

“Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.

Neni 283 i K.Pr. Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

"1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policies gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre".

Neni 248 i Kodit Penal

Shpërdorimi i detyrës

"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet".

Neni 328 i Kodit Penal

Korrupsioni aktiv në zgjedhje

"Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet".

Neni 328/a i Kodit Penal

Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

"Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në aktivitetet ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një

partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

III. ANALIZA LIGJORE

Vepra penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal

“Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet”.

Vepra penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal

“Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Përdorimi i administratës publike për qëllime politike sjell pasoja serioze për demokracinë dhe funksionimin e institucioneve shtetërore. Shfrytëzimi i burimeve të administratës është një praktikë e dëmshme dhe në shkelje flagrante të ligjeve të një shteti demokratik. Kur administrata përdoret për interesa politike, mund të krijohen mundësi për korrupsion dhe abuzim me pushtetin, si dhe favorizim të individëve ose grupeve me interesa të caktuara.

Në këto kushte, Partia Demokratike kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat e kallëzuar.

Referuar gravitetit të shkeljeve ligjore të kryera nga ana e personave të kallëzuar, me dashje direkte dhe duke shkelur Kushtetutën, mospërfillur ligjin dhe duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe të opozitës, kërkojmë që regjistrimi i këtij kallëzimi penal të kryhet menjëherë.

KONKLuzion:

Të nderuar Prokurorë,

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht dyshime të arsyeshme të bazuara mbi fakte dhe prova se personat e kallëzuar kanë konsumuar elementët e veprave penale të lartpërmendura.

Për pasojë, duke paraqitur këtë kallëzim, ftojme SPAK të veprojë me urgjencë për vënien para përgjegjësisë penale të personave të kallëzuar.

Përfundimisht, nga ana e SPAK, kërkojmë:

Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Erion Isai dhe Xhensil Shkëmbi, si dhe cdo shtetasi që do rezultojë me përgjegjësi penale nga ky kallëzim, duke urdhëruar kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë të rrethanave të parashtruara më sipër.


Me respekt,

**PËR PARTINË DEMOKRATIKE
KALLËZUESI:
EDMOND SPAHO**

PROVAT BASHKËNGJITUR:

- Foto e indicieve, provave ose publikimet ku mbështetet kallëzimi.
(Foto të marra gjatë orarit zyrtar të punës, ku Xhensil Shkëmbi shfaqet me deputetin Ilir Pendavinji, këshilltarin e partisë Socialiste Plator Çollaku dhe eksponentë të tjerë të Partisë Socialiste, në lidhje me fushatën për zgjedhjet e datës 11 maj 2025).







Xhensil Shkëmbi



Mar 30 · 🌐

Me ministrin e diasporës Taulant Balla në Athinë



Taulant Balla · Follow

Mar 30 · 🌐

LIVE

Live Euronews 📍Athinë





Xhensil Shkëmbi

Apr 25 · 🌐



Edmond Spaho - ky nuk është miell fushate por humanizmi

Jam pjesëtar i komunitetit kishtar në Maliq prej më shumë se 8 vitesh. Çdo muaj, Kisha Ungjillore për shkak të problemeve të shumta sociale të komunitetit të Qarkut të Korçës për më shumë se 200 familje në nevojë u ka ofruar ndihma ushqimore e jo vetëm. Familje të cilat jetojnë në kushte të vështira ekonomike, edhe për faj të politikës. Ndërsa këto ndihma janë pjesë e një projekti të fondacionit Hope for Albania, 3 vjeçar, ku shpërndahen për Krishtlindje dhe Pashkë

Kisha asnjëherë nuk e ka patur për qëllim të ngatërrojë humanizmin me politikën sepse kisha është fe, është familje, është atdhe. Krejt ndryshe nga politika.

Zoti Spaho, gratë të cilat i kishit ekspozuar në foto (duke shkelur rëndë privatësinë e individit) janë ndjerë të fyera nga ana juaj. Barrë të rëndë ke marrë përsipër deputet!





Partia
Demokratike

Tiranë, më 6.05.2025

MEMO

NGA: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Ivi Kaso, Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore, me adresë komunikimi: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 11, Tiranë dhe adresë E-mail: pd@rithemclimi.com

OBJEKTI: Memo në lidhje me kallëzimin penal për subjektin e kallëzuar Erion Isai që ushtron detyrën e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore" parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal

BAZA LIGJORE: Nenet 58 e vijues, 110 e vijues të K.Pr.Penale

DREJTUAR: Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizar (SPAK)

Prokurorëve të Çështjes

Të Nderuar Prokurorë të SPAK,

Pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizar – SPAK, rezulton i depozituar kallëzimi penal për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore" parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal, nga ana e Partisë Demokratike përfaqësuar nga unë në cilësinë e Sekretarit për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore të kësaj partie, ndaj shtetasit Erion Isai me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë.

Si përfaqësues i Partisë Demokratike në këtë kallëzim, kam depozituar kallëzimin penal si dhe kam vënë në dispozicion të Prokurorisë indiciet, provat dhe faktet e pakundërshtueshme që dëshmojnë abuzimet e kryera nga personi i kallëzuar Erion Isai.

Padyshim që hetimet për këto vepra penale, në vlerësimin tonë, janë tej mase të ngadalta dhe të vonuara e duhet të kishin nisur më parë. Megjithatë, me anë të kësaj shkrese dëshiroj tju rikujtoj edhe njëherë shkeljet ligjore dhe abuzive të konsumuara nga personi i kallëzuar dhe nisjen sa më shpejt të hetimeve.

Personi i kallëzuar ka kryer një sërë veprimtarish të ndaluara nga Kodi Zgjedhor, Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator pranë KQZ, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Kodit Penal.

Subjekti i kallëzuar ka nisur fushatën elektorale në diasporë dhe Shqipëri, në mbështetje të Partisë Socialiste, kandidatëve të saj për deputet dhe Kryeministrit Edi Rama, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, duke shkelur ligjin, shpërdoruar detyrën, fondet publike dhe funksionin e tij si funksionar i administratës vendore.

Erion Isai ka disa muaj që vepron në shkelje të hapur dhe të rëndë të ligjit, duke takuar, regjistruar në PER dhe duke ndikuar të bindja politike e zgjedhësve që nga muaji Janar 2025 me takimet e tij në Shba, Kanada, Itali, Greqi dhe në qytete në Shqipëri.

Për ne është e rëndësishme të theksojmë se, sjellja e përsëritur e Erion Isait është kthyer në një fenomen, në një precedent të rrezikshëm të shkeljes së ligjit dhe pandëshkueshmërisë së tij nga institucionet përkatëse.

Legjislacioni i brendshëm parashikon dispozita ligjore që ndalojnë çdo lloj ndërhyrje nga nëpunësit publikë në favor të një kandidati, parashikon rrethana kur nëpunësit publikë nuk mund të bëjnë fushatë gjatë kohës që janë në detyrë, përqëndrohet në ruajtjen e votës së lirë kundër ndikimit të mundshëm të nëpunësve publik përmes dhuratave, donacioneve ose premtimeve dhe parashikon sanksione penale në rast të shkeljes së këtyre dispozitave.

Veprimet në shkelje të ligjit që ka konsumuar personi i kallëzuar kanë sjellë pasoja negative dhe të rënda të gjithë sistemi zgjedhor, në veprimtarinë e institucionit që drejton dhe në veprimtarinë e administratës së Bashkisë Kolonjë.

Pjesëmarrja e një kryetari bashkie në takime politike për të mbështetur apo promovuar një kandidat për deputet përbën shqetësim serioz në kuadër të veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, për shkak se:

1. *Cënon barazinë në garën elektorale*
2. *Shkel detyrimin ligjor për paanshmëri institucionale*
3. *Shpërdoron burimet publike për qëllime elektorale*
4. *Krijon presion mbi administratën publike vendore*
5. *Dëmton interesin publik në favor të interesave politike*

Zbatimi i legjislacionit penal nga ana e SPAK është një nga sfidat më të mëdha në reformën në drejtësi, por ai mund të jetë efektiv përmes pavarësisë institucionale, hetimeve të plota dhe të gjithanshme dhe zbatimit të pandikuar të ligjit.

Sa më sipër, ju drejtohem i edhe njëherë me këtë Memo, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të domosdoshme dhe të gjithanshme në kuadër të hetimit penal dhe bazuar në nenet 58, 110 e vijues të K.Pr.Penale:

KËRKOJMË:

- Kryerjen e veprimeve të menjëhershme hetimore nga ana juaj në funksion të kallëzimit të bërë nga ne, ndaj shtetasit Erion Isai por edhe shtetasve të tjerë që mund të jenë përfshirë në këto ngjarje;
- Thellimin e hetimit në nivel kombëtar, për të evidentuar çdo abuzim të mundshëm;
- Nisjen e hetimit të thelluar pasuror për shtetasin Erion Isai, për të evidentuar nëse nga shpërdorimi i detyrës së tij si Kryetar Bashkie, ka përfituar edhe personalisht përfitime të padrejta.

Me respekt,

Z. Ivi KASO

Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore

i Partisë Demokratike



Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE

Tiranë, më 6 Maj 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimi i detyruar i mësuesve për qëllime politike dhe në mbështetje të një partie politike të caktuar

Subjekti: Vinjola Rota me detyrë në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....".

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Vinjola Rota me detyrë në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë njëkohësisht kandidatë për deputetë e Partisë Socialiste për Qarkun Korçë, momentalisht e pezulluar nga funksioni publik, është duke iu bërë presion e duke kërcënuar mësuesit me vendin e punës. Madje shkon edhe më tej, pretendon që mësuesit të kërkojnë votën për të edhe tek prindërit e fëmijëve.

Pranë Partisë Demokratike, Dega Korçë, kanë ardhur sinjalizime të shumta lidhur me këtë kandidatë.

Duke përdorur presione të tipit: "në qendrën ku ti voton unë pres vetëm votën tënde e të familjes tënde dhe i kam të lexueshme", kjo kandidatë kërcënon mësuesit se nëse nuk i dalin ato vota, pas 12 Majit të "gjejnë vend ku të futen".

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Neni 3, pika 1.3, gërma “ç” e Vendimit nr. 9/2020 parashikon:

“Neni 3

Veprimtari të ndaluara

Në zbatim të këtij vendimi:

1.3 “Veprimtari të ndaluara” janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

ç) “Përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” në nenin 8 parashikon: “Arsimi parauniversitar është i depolitizuar”.

Institucionet edukative duhet të sigurojnë një mjedis të paanshëm për nxënësit dhe stafin e tyre. Përfshirja në aktivitete politike mund të krijojë perceptime për përfshirje të shkollës në politikë, që ndikon negativisht në besimin dhe objektivitetin e procesit edukativ.

Për të gjitha sa më sipër, dyshimi jonë është që subjekti Vinjola Rota në kundërshtim me ligjin po përdor burimet njerëzore në këtë rast mësuesit, që të votojnë dhe mbështesin Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Për të gjitha sa më sipër, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj hetimin e këtij rasti dhe marrjen e masave të menjëhershme për personat e përfshirë në këtë ngjarje.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni LINK.

<https://www.instagram.com/p/DJKCfGSSG2d/?igsh=NTlpOGpzcZfZzXNq>

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PËR KOALICIONIN

PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ

Marash LOGU



Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Tiranë, më 21 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht *pjesëmarrja e punonjësve të administratës vendore në organizime politike në mbështetje të një partie politike të caktuar, vënja në dispozicion e tyre si burim njerëzor në mbështetje të Partisë Socialiste*

Subjekti: Klarsen Brako, drejtor pyjore në Njësinë Administrative Vreshtas, Xhezmi Koro, punonjës bashkie tek pylli fazaneve, Dorian Zholanji, drejtor shkolle në Sheqeras, Qezar Bezati, administratori i Njesisë Vreshtas, Nehat Alo, punonjës mirëmbajtje në Bashkinë Maliq, Ilirjan Kosta, drejtor i EKB Korçë, Mikela Barci, punonjëse e përkrahjes sociale, Njësia Administrative Libonik, Xhensika Selfo, punonjëse tatim taksave në Njësinë Administrative Vreshtas, Xhoana Dauti, punonjëse e tatim taksave në Njësinë Vreshtas, Flauevio Koro, roje shkolle në Sheqeras, Drini Terolli, punonjës shërbimesh Bashkia Maliq

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:

“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....”.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se punonjës të administratës vendore janë vendosur në funksion të Partisë Socialiste si burime njerëzore, duke shprehur në mënyrë të hapur mbështetjen për këtë parti politike.

Konkretisht rezultojnë se: Njësia Administrative Vreshtas përbëhet nga Klarsen Brako drejtor pyjore, Xhezmi Koro punonjës bashkie tek pylli fazaneve, Dorian Zholanji drejtor shkolle në Sheqeras, Qezar Bezati administratori i Njesisë Vreshtas, Nehat Alo punonjës mirëmbajtje në Bashkinë Maliq, Ilirjan Kosta drejtor i EKB Korçë, Mikela Barci punonjëse e përkrahjes sociale Njësia Administrative

Libonik, Xhensika Selfo punonjëse tatim taksave në Njësinë Administrative Vreshtas, Xhoana Dauti punonjëse e tatim taksave në Njësinë Vreshtas, Flauevio Koro roje shkolle në Sheqeras, Drini Terolli punonjës shërbimesh Bashkia Maliq.

Vlerësojmë se këto persona mund të zhvillojnë takime dhe mbledhje vetëm në kuadër të përmirësimit të politikave dhe zhvillimit të punës së institucioneve që përfaqësojnë. Nisur nga veprimet e tyre, si ngritja e dorës me pesë gishtat, në shenjë simbolike të numrit 5 që do të mbajë Partisa Socialiste në fletën e votimit, dyshojmë se ky takim ka patur natyrë politike dhe elektorale. Ne dyshojmë se këto persona për shkak të detyrës që mbajnë, mund të ushtrojnë ndikim në komunitet, duke ndikuar në bindjen politike të zgjedhësve.

Në këtë takim bie në sy, se këto persona kanë shprehur mbështetjen e tyre për Partinë Socialiste, duke treguar me dorë numrin 5, që korrespondon të jetë numri që Partia Socialiste do të mbajë në fletën e votimit, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin dhe kodin etik të administratës.

Këto persona janë vënë në funksion të Partisë Socialiste si burim njerëzor, duke shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.**

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Në këtë rast, subjektet e cituara në këtë denoncim, për shkak të angazhimit në punë në administratën vendore konsiderohen si burime njerëzore. Mbështetja e hapur e Partisë Socialiste automatikisht përbën shkelje ligjore jo vetëm për shkak se këto persona janë vënë në dispozicion të kësaj partie si burime njerëzore, por ligji ndalon shfaqjen e mbështetjes për një parti politike.

Neni 6 pika 3 fjalia e fundit e Vendimit nr. 9/2020 parashikon:

“Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.

Pra, në kuadër të kësaj dispozite ligjore, punonjësit e administratës shtetërore, pjesë të së cilës janë dhe personat e përmendur në këtë denoncim, e kanë të ndaluar me ligj të përdorin funksionin publik apo burimet njerëzore publike në mbështetje të një partie politike. Në rastin konkret, personat si me sipër të ngarkuar me funksione publike pranë administratës vendore, në mënyrë të hapur dhe në shkelje të ligjit, me anë të ngritjes së dorës me numrin 5, kanë shkelur ligjin pasi veprimet e tyre cilësohen automatikisht si mbështetje e Partisë Socialiste.

Këto veprime mund të referohen si shkelje edhe e Kodit Penal pasi neni 328/a parashikon:

Neni 328/a i Kodit Penal paragrafi fundit parashikon:

“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Për të gjitha sa më sipër, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat e përmendur në këtë denoncim.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto nga aktiviteti.

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1295136419285296&id=100063668502512&mibextid=wwXlfr&rdid=OkWnVsXAH0DjwRE3#

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

**PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ**

Franci NURI

09:40

70%



Ilirian Kosta is with Qezar Bezati
and Klarsen Brako. ...

4m · 🧑🏿🧑🏿

📍 Sheqeras 🇹🇷

Nga Sheqerasi Njësia Administrative "Vreshtas", me
zemër për #PS 🇹🇷 dhe me energji e perkushtim për
#Shqipërinë2030 🇹🇷

#Voto5 🗳️

#PS2030 🇹🇷 për #Shqipërinë2030 🇹🇷




09:40

70%



09:40

70%



09:40



70%





Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Tiranë, më 21 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimi i funksionit publik në mbështetje të një partie politike të caktuar dhe kandidatëve të saj

Subjekti: Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:

“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....”.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Kryetari i Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu ka shoqëruar kandidatin e Partisë Socialiste Eridjon Rustemi nëpër takime, duke shprehur në mënyrë të hapur mbështetjen për këtë parti politike dhe duke shkelur ligjin. Për këtë ngjarje do tju vendosim në dispozicion foto nga takimi.

Kemi bindjen se qëllimi i shoqërimit të kandidatit Eridjon Rustemi është bërë me qëllimin e posaçëm për të mbështetur dhe favorizuar këtë kandidat. Ne besojmë se kjo veprimtari është vetëm me natyrë politike dhe elektorale. Kryetari i Bashkisë Maliq për shkak të detyrës që mban, mund të ushtrojë ndikim në komunitetin e Maliqit, duke ndikuar në bindjen politike të zgjedhësve.

Ne dyshojmë se Kryetari i Bashkisë Maliq është vënë në funksion të Partisë Socialiste si burim njerëzor i institucionit që përfaqëson, duke shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron

kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Neni 6 pika 3 fjalia e fundit e Vendimit nr. 9/2020 parashikon:

“Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”.

Neni 7, pika 1, gërma “e” e këtij vendimi parashikon:

“Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:

e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e:

i) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë elektorale e të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore”

Pra, në kuadër të gjithë bazës ligjore të cituar, Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu, i cili drejton veprimtarinë e Bashkisë Maliq dhe njëkohësisht funksionar i administratës publike vendore, ka për detyrë të garantojë që asnjë burim njerëzor i Bashkisë Maliq, asnjë fond, asnjë mjet i Bashkisë dhe as veprimtaria e Bashkisë Maliq mos të vihen në dispozicion të fushatës elektorale të një partie dhe kandidati të caktuar. Kryetari i Bashkisë ka detyrimin ligjor të respektojë dhe zbatojë jo vetëm ligjin por edhe Kodin e Etikës së administratës publike dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”. Kryetari i Bashkisë ka detyrimin ligjor të garantojë dhe të mbikëqyrë mospërfshirjen e punonjësve të bashkisë që drejton, në veprime që mbështesin një parti politike apo kandidat të caktuar.

Por, Kryetari Gëzim Topçiu, me vetëdije dhe me dashje përfshihet vet në veprimtari të ndaluara nga Kodi Zgjedhor, Vendimi nr. 9/2020 madje dhe nga Kodi Penal.

Kryetari, i cili ka për detyrë të kontrollojë punonjësit e bashkisë nën varësinë e tij, merr pjesë në takime me natyrë politike dhe elektorale në mbështetje të kandidatit të Partisë Politike Eridjon Rustemi. Në këtë aspekt, çfarë na mbetet të mendojmë për kontrollin që Kryetari i Bashkisë duhet të bëjë kundrejt punonjësve të bashkisë? A është i aftë Kryetari i Bashkisë të kontrollojë dhe frenojë mospërfshirjen e punonjësve të Bashkisë Maliq në veprimtari që shprehin mbështetjen për një parti dhe kandidat të caktuar, kur ai vet e shkel ligjin?

Këto veprime nga ana e subjektit të denoncuar mund të referohen si shkelje edhe e Kodit Penal pasi neni 328/a parashikon:

Neni 328/a i Kodit Penal paragrafi fundit parashikon:

“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie





Eridjon Rustemi

21m · 🌐





Gëzim Topçiu · Follow


23m · 🌐

Takim pune me banorë në Pojan mbi problematikat në infrastrukturë e kanalizime .

Sapo kemi mbyllur asfaltimin e një zone për të vazhduar shpejt edhe me një projekt të ri në zonën e kishës .

Zërë i banorëve në vëmendjen tonë !







Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 11 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht pjesëmarrja në veprimtari të ndaluar, përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore dhe shpërdorim i detyrës nga Kryetari i Bashkisë Devoll Eduard Duro

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së..."

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Kryetari i Bashkisë Devoll Eduard Duro ka marrë pjesë në takime dhe organizime politike duke shoqëruar Niko Peleshin në takimet e këtij të fundit me banorët e qytetit të Devollit gjatë të cilit ka prezantuar kandidatët për deputet të Partisë Socialiste për Qarkun e Korçës. Vet kryetari Eduard Demo ka publikuar në rrjetin e tij social Facebook foto nga takimi, i cili shihet se është i pozicionuar në një tavolinë me Niko Peleshin dhe kandidatët për deputet.

Kjo veprimtari konsiderohet se është kryer në shkelje të ligjit për arsyet si vijojnë:

1. Kryetari i Bashkisë Eduard Demo ka vepruar si burim njerëzor i institucionit në mbështetje të Partisë Socialiste:

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

"Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu ~~premtimi ose ofrimi i përfirimeve nëpunësve publike, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimi, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim~~”.

Në këtë rast, subjekti i cili kryen detyrën e Kryetarit të Bashkisë Devoll konsiderohet si burim njerëzor për shkak të angazhimit të tij në administratën publike. Pjesëmarrja e tij në këtë takim politik dhe elektoral automatikisht cilësohet si përdorim i burimeve njerëzore në mbështetje të një partie politike të caktuar që në këtë rast është Partia Socialiste. Eduard Demo ka shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor si më sipër.

Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

“Kryeministri, administrata e tij, zëvendës kryeministri, ministri dhe zëvendës ministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendës dhe administrata e tij, prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varesi të Kryeministrit, Keshillit të Ministrave apo Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtori i departamenteve, drejtoret e drejtorive dhe administratat perkatese, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si dhe çdo ent ku shteti zoteron aksione kapitale/kuota apo emeron shumicën e organit mbikëqyres ose të organit administruar, titullat dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (kater) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdoqë formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Për sa më sipër, funksioni dhe detyra si kryetar bashkie duhet të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga bindjet politike, shfaqjet dhe organizimet politike. Në rastin konkret, Eduard Demo ka vepruar në shkelje të ligjit duke mosrespektuar detyrimin ligjor i cili i rëndon në sajë të funksionit që kryen.

2. Eduard Demo ka përdorur funksionin publik për veprimtari politike ose zgjedhore dhe ka shpërdorur detyrën

Subjekti në fjalë në kundërshtim të hapur me ligjin si më sipër dhe Kodin Penal ka përdorur funksionin e tij publik për të favorizuar një parti politike konkretisht Partinë Socialiste. Përdorimi i funksionit publik për qëllime politike dhe elektorale është i ndaluar me ligj për faktin se përfshin abuzimin me fondet publike, favorizimin e një partie politike dhe ushtrimin e ndikimit mbi votuesit.

Neni 328/a i Kodit Penal paragrafi fundit parashikon:

“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Neni 248 i Kodit Penal parashikon:

“Shpërdorimi i detyrës

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Pjesëmarrja e tij në këtë takim duke qenë se ai është kryetar bashkie dhe ushtron ndikimin e tij te banorët e qytetit, automatikisht ndikon në bindjen politike të zgjedhësve, duke sjellë përfitime dhe interesa për Partinë Socialiste dhe duke dëmtuar interesat e Partisë Demokratike – Koalicioni PD-ASHM

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për Eduard Demo me detyrë Kryetar Bashkie në Devoll lidhur me shkeljet si më sipër.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto nga aktiviteti.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ

Franci NURI



13:03 @ A

75%



Posts

Photos

Videos



Eduard Duro

Mar 16 · 🌐



Niko Peleshi · Follow

Mar 16 · 🌐


🗳️ Në Devoll për prezantimin e dy kandidatëve për deputetë të qarkut të Korçës, Genti Lakollari dhe Gëzim Gora, dy emra të spikatur, njëri në listën e hapur dhe tjetri në listën e mbyllur, të gatshëm të përfaqësojnë me dinjitet Devollin dhe qytetarët e tij.

🗳️ Partia Socialiste ka ndërtuar një histori suksesi në këtë krahinë, duke fituar besimin e njerëzve dhe duke u rritur zgjedhje pas zgjedhjesh. Në maj, synimi është i qartë: 7 mandate për të forcuar më tej përfaqësimin e Devollit dhe gjithë qarkut të Korçës.

#VetëmPërpara 🇲🇰 🇲🇰


Partia Socialiste e Shqipërisë 🗳️ ❤️





13:03 @

75%



Eduard Duro

4.9K friends • 1 mutual

Add friend

Message



Posts

Photos

Videos

Details

Studied at Universiteti F.S.Noli

Went to Universiteti F.S.Noli

Lives in Bilisht

From Bilisht

See Eduard's About Info


Friends

4,985 (1 mutual)





Partia
Demokratike



KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 16 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimit të aseteve publike dhe promovimit të veprave në fushën e infrastrukturës nga Bashkia Pogradec, pjesëmarrje në takime politike në Greqi në mbështetje të një kandidati dhe partie politike të caktuar, shpërndarja e postimeve në mbështetje të një partie politike të caktuar, kryer nga Kryetari i Bashkisë Pogradec Ilir Xhakolli

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....".

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Kryetari i Bashkisë Pogradec Ilir Xhakolli ka kryer disa veprimtari të ndaluara të cilat po i rendisim si më poshtë:

1. Shtrimi i rrugëve ose "asfalti elektoral" para zgjedhjeve

Bashkia Pogradec ka filluar të shtrojë "asfaltin elektoral" në disa fshatra të qytetit, si psh rrugët kryesore të fshatrave Verdovë, Rrëmenj, Gështenjas, Baçallëk, Çërravë dhe Kriçkovë. Bashkia Pogradec ka përfunduar fazën e parë të asfaltimit të rrugës Proptisht-Slabinjë. Një tjetër punë e kryer nga Bashkia Pogradec është dhe rijetëzimi i Qendrës Historike të "Pogradecit të Vjetër". Bashkia Pogradec ka kryer gjithashtu termoizolimimin e pallateve në lagjen 3. Janë kryer punime për rikonstruksionin e shkollës "Kajo Karafili" të fshatit Gështenjas.

Bazuar në nenin 23 pika 4 e ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" parashikon:

"Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore"

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ngre shqetësimin dhe dyshimin se rehabilitimi dhe shtrimi i rrugëve para fushatës zgjedhore është një tentativë nga ana e Bashkisë Pogradec për të ndikuar dhe përfituar votat e banorëve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM dyshon se kjo veprimtari e kryer para fushatës zgjedhore bëhet për qëllime politike dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe synon manipulimin e votave të zgjedhësve.

Kjo veprimtari është e ndaluar sipas Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, i cili parashikon:

“Neni 3

Veprimtari të ndaluara

1 Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë” veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjitikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, ai edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet...”

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit....”.

Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, rruga cilësohet të jetë burim/aset publik dhe përdorimi i saj para fushatës zgjedhore përbën shkelje të Kodit Zgjedhor.

2. Pjesëmarrje në takim me zgjedhësit në Selanik në datën 20 Janar

Në datën 20 Janar të këtij viti, Kryetari i Bashkisë Pogradec shihet se ka zhvilluar një takim me zgjedhësit në Selanik, Greqi, ku sipas citimit të tij, ka diskutuar për procesin e regjistrimit për zgjedhjet e 11 Majit dhe për punët e mira që ka bërë për qytetin. Shihet se në tavolinë Kryetari i Bashkisë është i shoqëruar nga disa persona të tjerë. Ne dyshojmë se mund të jenë funksionar të Bashkisë Pogradec, ndaj ftojme KQZ të kryejë një hetim të thellë për të identifikuar personat të cilët nëse zbulohet se janë funksionarë publikë, janë po ashtu në shkelje të ligjit.

Neni 6, pika 3 e Vendimit nr. 9/2020 parashikon:

“Punonjesit të administratës shtetërore i ndalohet të perdore të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerezore publike, me qëllim favorizimin e nje partie politike, koalicioni ose kandidati ne zgjedhje”.

Neni 7, pika 1 e Vendimit nr. 9/2020 parashikon:

"1. Sekretaret e pergjithshem te institucioneve publike qendore e vendore, te pavarura e te varesise, kryetarët e bashkive, perfektet, drejtuesit e njesive administrative dhe drejtuesit e institucioneve te varesise:

e) marrin masa dhe realizojne monitorimin e zbatimit te tyre, per te penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e:

i) burimeve njerëzore te institucionit ne funksion te veprimtarise elektorale e te fushates zgjedhore te subjekteve zgjedhore, ne zbatim te nenit 14, te ligjit nr. 9131 date 8.9.2003 "Per rregullat e etikes ne administraten publike";

ii) fondeve te institucioneve per periudhen 4 muaj perpara deri ne daten e zgjedhjeve, ne funksion te fushates zgjedhore te subjekteve zgjedhore;

iii) mjeteve dhe materialeve ne inventar te institucionit per periudhen 4 muaj perpara deri ne daten e zgjedhjeve, ne funksion te fushates zgjedhore te subjekteve zgjedhore;

iv) institucioneve publike per zhvillimin e fushates zgjedhore apo realizimin e propagandes politike ne to;

v) veprimtarise shtetërore per te favorizuar subjekte te caktuara zgjedhore"

Sipas kësaj dispozite, Kryetari i Bashkisë Ilir Xhakolli, ka detyrimin ligjor për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve njerëzore të institucionit që drejton, kur ndërkohë, ai vet si burim njerëzor i Bashkisë Pogradec, merr pjesë në takime me zgjedhësit me qëllim favorizimin e një partie të caktuar, që është Partia Socialiste.

Ndaj, në zbatim të kësaj dispozite, ftojme KQZ të hetojë cilët kanë qenë personat që kanë shoqëruar Ilir Xhakollin dhe çfarë fondesh të Bashkisë Pogradec janë përdorur në këtë takim.

Për sa më sipër, vlerësojmë se ky takim në cilësinë e tij si Kryetar Bashkie është në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9/2020 pasi jo vetëm Kryetari i Bashkisë ka funksionuar si burim njerëzor i institucionit, por edhe persona të tjerë nga Bashkia Pogradec kanë funksionuar si burim njerëzor.

3. Përdorimi i funksionit publik për të favorizuar një parti politike dhe kandidat të caktuar

Në postimin e tij në facebook që mban datën 26 Mars, subjekti ka postuar një foto dhe një shkrim së bashku me simbolet e Partisë Socialiste. Këtë rast nuk mund ta anashkalojmë, pasi përdorimi i simboleve të një partie të caktuar, automatikisht nënkupton mbështetjen e kësaj partie.

Nëse në një vendim nga ana juaj, përdorimi i simboleve #vetemperpara dhe #shqiperia2030 nuk janë konsideruar shkelje dhe në mbështetje të një partie të caktuar (rasti i disa punonjësve të administratës dhe ministrive që kanë shpërndarë këto simbole), në këtë rast është e dukshme dhe e qartë se përdorimi i simboleve të Partisë Socialiste dhe thirrja për të marrë pjesë në takimin e Kryeministrit Edi Rama, përbën favorizim dhe mbështetje të hapur për këtë parti dhe këtë kandidat.

Gjithashtu, në datën 25 Mars, Ilir Xhakolli ka shpërndarë në facebook të tij një postim të Bledi Çomo, i cili është kandidat i Partisë Socialiste, duke shprehur drejtpërdrejt mbështetjen për këtë kandidat, veprim i cili është i ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020.

Postimi ka të bëjë me një takim të zhvilluar në Njësinë Buçimas, gjatë të cilit Ilir Xhakolli ka marrë pjesë dhe ka shoqëruar Niko Peleshin dhe Bledi Çomo, të cilët janë kandidat për deputet të Partisë Socialiste.

Në këto raste, Ilir Xhakolli ka përdorur funksionin e tij publik si kryetar bashkie për të mbështetur Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Për të gjitha sa më sipër, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe mbi të gjitha kërkon të ndalohet ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë se jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.



Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto të shkeljeve të kryera.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

**PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ**

Franci NURI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Franci Nuri', with a large, sweeping flourish extending from the bottom right.

12:59

25%



Posts

About

Photos

Videos

Events



Ilir Xhakolli

Jan 20



#Diaspora

Këtë fundjavë që lamë pas pata kënaqësinë të isha i ftuar për të biseduar me bashkëatdhetarët tanë në Selanik dhe Athinë. Diskutuam me ta për procesin e regjistrimit në KQZ mbi zgjedhjet e 11 Majit dhe për punët e mira që kemi bërë në Pogradec gjatë këtyre viteve.

Konstatova një entuziazëm të madh në radhët e tyre për hapin historik dhe mundësinë që iu dhamë për të votuar në këto zgjedhje. Emigrantët më mirë se çdokush tjetër e bëjnë dallimin e ndryshimeve në qytet dhe vend kur kthehen, ndaj jam i lumtur që çdo ditë e më tepër plotësojmë pritshmëritë e tyre për një Pogradec të zhvilluar dhe Shqipëri Europiane!

#Diaspora #zgjedhje #11Maji #Selanik #Athinë



12:57

26%



Posts

About

Photos

Videos

Events

Like

Comment

Send

Share

**Ilir Xhakolli**

Mar 25 ·

**Bledi ÇOMO** · Follow

Mar 25 ·

🇲🇰Nga Njësia Buçimas drejt fitores së pandalshme!
Me Asamblenë e Partisë Socialiste në Buçimas me
Nikon, Ilirin, Erjonin dhe Alfonsin, aty ku edhe këtë
herë në çdo fshat të kësaj njësie ne do të fitojmë
bidshëm në zgjedhjet e 11 Majit. Buçimasi dhe
fshatrat e tij gjatë viteve të fundit kanë ndjerë
dorën e investimeve në kanalizime, infrastrukturë
rrugore, projekte në shërbim të turizmit në Drilon e
Tushemisht e sigurisht që nuk ka kohë të ndalë
hapin e zhvillimit për të forcuar më tej ekonominë
lokale, turizmin dhe bujqësinë. 11 Maji do të
tregojë se maksimizimi i votës për PS është një
formë falenderimi për vëmendjen e dhënë. Ka ende
për të bërë! Forca!

#11maj #BlediÇomo #ps5 🇲🇰



12:56

26%



Posts

About

Photos

Videos

Events

121

1 comment 1 share 529K views



Like



Comment



Send



Share



Ilir Xhakolli

Mar 26 · 🌐



🇷🇸🇷🇸. Kryeministri Edi Rama do të jetë në Kretë për një takim të veçantë me bashkatdhetarët tanë që jetojnë e punojnë atje, të shtunën 29 Mars.

📍 Adresa: Stadiumi i mbyllur "Kladissos"

🕒 Ora 18:00

Eshtë një moment historik për t'u bashkuar e për të ndarë mes nesh energjinë e jashtëzakonshme të diasporës shqiptare. 🇷🇸🇷🇸

#PS 🇷🇸🇷🇸 #11Maj #shqipëria2030



122

6 comments 7 shares



Like



Comment



Send



Share



Ilir Xhakolli

Mar 25 · 🌐



Bledi ÇOMO · Follow

Mar 25 · 🌐

12:57

25%



Posts

About

Photos

Videos

Events

64

4 comments 1 share



Like



Comment



Send



Share




Ilir Xhakolli

Mar 21 ·



Rrugët kryesore të fshatrave Vërdovë, Rrëmenj, Gështenjas, Baçallëk e Çerravë tashmë kanë marrë investimin e duhur me riveshjen e shtresave të reja asfaltike. Ndërkohë që puna do të vijojë me rrugët e brendshme si fazë e dytë për ti dhënë zgjidhje çështjes së infrastrukturës rrugore të këtyre zonave.



119

13 comments 22 shares 24.8K views



Like



Comment



Send



Share



Ilir Xhakolli

Mar 20 ·



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow

Mar 20 ·

Mirëmëngjes

nga puna disa ditore që po bëjmë për pa... See more

13:00 ▲

24%



Posts

About

Photos

Videos

Events



Ilir Xhakolli



Jan 11 · 🌐



Niko Peleshi · Follow

Jan 11 · 🌐

🇳🇪 🇷🇸 Për të gjithë bashkatdhetarët tanë në Selanik!

🌐 Nga dita e nesërme, në orën 10:00-20:00, çdo zgjedhës shqiptar që jeton dhe punon në **#Selanik** dhe ka nevojë për mbështetje teknike lidhur me procesin e regjistrimit për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit mund të paraqitet në zyrën e Partisë Socialiste në Selanik.

Për çdo pyetje ose nevojë për ndihmë gjatë procesit të regjistrimit, ekipi ynë do të jetë i gatshëm për të dhënë asistencë. Regjistrimi është i domosdoshëm për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit si votues i Diasporës.

📍 Adresa: Tsimiski 43, T.K. 54623 Thessaloníki, Greece (Kati III, përballë Konsullatës Shqiptare)

📞 Numër kontakti: +30 697 698 1218

🕒 Orari i shërbimit: 10:00 - 20:00

#DiasporaVoton🇳🇪

#PlatformaElektronikeERegjistrimit🇷🇸



12:58 ▲

25%



Posts

About

Photos

Videos

Events



Ilir Xhakolli



Mar 19 · 🌐




Edi Rama 🌐 updated his cover photo. · Follow

Mar 19 · 🌐



MIRËMËNGJES 🙌

dhe me numrin 5 🙌 të Partisë Socialiste në fletën e 11 majit, ku çdo shqiptar e shqiptare do të duhet ta investojë votën për të vazhduar pa asnjë ndalesë a lëkundje negociatat me BE, anëtarësuar Shqipërinë në Bashkimin Europian, siguruar pashaportën europiane për vete e familjen, duke mos parë majtas e djathtas, po drejt, tek maja e Shqipërisë 2030 në BE, ju uroj një ditë të mbarë 🙌



👍 48

1 comment 3 shares



Like



Comment



Send



Share



Ilir Xhakolli



Mar 18 · 🌐



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow

Mar 18 · 🌐

Mirëmëngjes 🙌

12:58 ▲

25%



Posts

About

Photos

Videos

Events



Ilir Xhakolli



Feb 21 · 🌐



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow


Feb 21 · 🌐



E kryer

Ka nisur faza e parë e asfaltimit të rrugës Proptisht-Slabinjë. Një aks rrugor i rëndësishëm për lidhjen e dy njësive Velçan-Proptisht me aksin nacional. Paralelisht do vijoje puna për rehabilitimin e qendrës së Proptishtit me trotuare, shesh dhe ndriçim publik. Sepse Mokra e meriton!

#fshatratepogradecit #mokra #proptisht #slabinjë #velçan



👍 230

19 comments 3 shares



Like



Comment



Send



Share

www.facebook.com/bashkia.pogradec

12:59 ▲

25%



Posts

About

Photos

Videos

Events



Ilir Xhakolli

Feb 12 · 🌐



Bashkia Pogradec (Faqe Zyrtare) · Follow

Feb 12 · 🌐

🔍 Termoizolimi i pallateve në lagjen 3

Kemi nisur nga puna me një tjetër bllok pallatesh duke aplikuar sistemin kapot. Falë kësaj ndërhyrjeje të financuar nga FSHZH i japim zonës jo vetëm një pamje të re, por mundësojmë apartamente më të ngrohta për familljet. Kjo punë do të vijojë në të gjitha lagjet ku ka pallate të para viteve 90".

#bashkiapogradec #fshzh



👤 126

14 comments 2 shares





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025

Nr: 125

Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

MOSFILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 37 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 125.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/3 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet marrjes në punë para fushatës zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 37 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është publikuar njoftim për shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë së lartë drejtuese në Bashkinë Maliq. Në mënyrë specifike vendet vakante konsistojnë në:

- Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion);
- Drejtor në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Aseteve (1 pozicion);

- *Përgjegjës sektori në Sektorin e Prokurimeve dhe Menaxhimit të Kontratave (1 pozicion);*
- *Përgjegjës Zyre në Zyrën Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (1 pozicion);*
- *Përgjegjës Zyre në Sektorin e Shërbimeve Sociale (1 pozicion);*
- *Agronom (1 pozicion);*
- *Specialist Koordinimi Donatore (1 pozicion);*
- *Nënpunës Finance Protokoll (3pozicion);*
- *Specialist Arkitekt Dizanj (1 pozicion);*
- *Specialist Auditi (1 pozicion);*
- *Specialist Inxhinier (1 pozicion);*
- *Specialist/Jurist (1 pozicion);*
- *Specialist Programues Bazë të dhënash (1 pozicion);*
- *Specialist Statisticien (1 pozicion)."*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillim të procedurës administrative për denoncimin nr. 37 ID, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Partia
Demokratike

KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 2 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nëpërmjet shpalljes së procedurave të prokurimit "Sistemim asfaltim rrugë 2025" nga Bashkia Maliq

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njetëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

"1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së...."

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Bashkia Maliq ka shpallur procedurat e prokurimit "Sistemim asfaltim rrugë 2025" para fushatës zgjedhore.

Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna:

- Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Maliq
- Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur pune
- Objekti i kontratës: Sistemim asfaltim rrugë 2025
- Numri i referencës së procedurës: REF-41656-03-19-2025
- Fondi limit: 83.332.941 Lek pa Tvsh
- Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04:04:2025 (d/m/v) Ora: 10:00

Shpallja e procedurave të prokurimit publik para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Pika 1 dhe 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...”.

Në kuptim të kësaj dispozite, rruga konsiderohet *aset publik* dhe Bashkia Maliq po përdor asetet publike para fushatës zgjedhore.

Neni 3 pika 4 e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

“4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor”.

Për këto arsye, vlerësojmë se shpallja e kësaj procedure nga ana e Bashkisë Maliq para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i kësaj procedure është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe mobilizimin e votave të zgjedhësve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Partia Demokratike kërkon nga institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK të postimit denoncues (faqja 20-21 e dokumentit)

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=ed8bcc46-19fc-4134-9512-c6f29db3317a>

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi,

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PËR KOALICIONIN

PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADIËSHTORE

Përfaqësuesi Ligjor i PD-ASHM në KQZ

Franci NURI



**Partia
Demokratike**

**KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE**

Tiranë, më 5 Maj 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimit të asetëve publike dhe promovimit të veprave në fushën e infrasktrukturës nga Bashkia Maliq

Subjekti: Kryetari i Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:

“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....”.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Bashkia Maliq vazhdon të shtrojë “asfaltin elektoral”, ka ndryshuar sistemin uhor dhe po punon për rinovimin e pyjeve. Këto ngjarje shoqërohen me foto dhe video të cilat do t’i vendosim në dispozicionin tuaj.

Bazuar në nenin 23 pika 4 e ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” parashikon:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore”

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ngre shqetësimin dhe dyshimin se rehabilitimi dhe sltrimi i rrugëve para fushatës zgjedhore është një tentativë nga ana e Bashkisë Maliq për të ndikuar dhe përfituar votat e banorëve.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM dyshon se kjo veprimtari e kryer para fushatës zgjedhore bëhet për qëllime politike dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe synon manipulimin e votave të zgjedhësve.

Kjo veprimtari është e ndaluar sipas Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, i cili parashikon:

“Neni 3

Veprimtari të ndaluara

1 Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë” veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjitikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, ai edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet...”

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...”

Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, rruga cilësohet të jetë burim/aset publik dhe përdorimi i saj për të mbështetur një subjekt zgjedhor të caktuar përbën shkelje të Kodit Zgjedhor.

Për këto arsye, vlerësojmë se veprimtaria e rehabilitimit të rrugëve para fushatës zgjedhore është kryer në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe ka sfond propagandistik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj.

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe mbi të gjitha kërkon të ndalohej ndikimi në votën e zgjedhësve. Kujtojmë se jetojmë në një rend demokratik ku vota është e lirë dhe e fshehtë. Askush dhe në asnjë formë nuk mund të ndikojë në bindjen personale të zgjedhësve.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni video të shkeljeve të kryera.

<https://www.facebook.com/BelindKellici.Official/videos/asfalti-elektoral-i-paligjsh%C3%ABm-vijon-t%C3%AB-hidhet-n%C3%AB-rrug%C3%ABn-e-vjct%C3%ABr-nga-teg-u-deri/1088991816579066/?mibextid=wwXIfr&rdid=k5B3wO5cxXizAEeS>

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, duke kërkuar përfundimisht:

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

**PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ**

Marash LOGU



Partia Demokratike e Shqipërisë

Denoncim i ri



Partia Demokratike e Shqipërisë

13:50

To: krimizgjedhor@pd.al ✓

Mesazhi juaj: Kam pare ne shume raste, se shuem fadroma kalojne ne rruget e Bashkise. Gjate kesaj khoe ku ka fushate zgjedhjeje, bashkia maliq ndryshoi sistemin uxor, dica qe nuk lejohet gjate fushates.

Denoncim anonim?: Jo

Vendos adresën tënde të email: shabrubin@gmail.com
on

Date: 04/05/2025

Time: 12:50

Page URL: <https://pd.al/krimizgjedhor/#sinjalizo>

User Agent: Mozilla/5.0 (Windows NT 10.0; Win64; x64)

AppleWebKit/537.36 (KHTML, like Gecko)

Chrome/136.0.0.0 Safari/537.36 Edg/136.0.0.0

Remote IP: 192.109.219.190

Powered by: Elementor



Partia Demokratike e Shqipërisë

13:37

To: krimizgjedhor@pd.al ✓

Mesazhi juaj: Ne Bashkine Maliq, nje sasi e madhe mbetjesh ishin gjendur pas festes se 1 majit, dhe tani, pas nje denoncimi te bere te paltforma JOQ, punteroet bashkiake po rinovojne pyllin ne fuhsate zgjedhore
Denoncim anonim?: Jo
Vendos adresën tënde të email: shabrubin@gmail.com
on

Date: 04/05/2025

Time: 12:37

Page URL: <https://pd.al/krimizgjedhor/>

User Agent: Mozilla/5.0 (Windows NT 10.0; Win64; x64)

AppleWebKit/537.36 (KHTML, like Gecko)

Chrome/136.0.0.0 Safari/537.36 Edg/136.0.0.0

Remote IP: 192.109.219.190

Powered by: Elementor



Partia
Demokratike

Tiranë, më 17 Shkurt 2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Lënda: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/3 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet marrjes në punë para fushatës zgjedhore

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

I nderuar z. Komisioner,

Partia Demokratike paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohem në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

- "1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.*
- 2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor. [...]"*

Partia Demokratike nëpërmjet këtij denoncimi përcjell rastin e shkeljeve të kryera nga Bashkia Maliq. Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Maliq ka shpallur procedurat për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë së lartë drejtuese para fushatës zgjedhore.

Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është publikuar njoftimi për shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë së lartë drejtuese në Bashkinë Maliq. Në mënyrë specifike vendet vakante konsistojnë në:

- Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion)
- Drejtor në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Asteve (1 pozicion)
- Përgjegjës Sektori në Sektorin e Prokurimeve dhe Menaxhimit të Kontratave (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Zyrën Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Sektorin e Shërbimeve Sociale (1 pozicion)
- Agronom 1 (pozicion)
- Specialist Koordinim Donatore (1 pozicion)

- *Nëpunës Finance Protokoll (3 pozicion)*
- *Specialist Arkitekt Dizanj (1 pozicion)*
- *Specialist Auditi (1 pozicion)*
- *Specialist Inxhinier (1 pozicion)*
- *Specialist/Jurist (2 pozicione)*
- *Specialist për Prokurimet (2 pozicione)*
- *Specialist Programues Bazë të dhënash (1 pozicion)*
- *Specialist Statisticien (1 pozicion)*

Premtimi apo marrja në punë para fushatës zgjedhore është e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Neni 91/3 i Kodit Zgjedhor parashikon “Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura...”.

Neni 3 pika 1.3 gërma “d” e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

“1.3 Veprimtari të ndaluara janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

d) gjatë fushatës zgjedhore marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura...”.

Për këto arsye, vlerësojmë se marrja në punë nga ana e Bashkisë Maliq është veprim i kryer në shkelje flagrante të nenit 91/3 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i marrjes në punë nga Bashkia Maliq është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Partia Demokratike kërkon respektimin e Kodit Zgjedhor dhe të të gjitha akteve të tjera në fuqi të cilat garantojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Partia Demokratike kërkon nga institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat që janë të përfshirë në këtë ngjarje. Personat të cilët kanë shkelur ligjin të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Bashkëngjitur po ju vendosim **LINK** të postimit denoncues.

<https://akpa.gov.al/bashkia-maliq-vende-te-lira-pune-5/>

Në këto kushte, Partia Demokratike po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht:**

- 1) Nisjen e hetimit administrativ për këto raste nga administrata e KQZ; si dhe
- 2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

PER PARTINE DEMOKRATIKE
Përfaqësues i PD në KQZ

Franci NURI

Nr. 360/3 Prot.
Datë 12.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 16183 Prot./V.M

Tiranë, më 09.05.2025

Lënda: Dërgojmë vendimin për mosfillimin e procedimit penal.

Drejtuar: Zuj. Albana Vokshi
Partia Demokratike e Shqipërisë
(Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.11)

TIRANË

Bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të vendimit për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me materialin kallëzues nr.119 datë 28.04.2025.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE
ORGANIZUAR

V E N D I M
PËR MOSFILLIMIN E PROÇEDIMIT PENAL

Në Tiranë, më 08.05.2025.

Unë, Vladimir Mara, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pasi studiova materialin kallëzues nr.119, datë 28.04.2025,

K O N S T A T O V A:

Se, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 28.04.2025 mbi bazën e kallëzimit penal të një grupi deputetësh të Partisë Demokratike, përfaqësuar nga shtetasit Albana Vokshi, Flamur Noka, Petrit Doda dhe Edi Paloka të ardhur me shkresën nr.14244 Prot., datë 25.04.2025, ka regjistruar materialin kallëzues Nr. 119 datë 28.04.2025.

I. Rrethanat e faktit

I.1. Një grup deputetësh të Partisë Demokratike kanë paraqitur në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kallëzim penal ndaj Kryetarit të Bashkisë Maliq, shtetasit Gëzim Topçiu, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga nenet 248 i Kodit Penal.

I.2. Sipas këtij kallëzimi penal, grupi deputetëve të Partisë Demokratike, Dega Tiranë në këtë kallëzim, pretendojnë se Kryetari i Bashkisë Maliq, Gëzim Topçiu, dyshohet se ka kryer shkelje penale para fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të datës 11.05.2025. Sipas tyre, rezulton se në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në buletin nr.14, datë 25.03.2025 është publikuar një procedurë prokurimi nga Bashkia Maliq, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, Vendimin nr.9/2020 dhe riejdhimisht në kundërshtim me Kodin Penal.

I.3. Kallëzuesit pretendojnë se procedura e prokurimit “Sistemim asfaltim rrugë 2025”, me nr. Ref-41656-03-19-2025, me fond limit 83.332.941 lekë pa tvsh, me afat të fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave datë 04.04.2025, ora 10:00, është shpallur para fushatës zgjedhore dhe është e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor. Gjithashtu synohet favorizimi i një pale të caktuar, e cila do të jetë pala ose shoqëria që do të shpallet fituese e kësaj procedure ose kandidat politik i caktuar.

I.4. Sipas kallëzuesve, pretendohet se Bashkia Maliq ka shpallur njoftim për vende të lira pune, në periudhën parazgjedhore. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Veprim ky që synon të ketë ndikim në procesin zgjedhor dhe të vota e zgjedhësve, duke dëmtuar procesin zgjedhor transparent, votën e lirë të zgjedhësve dhe mbi të gjitha rezultatin e zgjedhjeve në një shtet demokratik.

II. Verifikimet e kryera

II.1. Është kryer këqyrje e pamjeve filmike dhe fotografive të dërguara nga kallëzuesit, ku mbështetet kallëzimi tyre.

II.2 Nga këqyrja e materialeve të dërguara me një CD nga kallëzuesit, identifikohen një skedar që ka të bëjë me një lajm të publikuar në stacionin televiziv "Top channel", në lidhje me punësimet në administratën shtetërore gjatë periudhës zgjedhore, për të cilin ka një ndalim nga qeveria, ku rezulton se është prencipi për media i znj. Adca Pirdeni, Ministre e Shtetit për Administratën.

II.3. Me shkresën nr.14434 prot, datë 28.04.2025 i është kërkuar informacion Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nëse pranë tyre janë raportuar, referuar materiale lidhur me Bashkinë Maliq, apo institucione në varësi, për zhvillimin e punimeve në rrugët e Njësive Pojan, Maliq si dhe për hapjen e proceduarve të konkurrimit për vende të lira pune.

II.4 Me shkresën nr.15016 Prot., datë 30.04.2025, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, informon se nuk është depozituar pranë tyre asnjë denoncim për Bashkinë Maliq apo institucione në varësi të saj, për fakte dhe të dhëna të cilat i përmban kallëzimi penal që po trajtohet.

II.5. Me shkresën nr.14370 prot., datë 28.04.2025, Bashkisë Maliq i është kërkuar dokumentacion dhe informacion nëse gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill të vitit 2025 janë zhvilluar punime/asfaltime/riparime në rrugët e Njësive Administrative Pojan dhe Maliq.

II.6 Me shkresën kthim përgjime nr.15096 prot, datë 02.05.2025, Bashkia Maliq ka vendosur në dispozicion informacionin dhe dokumentacion në lidhje me kërkesën nëse gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill të vitit 2025 janë zhvilluar punime/asfaltime/riparime në rrugët e Njësive Administrative Pojan. Nga aktet e administruara rezulton Bashkia Maliq ka parashikuar në regjistrin e Prokurimeve Publike për vitin 2024 disa procedura prokurimi. Procedurat e prokurimit janë zhvilluar në vitin 2024, kontratat janë lidhur në vitin 2024 dhe punimet kanë filluar në vitin 2024.

Bashkia Maliq ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: "*Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023*"

-Procedura e prokurimit ka filluar me parashikimin në regjistrin e prokurimit të vitit 2024.

-Për këtë procedurë prokurimi është nxjerr urdhëri i prokurimit për fillimin e procedurës së prokurimit nr. 8, datë 06.02.2024, me objekt: "*Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023*", me numër reference, RIEF-00334-04-05-2024, me vlerë 39.998.648 me tvsh.

-Për këtë procedurë prokurimi është lidhur kontrata me nr. 3662 prot, date 01.08.2024 ndërmjet Bashkisë Maliq dhe operatorit ekonomik "*Niem*" shpk me afat të kryerjes së punimeve 2 (dy) muaj.

-Kontrata është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.47, date 12 gusht 2024.

-Sipas projektit të miratuar dhe preventivit të punimeve, në këtë objekt janë parashikuar punime të cilat do të kryhen në Njesitë Administrative Përgj, Pojan, Vreshtas, Libonik, Maliq.

-Për Njësine Administrative Pojan janë parashikuar të kryen punimet :

- o Sistemim asfaltim fshati Rembec
- o Sistemim asfaltim rrugë fshati Orman
- o Sistemim Asfaltim fshati Pojan Sistemim asfaltim fshati Terove

-Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 07.08.2024, sipas shkresës të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3662/2 prot, date 09.08.2024.

- Me shkresë të protokolluar pranë Bashkisë Maliq nr. 3662/4 prot, datë 09.10.2024 është bërë njoftimi për përfundimin e punimeve në datën 07.10.2024, për Njësitë Administrative Pirq, Pojan, Libonik, Maliq.

- Nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime ka filluar implementimi i projektit me objekt: "*Rikonstruksion i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq*" Pranë Bashkisë Maliq është protokolluar shkresa me nr. 4161 prot, date 16.09.2024 me lëndë "Njoftimi për fillimin e punimeve rikonstruksion i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq", ku njoftohet fillimi i punimeve në datën 12.09.2024 në këtë objekt. Duke qenë se AKUK ka filluar implementimin e projektit për ndërtimin e ujësjellesit në fshatin Podgorie, nga ana e Bashkisë Maliq me shkresë nr.4307/1prot, date 25.09.2024 me lëndë: "*Kërkesë për pezullim punimesh*", janë marre masa për pezullimin e punimeve në objektin: "*Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023*", pasi ndërtimi i ujësjellesit duhet të bëhet përpara shtrimit të shtresave të asfaltit.

- Në përfundim të objektit: "*Rikonstruksion i skemës së furnizimit me ujë për fshatin Podgorie, Bashkia Maliq*", është bërë njoftimi i rifillimit të punimeve në datën 21.03.2025 në objektin: "*Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023*", sipas shkresës nr. 1801/2 prot, datë 28.03.2025.

- Me shkresë nr. 1940 prot, date 28.03.2025 me lëndë : Njoftim përfundim të punimeve në objektin "*Shtresë tapeti rrugët e vitit 2023*", kanë përfunduar punimet e pa kryera në fshatin Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas. Në këtë objekt kanë përfunduar të gjitha punimet sipas kontratës. Objekti është në fazë kolaudimi dhe dosja e zbatimit të punimeve së bashku me dokumentacionin e punimeve i janë vendosur në dispozicion kolaudatorit të punimeve.

Për këtë kontratë punimet në Njësinë Administrative Pojan, Bashkia Maliq kanë përfunduar në vitin 2024.

Bashkia Maliq ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt : "*Sistemim asfaltim rrugë viti2024*"

-Procedura e prokurimit ka filluar me parashikimin në rregjistrin e prokurimit të vitit 2024. Për këtë procedurë prokurimi është nxjerrë urdhëri i prokurimit për fillimin e procedurës së prokurimit nr.44, date 13.06.2024 për objektin: "*Sistemim asfaltim rrugë viti 2024*", me numër reference REF-09853-06-19-2024, me vlerë, 62.498.281 leke pa tvsh

-Procedura e prokurimit është publikuar në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.32, datë 24 qershor 2024. Për këtë procedurë prokurimi është lidhur kontrata me nr.4067 prot, datë 06.09.2024 ndërmjet Bashkisë Maliq dhe operatorit ekonomik "Ruga ura Asfaltim nr.2 Elbasan" shpk, me afat të kryerjes së punimeve 4 (katër) muaj. Kontrata është publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.60, datë 16 shtator 2024.

-Sipas projektit të miratuar dhe preventivit të punimeve, në këtë objekt janë parashikuar punime të cilat do të kryhen në Njësitë Administrative Libonik, Pirq, Pojan, Vreshtas, Maliq. Për Njësinë Administrative Pojan janë parashikuar të kryen punimet: Sistemim asfaltim rruga fshati Shëngjergj/Sistemim asfaltim sheshi kisha Pendavinj/Sistemim asfaltim rrugë të brendëshme Pojan.

Punimet në këtë objekt kanë filluar në datën 26.09.2024, sipas shkresës të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 4067/3 prot, date 26.09.2024.

-Sipas grafikut të punimeve, punimet për këtë objekt duhet të përfundonin në datën 25.01.2025.

Për arsye të kushteve klimatike operatori ekonomik dhe mbikqyresi i punimeve me shkresë të protokolluar pranë Bashkisë Maliq përkatësisht me nr. 4067/5 prot, datë 14.01.2025 kanë

-Punimet kanë rifilluar me shkresë të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 1588, date 12.03.2025 me lëndë: "Njoftim për rifillimin e punimeve".
-Me shkresën nr. 5881prot, datë 28.03.2025 me lëndë: "Njoftim përfundim të punimeve", kanë përfunduar punimet në objektin: "Sistemim asfaltim rrugë viti 2024". Objekti është në fazë kolaudimi dhe dosja e zbatimit të punimeve së bashku me dokumentacionin e punimeve i janë vendosur në dispozicion kolaudatorit të punimeve. Procedurat e prokurimit të mesipërme kanë qënë të parashikuara në vitin 2024 si dhe kontratat janë lidhur në vitin 2024. Punimet në këto objekte janë filluar në vitin 2024 dhe janë kryer sipas afateve dhe grafikut të përcaktuar në kontratë.

-Në lidhje me kërkesën për informacion nëse Bashkia Maliq apo institucioneve në varësi të saj kanë shpallur apo hapur procedurë konkurrimi për vende të lira pune për muajt janar/shkurt/mars/prill 2025, rezulton se nga aktete e administruara ana e Bashkisë Maliq është miratuar Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 129, datë 26.12.2024 "Për miratimin e numurit të punonjesve në nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë", ku është miratuar numëri maksimal i punonjësve të Bashkisë Maliq dhe pozicionet e punës.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq ka marrë vendimin nr. 5, datë 12.02.2025 "Për planin vjetor të pranimi për vitin 2025, pjesë e shërbimit civil", ku janë përcaktuar pozicionet vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2025.

II.7 Me shkresën nr.14372 prot., datë 28.04.2025 i është kërkuar informacion Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nëse Bashkia Maliq apo institucionet në varësi të saj kanë dërguar pranë AKPA procedura konkurrimi për vende të lira pune.

II.8 Me shkresën kthim përgjigje nr.15326 prot., datë 02.05.2025, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, informon në lidhje me kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar nga Bashkia Maliq për procedura konkurrimi për vende të lira pune për periudhën Janar, Shkurt, Mars, Prill 2025.

Nga aktete e administruara rezulton se në lidhje me kallëzimin për punësimet, me shkresën nr. 735 prot, datë 13.02.2025 "Dërgohen formularët për shpalljen e pozicioneve vakante të Bashkisë Maliq", nga Bashkia Maliq janë dërguar për publikim formularët për shpalljen e pozicioneve vakante pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 26.02.2025 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025", pika 13 ku thuhet se: "Departamenti i administratës publike merr masat e nevojshme që gjatë fushatës zgjedhore të mos publikojë vendet vakante të shërbimit civil të institucioneve të administratës shtetërore dhe të pezullojë të gjitha fazat e proceseve të rekrutimit në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore të nisura para datës 11 prill.

Titullari i Institucionit ka nxjerrë Urdhërin nr. 156, datë 13.03.2025 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Maliq gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025", pika 5 dhe pika 6, në të cilin ndalohen shpalljet e pozicioneve vakante dhe pezullohen procedurat

Bazuar në Vendimet e mësipërme nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq është marrë Vendimi nr. 3, datë 13.03.2025 "Për pezullimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të nisura pra datës 11 prill 2025", me të cilin janë pezulluar procedurat e rekrutimit të shpallura dhe nuk janë shpallur procedura rekrutimi të nëpunësve civil.

Procedurat e shpallura nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq për rekrutim në shërbimin civil janë pezulluar gjatë periudhës zgjedhore sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.122, datë 26.02.2025 nga data 13.03.2025 deri në përfundim të periudhës zgjedhore.

II.9. Me shkresën nr.15360 prot., datë 05.05.2025, Bashkisë Maliq për nevoja të verifikimeve në kuadër të kallëzimit nr.119, datë 28.04.2025 i është kërkuar një kopje e plotë e dokumentacionit të procedurës së prokurimit "Sistemim asfaltim rrugë 2025", me nr. Ref-41656-03-19-2025, me fond limit 83.332.941, përfshirë dhe dokumentacionin e zbatimit të kontratës për këtë procedurë, në Pojan, Maliq; Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit për vitin kalendarik 2025, së bashku me ndryshimet deri në kthimin e përgjigjes; Një kopje të planit të buxhetit për vitin 2025; Vendim të Këshillit Bashkiak së bashku me relacionet përkatëse në lidhje me detajimin e buxhetit dhe miratimin e fondeve për vitin 2025;

II.10 Me shkresën kthim përgjime nr.15573 prot, datë 06.05.2025, Bashkia Maliq ka vendosur në dispozicion informacionin dhe dokumentacion. Nga analiza e akteve, rezulton se Bashkia Maliq ka miratuar buxhetin e vitit 2025 me Vendimin nr. 130, datë 26.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025", ku Vendimi është shoqëruar me "Relacion, Tabelat e shpërndarjes së fondeve për vitin kalendarik 2025 dhe për fondet të cilat janë të shtrirë në vitet e tjera", gërma "A", pika II, "Shpenzime", pika 4, gërma a), ka miratuar tabelën e shpenzimeve dhe investimet të cilat do të kryhen nga Bashkia Maliq për vitin 2025 si dhe objektet të cilat do të jenë të shtrira në kohë për më shumë se një vit kalendarik.

Objekti "Sistemim asfaltim rrugë viti 2025", është i shtrirë në kohë për periudhën 2025 - 2027, të cilat nuk përkojnë me vitin zgjedhor.

Bazuar në Buxhetin e miratuar të Bashkisë Maliq për vitin 2025, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit në Bashkisë Maliq ka hartuar Rregjistrin e Parashikimeve për procedurat e prokurimit dhe ndryshimet përkatëse të cilat janë dërguar në degën e thesarit Korçë Rregjistri i parashikimeve është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Bazuar në rregjistrin e prokurimit publik Autoriteti Kontraktor ka filluar procedurën e prokurimit:

1.Urdhër Prokurimi Nr.13, datë 21.02.2025 i cili përmban :

- Projekt Zbatim "Sistemim asfaltim rrugë viti 2025".
- Preventiv
- Grafik punimesh
- Specifikime teknike dhe Relacion teknik.
- Procedura e prokurimit

Procedura e hapur- Punë - Sistem elektronik

Fondi limit : 83.332.941(tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet e nën) leke në tvsh: 99 999 529(nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e

Afati i punimeve : 5 muaj

Nr. REF -41656-03-19-2025

2. Formularët e deklarimit të konfliktit të interesit nga antarët e Njesisë e prokurimit .
3. Urdhër Nr.114, date 21.02.2025 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave"
4. Formularët e deklarimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.
5. Urdhër Kërkesë-Blerja Nr.13 date 24.02.2025.
6. Proces - verbal "Për hartimin e dokumentave të tenderit" datë 19.03.2025.
7. Njoftimi i shkurtuar i kontratës "Sistemim asfaltim rrugë viti 2025" .
8. Dokumentat standarte të tenderit
9. Proces verbal për shtojce në dokumentat e tenderit datë 21.03.2025.
10. Shtojce për dokumentat e tenderit date 21.03.2025, (bashkëngjitur email nga Agjencia e prokurimit publik për rekomandim mbi procedurën e prokurimit date 21.03.2025).
11. Buletini i Agjencisë së prokurimit publik Nr.14,date 25 Mars 2025.
12. Proces-Verbal si afat i fundit për pranimin e ofertave për procedurën date 04.04.2025.
13. Proces- Verbal i hapjes së ofertave datë 04.04.2025.
14. Formulare deklarimi të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
15. Kërkim informacioni drejtuar personit përgjegjës date 07.04.2025 "Për gjendjen Gjyqësore të administratorëve të operatorëve ekonomik".
16. Kthim përgjigje për KVO nga Njësia e Prokurimit datë 10.04.2025.
17. Proces verbal i vlerësimit të ofertave datë 10.04.2025.
18. Renditja përfundimtare nga sistemi elektronik.
19. Proces - verbal për përfundimin e fazës së vlerësimit të ofertave për tenderin datë 10.04.2025.
20. Kërkesë për dokumentacionin administrativ ligjor me Nr.2198 Prot datë 11.04.2025 për operatorin ekonomik "VASHTEMLIA"shpk .
21. Kërkesë për ndryshim klasifikimi nga Operatori Ekonomik "AVDULI"shpk Nr.26 prot datë 12.04.2025.
22. Kthim përgjigje Nr 2252/1prot, date 15.04.2025 për Operatorin Ekonomik"AVDULI" shpk.
23. Shkresë me llosh "Dorezim dokumentacioni" në lidhje me dokumentacionin administrativ ligjor me Nr. 2198/1.Prot, date 15.04.2025, të operatorit ekonomik "Vashtemia" shpk.
24. Proces verbal shqyrtim dhe vlerësim dokumentacioni date 18.04.2025.
25. Formulari i njoftimit të fituesit paraprak.
26. Publikimi i Njoftimit paraprak të fituesit në Buletin nga APP Nr.21,date 28 Prill 2025.
27. Në përfundim të afatëve të ankimimit nuk pati ankesa.

II.11 Për sqarimin e rrethanave të kallëzimit penal, në datën 06.05.2025 është marrë deklarim shtetasit Genci Floqi, me detyrë Drejtor i Burimeve Njërëzore, Prokurimeve Publike dhe Çështjeve Ligjore në Bashkinë Maliq. Gjatë deklarimit ai spjegoi se procedura e prokurimit "Sistemim asfaltim rrugë 2025" është parashikuar në fillim të vitit kalendarik 2025, dhe më pas është dërguar në Degën e Thesarit Korçë. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq, me vendimin nr. 130, datë 26.12.2024 është "Miratimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025", është parashikuar që gjatë vitit 2025 të realizohen dy investime të shtrira në kohë për periudhën 2025-2027, ku një ndër to është "Sistemim asfaltim rrugë 2025". në shumën 100.000 mijë lekë. të ndara në zëra si për vitin

Procedura është në fazën e njoftimit të fituesit paraprak. Është publikuar në buletin e APP, ka përfunduar afati ankimor prej 7 ditësh dhe nuk ka patur ankesa. Tani është faza për hedhjen e njoftimit përfundimtar të fituesit. Pas publikimit në buletin e APP, hapet faza për lidhjen e kontratës e cila ka afat 60 ditë për lidhjen e saj. Dhe më pas fillojnë punimet. Në lidhje me këtë procedurë, ai thekson se nuk kanë filluar punimet dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme. Procedura nuk përfundon para datës 11.05.2025, që është data e zgjedhjeve dhe nuk mund të zhvillohim asnjë procedurë për shkak se duhet respektuar kërkesat e ligjit dhe Kodit Zgjedhor. Gjithashtu në lidhje me këtë procedurë prokurimi është bërë denocimi nr. 80 pranë KQZ, ai deklaron se është marrë vendimi dhe është vendosur rrëzimi i kërkesës.

II.12 Në datën 05.05.2025 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me prova dhe fakte shtesë në lidhje me kallëzimin e paraqitur nga Partia Demokratike në datën 24.04.2025, me nr.360 prot.

II.13 Partia Demokratike, e përfaqësuar nga deputetja Albana Vokshi me kthim përgjigjen nr. 360/2, prot., datë 06.05.2025 ka vënë në dispozicion të njëjta fakte si në kallëzimin fillestar, të cilat kanë të bëjnë me publikim e procedurës së prokurimit "Sistemin asfaltimi rrugë 2025" dhe në lidhje me shpalljen e njoftimit për vende vakante të lira pune në periudhën parazgjedhore.

Në analizë sa më sipër rezulton e provuar se procedura e prokurimit është në fazë procedurale, pa shpallje përfundimtare të fituesit. Në këto kushte nuk ka përfutur nga fondet publike asnjë subjekt privat apo i lidhur me procesin zgjedhor. Duke qenë në këtë fazë dhe nga verifikimet e kryera, nuk është kryer asnjë akt publik apo promovim që lidhet me asfaltimin e rrugëve, sic është pretenduar nga kallëzuesi, e si rrjedhojë rezulton se nuk ekziston një raport i drejtëpërdrejtë midis procedurës së prokurimit dhe votës së zgjedhësve në zonën e Maliqit, Korçë.

Nga aktet e administruara rezulton se procedura e prokurimit "Sistemin asfaltim rrugë 2025" është pjesë e një plani buxhetor të parashikuar më herët si dhe është pjesë e një buxheti të shtrirë në kohë për më shumë se një vit kalendarik.

Nga aktet e administruara dhe verifikimet e kryera në kuadër të këtij materiali kallëzues rezulton se Bashkia Maliq akoma nuk ka lidhur kontratë për vitin 2025, me operator ekonomik për këtë procedurë prokurimi të pretenduar në kallëzim dhe për rrjedhojë nuk ka punime të kryera lidhur me këtë procedurë të pretenduar në kallëzim.

Gjithashtu nga verifikimet e kryera rezulton se në sistemin e Agjensisë së Prokurimit Publik nuk ka një njoftim përfundimtarë për fituesin e kësaj procedure tenderimi.

III. Kuadri Ligjor

III.1 Në lidhje me veprën penale "Shpërdorim i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, parashikohet shprehimisht: *"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet."*

Nga ana objektive vepra penale e shpërdorimit të detyrës kryhet me veprime aktive të

ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës. Pra, elementi i parë i anës objektive të kësaj vepre penale janë veprimet ose mosveprimet e kryera nga personi i ngarkuar me një funksion publik, të cilat duhet domosdoshmërisht të jenë kryer:

-Në kundërshtim me ligjin ose ligjet që normojnë veprimtarinë përkatëse të personit që ushtron funksion publik konkret;

-Të përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës.

-Të kenë sjellë si pasojë përfitime materiale ose jomateriale për vetë personin ose për persona të tjerë ose të kenë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

Pra, nga ana objektive kjo vepër kryhet me veprime ose mosveprime, të cilat synojnë të pengojnë zbatimin e ligjit, por kjo karakterizohet, *së pari*, nga fakti se veprimi a mos veprimi duhet të kryhet nga personi që e ka për detyrë ta bëjë këtë veprim, dhe *së dyti*, që veprimi ose mosveprimi, të jetë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm. Nëse veprimi ose mos veprimi i kryer nuk kanë lidhje me detyrën dhe kompetencat e dhëna, nuk ndodhemi përpara veprës penale që parashikon neni 248 i Kodit Penal.

Nga kjo dispozitë rezulton se, ligjvënësi i ka cilësuar si marrëdhënie juridike të rëndësishme, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislacioni penal, marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përbushjen e rregullt të detyrës, zbatimin e ligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore. Në këtë kuptim, neni 248 i Kodit Penal, i sipërcituar është një dispozitë "*blanket*", e cila i referohet akteve të tjera ligjore që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike.

III.2 Neni 328 i Kodit Penal "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" parashikon se:

"Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet."

Objekt i veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve duke i dhënë një mbrojtje juridike të posaçme me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive vepra penale kryhet me veprime ose mosveprime në një çfarëdo forme:

- Me ofrimin ose dhënien e të hollave, të mirave materiale (nuk ka rëndësi shuma e të hollave të ofruar ose të dhëna). Të mirat materiale mund të jenë edhe në formën e dhuratave, ushqimeve, shtrimit e rrugëve, zgjidhjen e problemeve të pronësisë etj.

- Me bërjen e premtimeve për vende pune kryesisht për ata që janë të papunë si dhe favorizime të tjera për ofrim të një vendi tjetër pune, gradime, transferime etj.

Këto forma korrupsioni përdoren me qëllim orientimin e votës dhe shtyrjen për të votuar në një mënyrë të caktuar pro një kandidati të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime ose për t'u angazhuar në mbështetjen e një kandidati përmes veprimeve të paligjshme.

III.3 Kodi Zgjedhor (ligji 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar) në nenin 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)" parashikon: "1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme,

përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. 3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë. 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. 5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike."

Neni 92: Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) 1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. 2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. 3. Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. 4. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit "Ndaluar nga KQZ-ja" në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë. Shënimi "Ndaluar nga KQZ-ja" vendoset jo më vonë se dy ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga publiku, nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. 5. Veprimtaritë e ndaluara nga KQZ-ja nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv. 6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, sanksionohet ndalimisht nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin

shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni, miratohen nga KQZ-ja me akt normativ.

III.4 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “c”, dhe nenit 91 të ligjit nr. 10091, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH, të ndryshuar,” ka miratuar vendimin nr. 9, datë 13.02.2025, “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike” ku parashikon “Kategoritë e ndalimeve”. Sipas pikës II.1 “Ndalimin për miratimin e akteve juridike” parashikohet se: “1. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj..., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore apo të parashikuar përpara afatit të ndaluar, sipas këtij vendimi. 2. Kryetari i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe Kryetari i Bashkisë marrin masa për të mosvendosur, ose propozojnë të mosvendosen në rend të dritës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim akte të përmendura në pikën II.1.1”.

Pika II.2 “Ndalime për promovimin e veprimtarive publike”, parashikon se:

“1. Janë të ndaluara veprimtaritë publike me karakter politik të institucioneve publike për: a) promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim të interesit publik. b) promovimin e projekteve dhe ose të investimeve, kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut. c) promovimin e projekteve dhe ose të investimeve për mbrojtjen e monumenteve dhe objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor ose për mbrojtjen e objekteve të luajtshme me vlerë historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore. d) promovimin e projekteve dhe ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi. e) shpërndarjen në aktivitet publik të lejeve të legalizimeve; dh) shpërndarjen e akteve për regjistrimin e tokës bujqësore apo çdo lloj pronësie tjetër sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë si dhe të regjistrimit të titujve të pronësisë sipas ligjit “Për kadastrën”. e) promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

2. “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë edhe veprimtaritë publike të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit sipas përkufizimit të nenit I.2, pika 3, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion , apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë, por pa u kufizuar, si përdorimin e fondeve publike për mbështetje të subjekteve zgjedhore, vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuar në nenin 142 të kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor të institucioneve. 3. Ndalimet e mësipërme nuk përfshijnë përmbushjen e përgjegjësisë ligjore, si dhe ushtrimin e detyrave funksionale të institucioneve publike dhe të funksionarëve përkatës.”

Pika II.3 Ndalime të përdorimit të aseteve, parashikon se:

“1. Ndalohet vënia direkt ose indirekt në dispozicion të partive politike dhe/ose subjekteve zgjedhore të mjeteve materiale dhe monetare në pronësi, apo në administrim të institucionit publik. 2. Në përputhje me fushën e përgjegjësisë, funksionari i institucionit publik mund të zhvillojë veprimtari publike si të tilla, por pa u kufizuar si: inspektime, takime, konsultime publike, prezantimeve të projekteve me interes komunitar etj. me kushtin që nicsëmarrës në

qartazi kanë lidhje përgjegjësie ose bartin të drejta dhe detyrime me dhe nga veprimtaria. Por ndalohet me këtë rast pjesëmarrja në aktivitet e përfaqësuesve politikë, deputetëve që nuk i përkasin zonës zgjedhore ku zhvillohet veprimtaria, si dhe promovim politik dhe elektoral në çdo formë, direkt apo indirekt. 3. Në zhvillimin e një veprimtarie partiake, në të cilën promovohet një punë publike apo një projekt i caktuar, ndalohet përdorimi i shenjave dhe simboleve të institucioneve publike. 4. Në zhvillimin e një veprimtarie partiake ose elektorale ndalohet përdorimi në çdo formë i automjeteve të institucioneve publike, me përjashtim të rastit kur përdorimi i tyre lidhet me ruajtjen dhe sigurisë personale fizike të funksionarit publik për shkak të statusit të këtij të fundit”.

IV. Analiza e faktit dhe e ligjit

IV.1 Në kallëzimin penal pretendohet se nga ana e kryetarit të Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi (Kodi Zgjedhor, neni 91 e vijues) po kryen punime për asfaltimin e rrugëve duke përdorur asetet publike, në kohë zgjedhjesh në shkelje të ligjit.

IV.2. Nga aktet e administruara në funksion të këtij kallëzimi penal, rezulton se nga ana e Bashkisë Maliq, procedura e prokurimit “Sistemim asfaltim rrugë 2025”, me nr. Ref-41656-03-19-2025 nuk kanë filluar punimet, pasi nuk është proceduar me lidhjen e kontratës me Operatorin ekonomik fitues.

IV.3. Përsa i përket pretendimit në lidhje me shpalljen e njoftimit për vende të lira pune në peiudhën zgjedhore, nga aktet e administruara rezulton se nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq është marrë Vendimi nr. 3, datë 13.03.2025 “Për pezullimin e procedurave të rekrutimit në sherbimin civil te nisura pra datës 11 prill 2025”, me të cilin janë pezulluar procedurat e rekrutimit të shpallura dhe nuk janë shpallur procedura rekrutimi të nëpunësve civil. Procedurat e shpallura nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq për rekrutim në sherbimin civil janë pezulluar gjatë periudhës zgjedhore sipas percaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.122, datë 26.02.2025 nga data 13.03.2025 deri në përfundim të periudhës zgjedhore.

IV.4. Pretendimi i kallëzueses në këtë material kallëzues është për konsumimin e veprës penale të “Shpërdorimi të detyrës” ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq, për asfaltimin rruge në Maliq. Nga veprimet verifikuese të kryera në funksion të këtij kallëzimi penal, rezulton se nga ana e shtetasit Gëzim Topçiu, nuk është konstatuar të jetë konsumuar ndonjë element i kësaj vepre penale. Nuk është konstatuar ndonjë veprim i kryer në kundërshtim me ligjin nga ana e kryetarit të Bashkisë Maliq që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës.

IV.5. Në lidhje me konstatimin e shkeljeve të tjera, të cilat edhe pse nuk përmenden nga kallëzuesit, por mund të interpretohen nga vetë përmbajtja e materialit kallëzues, që mund të orientohen në drejtim të veprës penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, rezulton se në kuadër të zhvillimit të një procesi zgjedhor të ndershëm dhe transparent, Komisioni Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka miratuar Vendimin Nr. 9, datë 13.02.2025 “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Ky vendim ka si qëllim, marrjen e masave, monitorimin dhe parandalimin e veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare e logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore gjatë periudhës kohore katër muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, si dhe gjatë fushatës zgjedhore, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor si dhe mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

IV.6. Nga përmbajtja e vendimit Nr. 9, datë 13 shkurt 2025 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, qëllimi i këtij rregullimi nënligjor, ka qenë përcaktimi i veprimtarive të ndaluara, synimi i parandalimit të veprimtarive të ndaluara nëpërmjet përdorimit të gabuar, të burimeve njerëzore, financiare e logjistike gjatë periudhës kohore para zgjedhjeve, me synim krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët apo partive politike, si dhe përcaktimi i rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore dhe vendore, agjencive dhe enteve shtetërore etj.

Veprimtari publike sipas Nenit 2/b të këtij vendimi janë: *"të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për publikun dhe të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, të kryera brenda ose jashtë vendit nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë agjendë informimin për periudhën katër mujore para datës të zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve"*.

Sipas nenit 4 të këtij vendimi parashikohet që: *"Veprimtari e ndaluara është çdo veprimtari apo akt i institucionit publik dhe/ose i administratës shtetërore, e cila keqpërdor asetet publike dhe ndalohet për tu kryer*.

Sipas kreut II "Kategoritë e ndalimeve", pika II.1 "Ndalime për miratimin e akteve juridike", pika parashikohet: *"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj..., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore apo të parashikuar përpara afatit të ndaluar, sipas këtij vendimi*.

Në parashikimin që ligjvënësi ka bërë në nenin 328 të K.Penal kërkohet që vota apo zgjedhësi të jetë i përcaktuar i njohur dhe veprimet e personit të dyshuar t'i jenë kundërtuar, të kenë pasur për objekt një apo disa zgjedhës konkret me qëllim deformimin e vullnetit të tyre. Ofrimi i të mirave ka një qëllim të posaçëm dhe qëllimi është element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale dhe si i tillë duhet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në rastin konkret, konstatohet se nuk jemi para provave/indicjeve që të mbështesin konsumimin e veprës penale e "Korrupsionit aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Nga aktet dhe të dhënat e paraqitura si dhe ato të administruara, nuk evidentohet se janë ofruar apo dhënë të mira materiale, apo se janë kërkuar ose pranuar të mira materiale etj, me qëllim dhënien e ndonjë firme për paraqitje kandidati në zgjedhje apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Korrupsioni është një marrëveshje mes dy palëve dhe në rastin konkret, nuk rezulton se ka një marrëveshje të tillë midis banorëve të Bashkisë Maliq dhe kryetarit të Bashkisë Maliq apo nëpunësve të Bashkisë, me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar. Vetë kallëzuesit kanë parashtruar dyshime se punimet po kryhen me qëllim ndikimin e padrejtë në zgjedhje, por nga verifikimet e kryera nuk rezultoi të mbështetej në ndonjë provë apo indicie konkrete. Ndodhur në këto kushte, mbi bazë të akteve të administruara gjatë hetimit nuk evidentohen të dhëna të tilla që të provojnë kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit aktiv në zgjedhje".

IV.8. Sa më sipër u arsyetua, organi procedues vlerëson se nuk ka të dhëna për fillimin e procedimit penal për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" apo të ndonjë vepre tjetër penale, përse kohë nuk u konstatua asnjë indicie me vlerë provuese, në këtë drejtim, apo vepra të tjera penale në kompetencë lëndore nga Prokuroria e Posaçme dhe për rrjedhojë procedimi penal nuk mund të fillojë.

Neni 290 i K.Pr. Penale parashikon: “*Procedimi penal nuk mund të fillojë kur... pika ç... fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë se fakti nuk ekziston..*”


Nga sa më sipër, procedimi penal nuk mund të fillojë, pasi fakti nuk përbën vepër penale. Nga analiza e fakteve dhe provave të sipërcituara rezulton se faktet e pretenduara nga kallëzimet nuk përmbajnë elementë të ligurës të veprës penale “*Shpërdorim detyrë*”, “*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*”, parashikuar përkatësisht nga nenet 248 dhe 328 të Kodit Penal, apo ndonjë tjetër veprë penale në kompetencë lëndore nga Prokuroria e Posaçme. Për këto arsye mbështetur në nenet 290/1 gërma ç) dhe 291/1/2 të K.Pr.Penale:

VENDOSA:

1. Mosfillimin e procedimit penal, që ka të bëjë me kallëzimin penal nr. 119 datë 14.04.2025.
2. Të njoftoj me këtë vendim kallëzuesit, të cilët kanë të drejtë të bëjnë ankim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e organizuar Tiranë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI

VLADIMIR MARA





Partia
Demokratike

Nr. 360 Prot.

Tiranë, më 24/04/2025

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES: NJË GRUP DEPUTETËSH TË PARTISË DEMOKRATIKE, nënshkrues të këtij kallëzimi, Adresa për efekt komunikimi: Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë, email: pd@rithemclimi.com

OBJEKTI: Kallëzim i veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

KUNDËR: Gëzim TOPÇIU Kryetarit të Bashkisë Maliq

Çdo shtetasi të identifikuar në këtë kallëzim dhe ende të painedifikuar deri më tani, i cili nga ky hetim do të rezultojë me përgjegjësi penale.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Neni 248, 328/a dhe 331/a të Kodit Penal të ndryshuar;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale;
Kodi Zgjedhor i ndryshuar;
Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"

DREJTUAR: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR- SPAK.

*Të nderuar Prokurorë të SPAK,
Të nderuar Z. Dumani, Drejtues i SPAK*

Unë kallëzuesi subjekti politik "Partia Demokratike", Dega Tiranë, ditët e fundit kam rënë në dijeni të veprimtarisë penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal "Shpërdorimi i detyrës", për të cilën ekziston dyshimi serioz se mund të jetë konsumuar nga ana e Kryetarit të Bashkisë Maliq, Gëzim Topçiu.

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim këtë kallëzim për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprës penale.

RRETHANAT DHE FAKTET:

Kemi vendosur të paraqesim sot në Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) këtë kallëzim penal ndaj Kryetarit të Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu, nisur nga shkeljet e Kushtetutës dhe Kodit Penal, veprime këto të kryera në dëm të deputetëve të opozitës dhe të qytetarëve shqiptarë.

Viti 2025 është një vit elektoral në Shqipëri për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvend në datën 11 Maj 2025. Për të garantuar një proces zgjedhor të barabartë midis forcave politike, një garë me njëte të barabarta dhe të ndalohet ndikimi te zgjedhësit, Kodi Zgjedhor, Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” dhe Kodi Penal kanë parashikuar një sërë veprimtarish të ndaluara për mos t’u kryer nga institucionet publike dhe funksionarët publikë.

Rezulton se, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në buletin nr. 14 datë 25 Mars 2025 është publikuar një procedurë prokurimi nga Bashkia Maliq, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, Vendimin nr. 9/2020 dhe njëdhimisht, në kundërshtim me Kodin Penal.

Ky fenomen njihet ndryshe si “*asfalti elektoral*” i cili po zbatohet në masë nga të gjitha bashkitë e vendit dhe në kundërshtim me ligjin.

Njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit përmban këto të dhëna:

- *Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Maliq*
- *Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur pune*
- *Objekti i kontratës: Sistemin asfaltim rrugë 2025*
- *Numri i referencës së procedurës: REF-41656-03-19-2025*
- *Fondi limit: 83.332.941 Lek pa Tvsh*
- *Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj*
- *Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04.04.2025 (d/m/v) Ora: 10:00*

Shpallja e procedurave të prokurimit publik para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Ne dyshojmë se Kryetari i Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu ka konsumuar veprën penale të nenit 248 të Kodit Penal, pasi shpallja e kësaj procedure prokurimi jo vetëm që është bërë në kundërshtim me ligjin dhe në periudhë parazgjedhore, por synon favorizimin e një pale të caktuar, e cila do të jetë pala ose shoqëria që do të shpallet fituese e kësaj procedure ose një kandidat politik i caktuar.

Përveç, këtij rasti, sjellim para jush një tjetër shkelje të kryer nga Kryetari i Bashkisë Maliq, i cili po në shkelje të ligjit ka shpallur njoftim për vende të lira pune në periudhë parazgjedhore. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Për më tepër, me anë të një njoftimi publik Qeveria ndalon punësimet në administratë në prag të zgjedhjeve. Konkretisht, Ministria e Shtetit për Administratën, Adea Pirdeni njoftoi se në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare të 11 Majit ky vendim është marrë për të garantuar një proces të rregullt zgjedhor.

Ministria Pirdeni është shprehur se *“Por në këtë vendim ne kemi kaluar në një nivel tjetër për të garantuar një standard edhe më të lartë të garantimit të paanshmërisë të procesit zgjedhor duke parashikuar që prej datës 3 mars 2025 do të ndalohet çdo procedure rekrutimi nga institucionet që rekrutojnë punonjësit e tyre përmes Kodit të Punës”*.

Në njoftimin e shpallur në AKPA rezulton se vendet vakante janë si vijon:

- Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion)
- Drejtor në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Asteve (1 pozicion)
- Përgjegjës Sektori në Sektorin e Prokurimeve dhe Menaxhimit të Kontratave (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Zyrën Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (1 pozicion)
- Përgjegjës Zyre në Sektorin e Shërbimeve Sociale (1 pozicion)
- Agronom 1 (pozicion)
- Specialist Koordinim Donatore (1 pozicion)
- Nëpunës Finance Protokoll (3 pozicion)
- Specialist Arkitekt Dizanj (1 pozicion)
- Specialist Auditi (1 pozicion)
- Specialist Inxhinier (1 pozicion)
- Specialist/Jurist (2 pozicione)
- Specialist për Prokurimet (2 pozicione)
- Specialist Programues Bazë të dhënash (1 pozicion)
- Specialist Statisticien (1 pozicion)

Premtimi apo marrja në punë para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, për shkak se synon të ndikojë në bindjen politike të zgjedhësve dhe krijon një pabarazi midis forcave politike.

Për të dyja rastet, ne kemi bindjen se nga ana e Kryetarit të Bashkisë është konsumuar vepra penale *“shpërdorimi i detyrës”*.

Duke qenë se këto veprime kanë ndikim të madh në procesin zgjedhor dhe te vota e zgjedhësve vlerësojmë se këto veprime dëmtojnë rëndë procesin zgjedhor transparent, votën e lirë të zgjedhësve dhe mbi të gjitha rezultatin e zgjedhjeve në një shtet demokratik.

JURIDIKSIONI, KOMPETENCA DHE KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM:

Juridiksioni:

Neni 69/1 i Kodit Penal parashikon se “1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”. Duke qenë se kemi të bëjmë me konsumimin e veprës penale të parashikuar nga Kodi Penal, vlerësojmë se jemi përpara juridiksionit të gjykatës penale.

Kompetenca lëndore:

Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

- a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;
- b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;
- c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
- ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.

Në rastin konkret, duke qenë se veprat penale të kryera nga subjekti me detyrë kryetar bashkie përfshihen në nenin 75/a, çmojmë se ky kallëzim penal është në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) për t’u gjykuar.

Ligji i zbatueshëm:

Neni 280 i K.Pr. Penale

Marrja dijeni për veprën penale

“Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.

Neni 283 i K.Pr. Penale

Kallëzimi nga ana e shtetasve

“1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policies gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

Neni 248 i Kodit Penal

Shpërdorimi i detyrës

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Neni 91/3 i Kodit Zgjedhor:

“Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura...”.

Neni 3 pika 1.3 gërma “d” e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:

“1.3 Veprimtari të ndaluara janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

d) gjatë fushatës zgjedhore marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shitesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura...”.

Pika 1 dhe 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...”.

Neni 3 pika 4 e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:

“4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor”.

ANALIZA LIGJORE:

I. Kryerja e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” në lidhje me shpalljen e procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore

Pika 1 dhe 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor parashikon:

“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit...".

Neni 3 pika 4 e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

"4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor".

Ndalimi i përdorimit të burimeve publike para fushatës zgjedhore është një veprimtari e ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020 dhe ka për qëllim ndalimin për t'u vënë në dispozicion ose për t'u përdorur nga një punonjës i administratës publike apo funksionari publik i burimeve dhe asteve publike të cilat institucioni zotëron në sajë të zhvillimit të veprimtarisë publike, ose që i ka nën administrim, siç janë rrugët në rastin konkret, të cilat sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" janë nën administrim të pushtetit vendor dhe në këtë rast të Bashkisë Maliq.

Ndalimi për të përdorur burimet/asetet publike nga funksionari publik lidhen me shkeljen e qëllimshme të parimeve të ligjshmërisë dhe paanshmërisë në administratën publike, me qëllim përfitimin politik apo favorizimin elektoral të një partie të caktuar.

Shpallja e procedurave të prokurimit publik nga një njësi e vetëqeverisjes vendore në periudhën paraprake të fushatës zgjedhore na shtyn të kemi shqetësime të natyrës ligjore dhe etike, pasi këto veprime na krijojnë perceptimin e përdorimit të fondeve publike për qëllime të fushatës, gjë që ndalohet në bazë të dispozitave të mësipërme.

Shpallja e procedurave të prokurimit publik konsiston në kryerjen e veprimeve të jashtëligjshme me dashje, duke dëshiruar pasojat që do të prodhojë ky veprim/vendim dhe pasojat që sjellin në prag të mbajtjes së procesit zgjedhor janë:

- Shkelja e parimit të barazisë zgjedhore

Shkelja e parimeve të barazisë zgjedhore është një nga elementët më të rëndësishëm të një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent. Ky parim ka të bëjë me sigurinë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të kenë mundësi të barabarta për të konkurruar dhe për të prezantuar programet e tyre përpara zgjedhësve. Çdo veprim që bie ndesh me këtë parim përbën shkelje të rëndë të Kodit Zgjedhor dhe sjell pasoja të rënda për legjitimitetin e zgjedhjeve.

Shpallja e procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore përbën mundësi të pastra për përdorimin e resurseve publike në mënyrë të njëanshme për të favorizuar një palë ose kandidat të caktuar, para dhe gjatë periudhës zgjedhore.

- Abuzimi me detyrën publike

Shpallja e procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore përbën shpërdorim të detyrës shtetërore për qëllime zgjedhore, pasi lidhet me përdorimin e fondeve dhe resurseve

publike/të shtetit (staf, mjetet, rruga etj) për përfitime partiake apo individuale, pa i dhënë të gjitha palëve mundësi të barabarta në periudhën zgjedhore.

- Shkelja e ndalimit të propagandës zgjedhore para afatit zgjedhor

Sipas Kodit Zgjedhor, është e ndaluar të zhvillohet propaganda zgjedhore para fillimit të fushatës zgjedhore. Procedurat e prokurimit të cilat shpallen para fushatës zgjedhore konsiderohen si propagandë e ndaluar që favorizon një palë të caktuar që do të jetë fituesi i procedurës, i cili nëpërmjet ndikimit të tij në komunitet arrin të ndikojë dhe në votën e zgjedhësve, për pasojë dhe në rezultatin e zgjedhjeve.

- Përdorimi i burimeve publike për interesa partiake

Shpallja e procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore konsiderohet si përdorim i burimeve dhe shpenzimeve publike për qëllime partiake, dhe si pasojë mund të ndikohet dhe manipulohet procesi zgjedhor në favor të një partie ose kandidati të caktuar.

- Mungesa e transparencës dhe kontrollit

Shpallja e kësaj procedure prokurimi para fushatës zgjedhore dyshojmë të jetë bërë pa respektuar transparencën dhe kontrollin e duhur, duke shkelur legjislacionin në fuqi. Këto veprime kanë krijuar mundësi për shpërdorimin e pushtetit dhe ndikim të padrejtë në zgjedhje. Në këto kushte qytetarët e kanë të vështirë të kuptojnë se cilat veprime janë të financuara me paratë publike dhe cilat janë pjesë e fushatës zgjedhore.

Sipas nenit 248 të Kodit Penal vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” është:

“Kryerja ose moskryerja e veprimeve apo funksioneve nga personi që kryen një funksion publik, me qëllim përfitimi të padrejtë për veten apo për persona të tjerë, kur këto veprime bien ndesh me ligjin dhe sjellin dëm për shtetin apo interesin publik.”

Në rastin konkret, shpallja e kësaj procedure prokurimi:

- Në mungesë të nevojës së menjëhershme ose emergjente;
- Jashtë planifikimit dhe transparencës së kërkuar nga ligji për prokurimet publike
- Në një periudhë kur fillon heshtja zgjedhore e administratës dhe kërkohet neutralitet politik i institucioneve publike (referuar Kodit Zgjedhor dhe praktikave të KQZ-së);

përbën një devijim të qëllimshëm nga funksioni ligjor dhe institucional i bashkisë dhe vë në dyshim qëllimin e përdorimit të fondeve publike.

Ne dyshojmë se qëllimi i procedurës së prokurimit ka qenë:

- Të influencojë opinionin publik në prag të zgjedhjeve;
- Të favorizojë aktorë privatë të lidhur me interesat politike të funksionarëve aktualë;

- Të krijojë avantazh elektoral nëpërmjet përdorimit të aseteve shtetërore

Në këtë kontekst, ky veprim përmbush elementët e veprës penale “Shpërdorim detyrë”, pasi përfshin:

- Kryerjen e një veprimi të paligjshëm;
- të kryer nga subjekt aktiv me funksion publik;
- me pasoja në dëm për interesin publik dhe për barazinë e garës zgjedhore.

Shpërdorimi i detyrës është një vepër penale që lidhet ngushtë me keqpërdorimin e pushtetit ose detyrës që një person mban në një institucion shtetëror apo publik. Sipas legjislacionit shqiptar, kjo vepër penale parashikohet në nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe është një shkelje e rëndë e ligjit, pasi ndikon në besimin e qytetarëve në administratën publike dhe në funksionimin e drejtësisë.

Objekt i veprës penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, të cilat parashikojnë veprat penale që prekin funksionimin e drejtë të aparatit shtetëror, zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Nga ana objektive, vepra penale është kryer nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës dhe që kanë sjellë si pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të shtetasve dhe deputetëve të opozitës.

Subjekti i veprës penale, është subjekt i posaçëm, dhe konkretisht Kryetari i Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçëm favorizimit të një shoqërie private ose të një kandidati apo partie politike dhe ndikimin të vota e lirë e zgjedhësve.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, shpallja e procedurave të prokurimit para fushatës zgjedhore për të gjitha shpjegimet sa më sipër përbën konsumim të veprës penale parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës” nga ana e personit të kallëzuar.

II. Kryerja e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” në lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës para fushatës zgjedhore

Neni 91/3 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura...”

Neni 3 pika 1.3 gërma “d” e Vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon:

“1.3 Veprimtari të ndaluar janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

d) gjatë fushatës zgjedhore marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura...”

Në sajë të *njoftimit publik të Qeverisë*, i cili ndalon punësimet në administratë në prag të zgjedhjeve, duke filluar që nga data 3 Mars, Bashkia Maliq duhet të kishte anuluar këtë shpallje. Ende sot e kësaj dite, kjo shpallje është aktive në faqen e AKPA dhe dyshojmë se vendet vakante janë plotësuar nëpërmjet marrjes në punë.

Premtimi apo marrja në punë para fushatës zgjedhore është e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Kryerja e veprimeve të ndaluara nga ligji gjatë ushtrimit të funksionit publik, përbën konsumim të veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Këtë praktikë nga Bashkia Maliq e kemi denoncuar si të paligjshme dhe në KQZ.

Ligji është i qartë dhe shterues kur përcakton ndalimin e marrjes në punë, lirimin nga puna, lëvizjen apo transferimin në detyrë. Në analizë të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020, në administratë:

- Ndalohet rekrutimi në pozicione të reja gjatë periudhës zgjedhore, përveç rasteve të jashtëzakonshme dhe me miratim nga Departamenti i Administratës Publike;
- Procedurat e konkurseve duhet të jenë të planifikuara në fillim të vitit dhe të bazuara në nevoja reale të administratës, jo në interesa momentale;
- Kodi Zgjedhor (neni 91) ndalon përdorimin e burimeve njerëzore për qëllime elektorale, në këtë rast burime njerëzore cilësohen personat që do të punësohen në këto vende vakante.

Neni 248 i Kodit Penal parashikon:

"Kryerja ose moskryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin nga personi që kryen një funksion publik, me qëllim përfitimi të padrejtë për vete ose për persona të tjerë, kur sjell pasoja të dëmshme për shtetin apo interesin publik, përbën vepër penale."

Në këtë rast, elementët e veprës janë të përmbushur si më poshtë:

- Subjekti aktiv: Funkzionari publik, Kryetari Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu, i cili ka kompetencë për shpalljen e vendeve të punës;
- Veprimi i paligjshëm: Shpallja dhe zhvillimi i procedurave të punësimit në shkelje të ndalesave ligjore zgjedhore ose jashtë planifikimit vjetor;
- Qëllimi: Përdorimi i pozicioneve të punës për të favorizuar individë të lidhur politikisht, për të blerë ndikim elektorale ose për të siguruar vota në këmbim të vendeve të punës;
- Pasojat: Cënimi i parimeve të konkurrencës së ndershme, neutralitetit të administratës, barazisë së qytetarëve dhe integritetit të zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Avokati i Popullit dhe organizatat monitoruese të zgjedhjeve (p.sh. ODIHR, Komiteti Shqiptar i Helsinkit) kanë theksuar në raporte të ndryshme se punësimet në administratë publike në prag të zgjedhjeve:

- Përdoren si mjet ndikimi elektorale;
- Kompromentojnë besimin e publikut në administratë;

- *Krijojnë pabarazi në garën zgjedhore;*
- *Dëmtojnë interesin publik nëpërmjet rritjes së klientelizmit dhe fryrjes së administratës.*

Bazuar në analizën e mësipërme, shpallja dhe zhvillimi i konkurseve për vende të lira pune nga Bashkia Maliq në periudhën para fushatës zgjedhore, kur ato nuk janë të domosdoshme apo emergjente dhe bien në kundërshtim me legjislacionin për administratën publike dhe zgjedhjet, përbën një akt të qëllimshëm të shpërdorimit të funksionit publik.

Ky veprim përmbush elementët e nenit 248 të Kodit Penal ("Shpërdorim detyre"), pasi:

- Shkel ligjin;
- Kryhet nga një funksionar publik në mënyrë të qëllimshme;
- Ka për qëllim përfitim politik ose personal;
- Dëmton interesin publik dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Objekt i veprës penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, të cilat parashikojnë veprat penale që prekin funksionimin e drejtë të aparatit shtetëror, zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Nga ana objektive, vepra penale është kryer nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme, që përbëjnë mospërmbushje të rregullit të detyrës dhe që kanë sjellë si pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të shtetasve dhe deputetëve të opozitës.

Subjekti i veprës penale, është subjekt i posaçëm, dhe konkretisht Kryetari i Bashkisë Maliq Gëzim Topçiu.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçëm favorizimin e disa personave të caktuar, personat që do të fitojnë të drejtën për t'u punësuar dhe ndikimin të vota e lirë dhe bindja politike e zgjedhësve.

Referuar gravitetit të shkeljeve ligjore të kryera nga ana e Kryetarit të Bashkisë Maliq, me dashje direkte dhe duke shkelur Kushtetutën, mospërfillur ligjin dhe duke dëmtuar interesat e ligjshme të zgjedhësve dhe të opozitës, kërkojmë që regjistrimi i këtij kallëzimi penal të kryhet menjëherë.

KONKLuzion:

Të nderuar Prokurorë,

Nga sa analizuam më sipër, rezultojnë përfundimisht dyshime të arsyeshme të bazuara mbi fakte dhe prova se personi i kallëzuar ka konsumuar elementët e veprës penale të lartpërmendur.

Për pasojë, duke paraqitur këtë kallëzim, ftojme Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) të veprojë me urgjencë për vënien para përgjegjësisë penale të personit të kallëzuar.

Përfundimisht, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korupsionit (SPAK), kërkojmë:

Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Gëzim Topçiu me detyrë Kryetar i Bashkisë Maliq, për kryerjen e veprave penale parashikuar nga neni 248 "Shpërdorimi i detyrës" të Kodit Penal të ndryshuar, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë të rrethanave të parashtruara më sipër.

Me respekt,

KALLËZUESIT

Albano Volshe
Flamur Moku
Petrit Doda
EDI PALORA





Partia
Demokratike

Tiranë, më 6.5.2025

Shkresë përcjellëse dokumentacioni

Drejtuar: Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK)
Drejtuesit të Prokurorisë Z. Altin Dumani

Lënda: Kthim përgjigje shkresës datë 05.05.2025 nr. 15463 prot. me lëndë “Kërkohet informacion dhe dokumente” të SPAK

Nga: Partia Demokratike përfaqësuar nga deputetja Albana Vokshi

I nderuar Z. Dumani,

Jemi njohur me shkresën datë 05.05.2025 nr. 15463 prot me lëndë “Kërkohet informacion dhe dokumente” nxjerrë nga SPAK në të cilën na kërkohet të depozitojmë fakte dhe prova shitesë në lidhje me kallëzimin penal që Partia Demokratike ka paraqitur më datë 24.4.2025 me nr. 360 prot.

Në këtë shkresë citohet se “Ndonëse ju pretendoni se bashkëlidhur keni vendosur prova, në fakt ndër to janë vetëm disa fotografi bardh e zi të vendeve e rrugëve të ndryshme, nga të cilat nuk mund të verifikohet vendi i ngjarjes dhe as koha e kryerjes së veprës penale”. Nga ky citim kuptojmë se ju i jeni referuar një kallëzimi penal tjetër i cili lidhet me ndonjë çështje tjetër penale dhe jo me kallëzimin penal që Partia Demokratike ka nisur në datën 24.4.2025 që mban nr. 360 prot.

Në fakt, kallëzimi penal datë 24.2.2025 me nr. 360 prot që kemi sjellë pranë jush i referohet çështjes penale me këto të dhëna:

Kallëzues: Një grup deputetësh të Partisë Demokratike

Objekti: Kallëzim i veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a Kodit Penal

Kundër: Kryetarit të Bashkisë Maliq, Gëzim Topçiu

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
Neni 248, 328/a dhe 331/a të Kodit Penal të ndryshuar;
Nenet 74, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale;
Kodi Zgjedhor i ndryshuar;
Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror; agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Drejtuar: SPAK

Megjithatë, me anë të kesaj shkrese dëshiroj tju rikujtoj edhe njëherë shkeljet ligjore dhe abuzive të konsumuara nga personi i kallëzuar dhe nisjen sa më shpejt të hetimeve.

Rezulton se, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në buletin nr. 14 datë 25 Mars 2025 është publikuar një procedurë prokurimi nga Bashkia Maliq, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, Vendimin nr. 9/2020 dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me Kodin Penal.

Njoftimi për shpalljen e procedurave të prokurimit përmban këto të dhëna:

- *Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Maliq*
- *Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur pune*
- *Objekti i kontratës: Sistemim asfaltim rrugë 2025*
- *Numri i referencës së procedurës: REF-41656-03-19-2025*
- *Fondi limit: 83.332.941 Lek pa Tvsh*
- *Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj*
- *Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 04.04.2025 (d/m/v) Ora: 10:00*

Përveç, këtij rasti, sjellim para jush një tjetër shkelje të kryer nga Kryetari i Bashkisë Maliq, i cili po në shkelje të ligjit ka shpallur njoftim për vende të lira pune në periudhë parazgjedhore. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Për më tepër, me anë të një njoftimi publik Qeveria ndalon punësimet në administratë në prag të zgjedhjeve. Konkretisht, Ministria e Shtetit për Administratën, Adea Pirdeni njoftoi se në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare të 11 Majit ky vendim është marrë për të garantuar një proces të rregullt zgjedhor.

Ministria Pirdeni është shprehur se “*Por në këtë vendim ne kemi kaluar në një nivel tjetër për të garantuar një standard edhe më të lartë të garantimit të paanshmërisë të procesit zgjedhor duke parashikuar që prej datës 3 mars 2025 do të ndalohet çdo procedure rekrutimi nga institucionet që rekrutojnë punonjësit e tyre përmes Kodit të Punës*”.

Për të dyja rastet, kemi bindjen se nga ana e personit të kallëzuar janë konsumuar veprat penale si më sipër.

Për këtë çështje, do të gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese provat:

- *Njoftimin në AKPA për shpalljen e vendeve të lira të punës nga Bashkia Maliq*
- *Njoftimin në buletin nr. 14 datë 25 Mars 2025 të publikuar në Agjencinë e Prokurimit Publik*
- *Deklaratën publike të Ministres Pirdeni*

Sa më sipër, ju drejtohem edhe njëherë me këtë Memo, me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore të domosdoshme dhe të gjithanshme në kuadër të hetimit penal dhe bazuar në nenet 58, 110 e vijues të K.Pr.Penale:

KËRKOJMË:

- **Kryerjen e veprimeve të menjëhershme hetimore nga ana juaj në funksion të kallëzimit të bërë nga ne, ndaj shtetasit Gëzim Topçiu por edhe shtetasve të tjerë që mund të jenë përfshirë në këto ngjarje;**
- **Thellimin e hetimit në nivel kombëtar, për të evidentuar çdo abuzim të mundshëm;**

- Nisjen e hetimit të thelluar pasuror për shtetasin Gëzim Topçiu, për të evidentuar nëse nga shpërdorimi i detyrës së tij si Kryetar Bashkie, ka përfituar edhe personalisht përfitime të padrejta.

Me respekt,

Zj. Albana VOKSHI

DEPUTETE E PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 360/1 Prot.

Data: 06.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 15463 Prot./V.M

Tiranë, më 05.05.2025

Lënda: Kërkohej informacion dhe dokumente.

Drejtuar: Znj. Albana Vokshi
Partia Demokratike e Shqipërisë
(Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.11)

TIRANË

Në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, është depozituar kallëzimi i Partisë Demokratike të Shqipërisë Nr.360 Prot, datë 24.04.2025, i nënshkruar nga ana juaj. Ky kallëzim është regjistruar në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale, si kallëzimi Nr.119 datë 28.04.2025.

Në përmbajtjen e kallëzimit, ju pretendoni kryerjen e veprave penale gjatë fushatës elektorale, nga përfaqësues të pushtetit vendor, por pa specifikuar ndonjë fakt konkret, kohë, vend dhe mënyrë të kryerjes së veprës penale.

Ndonëse ju pretendoni se bashkëlidhur keni vendosur prova, në fakt ndër to janë vetëm disa fotografi bardh e zi të vëndeve e rrugëve të ndryshme, nga të cilat nuk mund të verifikohet vëndi i ngjarjes dhe as koha e kryerjes së veprës penale.

Bazuar në nenin 284/1 të Kodit të Procedurës Penale, kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, elementë të cilët mungojnë në kallëzimin tuaj.

Nga sa më sipër, ju ftojme që deri në datën 08 Maj 2025, të depozitoni në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, elementë shtesë të rrethanave të faktit, prova të cilat mund të dispononi, si dhe të paraqiteni vetë për të dhënë shpjegime të detajuara rreth asaj që pretendoni në çdo kohë që e çmoni të arsyeshme brenda orarit zyrtar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI



Adresa: Rruga "Jordan Misja" Nr.1, Tiranë

Website: www.spak.gov.al